

RAPORTI VJETOR 2022



EUROSIG
SIGURI E STANDARDEVE EUROPIANE



PROFILI I KOMPANISË

EUROSIG, si shoqëri e konsoliduar në tregun e sigurimeve, është e shtrirë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë me 19 degë, 12 agjenci dhe mbi 100 pika shitjeje e përfaqësimi. Aktualisht, në Eurosigt janë të punësuar qindra punonjës në nivel qendror dhe vendor.

Përkushtimi në shërbimet e sigurimit që ofrojmë ka sjellë rritjen e vazhdueshme të numrit të klientëve, të cilët na kanë besuar. Nga viti në vit, nën siglën "EUROSIG", treguesit ekonomiko-financiare të shoqërisë kanë shënuar rritje 2-shifrore.



PËRMBAJTJA

Fjala përshëndetëse e Kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës.....	4
Fjala përshëndetëse e Drejtorit të Përgjithshëm	6
Struktura qeverisëse e shoqërisë.....	8
Vizioni, misioni, vlerat e Eurosig	9
Burimet njerëzore, veprimtaritë kryesore, klientët dhe partnerët e Eurosig	11
Eurosig nëpërmjet shifrave	14
Disa të dhëna për Grupin Financiar Eurosig–Insig–UBA	16
Përgjegjësia sociale dhe promovimi i vlerave	17
Pjesëmarrjet e Eurosig në kapitalin e shoqërive të tjera.....	32
Lista e aksionarëve të Eurosig me pjesëmarrje influencuese të kapitalit	32
Lista e administratorëve të Eurosig	32
Opinion i shkurtuar mbi auditimin e brendshëm	33
Monitorimi, administrimi dhe kontrolli i riskut që ndërmerr Eurosig	38
Treguesit e mjaftueshmërisë së kapitalit, të likuiditetit dhe të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike	40
Objektivat për vitin 2023	42
Opinion i Shoqërisë Audituese dhe Pasqyrat Financiare sipas SNRF	45

FJALA PËRSHËNDETËSE KRYETARIT TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS

Vasil PILO

Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës



Rezultatet e arritura janë shprehja më e mirë e leadershipit vizionar, vendimmarrjes së suksesshme strategjike dhe performancës në rritje të menaxherëve dhe stafeve respektive të subjekteve të Grupit.

Të nderuar lexues dhe aksionarë të Eurosig,

Me gjithë kompleksitetin e krijuar nga ndikimi i zhvillimeve gjeopolitike, brenda një mjedisi sfidues ekonomik dhe financiar, viti 2022 konsiderohet i suksesshëm në realizimin e objektivave dhe prioriteteve tona. Në sajë të planifikimeve të kujdesshme strategjike dhe një qeverisjeje korporative efektive, Grupi Financiar Eurosig-INSIG-UBA performon me sukses në Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Kosovës, duke treguar qëndrueshmëri dhe standarde të larta.

Rezultatet e arritura janë shprehja më e mirë e leadershipit vizionar, vendim-marrjes së suksesshme strategjike dhe performancës në rritje të menaxherëve dhe stafeve respektive të subjekteve të Grupit. Punonjësit tanë besojnë në atë që bëjnë dhe punojnë gjithnjë e më shumë.

Bashkëpunimi i suksesshëm që kemi përforcuar në vite me klientët dhe partnerët tanë është në themel të standardeve të larta të arritura. Në udhëtimin tonë të përbashkët, kemi treguar se jemi me vizion, kemi identifikuar vazhdimisht mundësi të reja, duke ecur me kërkesat e tregut dhe përshtatur me nevojat e klientëve.

Në 18 vite veprimtari, Eurosig ka vepruar si biznes i motivuar shpirtërisht, duke ndihmuar njerëzit të ndërtojnë një të ardhme më të sigurtë, duke u kujdesur për jetën dhe pasuritë e tyre, duke ofruar zgjidhje me kompetencë dhe prekje njerëzore.

Drejtimi me integritet, performanca, konsolidimi dhe stabiliteti brenda normave të lejuara i treguesve ekonomiko-financiarë, tregojnë se shoqëria Eurosig është e shëndetshme dhe se sistemet e saj të kontrollit dhe ato operacionale janë në gjendje të përballojnë volumin e një rritjeje konstante të biznesit. Ne punojmë si një kompani që e mbështet rritjen e vet fitimprurëse mbi baza të shëndetshme financiare, duke rritur vlerën për aksionarët tanë si dhe duke krijuar mundësi për karrierë dhe shpërblime financiare për punonjësit dhe agjentët që përfaqësojnë çdo ditë Eurosigun në mbarë vendin. Kjo shërben si garanci në realizimin me sukses të objektivave të Strategjisë së Eurosig 2022 - 2026.

Në emër të Këshillit Mbikëqyrës, dëshiroj të falënderoj Menaxhimin e Lartë, Menaxhimin Operacional dhe të gjithë punonjësit e Eurosig për punën dhe arritjet në vite. Përkushtimi dhe angazhimi juaj vijues ndaj klientëve është garanci suksesi në të ardhmen.

Falënderim i veçantë për arritjet tona u takojnë aksionarëve, për mbështetjen e vazhdueshme; klientëve dhe partnerëve të biznesit, për besimin që na kanë dhënë ndër vite.

Me urimet e përzemërta për Ju dhe familjet Tuaja, me besim të plotë për bashkëpunimin tonë, Ju ftojme në udhëtimin tonë të përbashkët në të ardhmen.

FJALA PËRSHËNDETËSE E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM

Dr. Xhevdet KOPANI

Drejtor i Përgjithshëm



Të nderuar klientë, partnerë, miq e bashkëpunëtorë,

Të nderuar punonjës të Grupit Eurosig-Insig-UBA,

Viti 2022 u mendua si një vit i daljes nga pandemia, ringritjes dhe përmirësimit të treguesve të shoqërisë në tërësi. Pasojat e pandemisë në Shqipëri, rajon dhe mbarë botën, në humbjen e jetëve dhe shëndetin e njerëzve, tkurrjen e tregjeve, rritjen e inflacionit, koston e jetesës së klientëve, pasigurinë për të ardhmen ishin me ndikim të konsiderueshëm në të gjitha sferat e jetës.



U jam mirënjohës të gjithë klientëve që na besuan, partnerëve tanë ndërkombëtarë dhe stafit të përkushtuar të Eurosig.

Por, kur të gjithë po mendonim për të rikuperuar pasojat e pandemisë, filloi konflikti Rusi-Ukrainë, i cili u shoqërua me rritjen e çmimeve, kostos së jetesës, inflacionit, uljen e konsumit etj. dhe që pati ndikim të madh në të gjitha ekonomitë, jo vetëm europiane, por dhe më gjerë.

Natyrisht që edhe shoqëritë financiare dhe ato të sigurimit ishin të ndikuara nga faktorë të krizës së përgjithshme, pasigurisë për jetën, investimet, tregun, sigurinë në tërësi, dhe, si shoqëri financiare, ne ishim më të ndjeshëm ndaj këtyre fenomeneve. Megjithatë, ajo që u evidentua ishte marrja e masave nga tregjet, gatishmëria jonë për të patur në qendër të vëmendjes klientin, duke sakrifikuar dhe pjesë nga të ardhurat tona, duke marrë përsipër kosto që duhet dhe mund të transferoheshin tek klientët, me të vetmin qëllim kujdesin ndaj tyre.

Gjatë vitit 2022, tregu i sigurimeve të Jo-Jetës arriti 21 miliardë lekë, me një rritje +9.16 %, në krahasim me vitin 2021. Vlera e dëmeve të paguara arriti në 6.8 miliardë lekë. Shoqëria Eurosig sh.a. arriti një volum primesh mbi 2,6 miliardë lekë, me një realizim nga viti 2021 në masën 112,15%. Dëmet arritën në 694 milionë lekë, duke shënuar vlerën më të lartë në 5 vitet e fundit. Dëmet e Fondit të Kompenzimeve zënë 11% të dëmeve të paguara nga tregu. Raporti sigurime vullnetare me sigurime të detyrueshme arriti rreth 18% me 82%. Eurosigu tregoi rritje dhe qëndrueshmëri në rezultate, duke vazhduar të jetë në vendin e tretë në tregun e sigurimeve për vitin 2022.

Ky vit shënoi gjithashtu përmirësime në infrastrukturën e teknologjisë së informacionit, marrjen e masave për t'u përballur me kërcënimet kibernetike, ofrimin e shërbimeve më të shpejta e cilësore për klientët, duke përsosur procesin e digjitalizimit të shërbimeve, ofrimit online të tyre, dëmshpërblim të drejtë, real dhe të shpejtë.

Treguesit e arritur në vitin 2022 janë rrjedhojë e punës, përkushtimit, profesionalizmit të të gjithë punonjësve, agjentëve, ndërmjetësve, të bashkëpunëtorëve, të cilët me këtë rast i falënderoj për gjithçka kanë bërë gjatë këtij viti për përbushjen e objektivave strategjike dhe atyre vjetore.

Gjithashtu, këta tregues pozitivë janë realizuar falë dhe kujdesit dhe mbështetjes së Aksionerit kryesor, Z. Kadri Morinaj, dhe Këshillit Mbikëqyrës.

Falënderim i veçantë është për të gjithë ata klientë që na besuan, por dhe për partnerët tanë ndërkombëtarë, risigurues, brokëra etj., të cilët dëshmuar partneritet, besnikëri dhe besueshmëri ndaj nesh.

Shoqëria Eurosig, për vitin 2023 e në vijim, do të mbetet e fokusuar tek shërbimi ndaj klientit, përgjegjshmëria e lartë në komunikimin me ta, veçanërisht në trajtimin e dëmeve dhe digjitalizimin e shërbimeve. Ofrimi i produkteve dhe paketave promovionale me orientim ruajtjen e shëndetit dhe pronës së klientit dhe dhënien e një sigurie maksimale për të gjitha produktet e ofruara.

STRUKTURA QEVERISËSE E SHOQËRISË

Në Eurosig kemi implementuar praktikat më të mira të qeverisjes së biznesit, duke ndarë të drejtat dhe përgjegjësitë ndërmjet Asamblesë së Aksionarëve, Këshillit Mbikëqyrës, Drejtorit të Përgjithshëm, Menaxhimit të Lartë, Menaxhimit Operacional dhe Funksiioneve Kryesore të Kontrollit. Në funksion të mirëqeverisjes, janë krijuar dhe funksionojnë edhe Komiteti i Auditimit&Menaxhimit të Riskut, Komiteti i Investimeve, Komiteti i Risigurimit dhe Komiteti i Vlerësimit të Dëmeve.

Fushat e përgjegjësiave të organeve mbikëqyrëse, ekzekutive, menaxheriale dhe funksioneve të kontrollit janë të përcaktuara në aktet e brendshme të Eurosig. Kjo ndikon pozitivisht në mënyrën e përcaktimit të strategjive dhe objektivave të Eurosig, përzgjedhjen dhe mbikëqyrjen e personelit, kryerjen e veprimtarive ditore, përcaktimin dhe respektimin e Kodit të Sjelljes dhe Etikës, duke operuar në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi.



Kemi implementuar praktikat më të mira të qeverisjes së biznesit



MISIONI

Misioni i Eurosig është:

- a) të sigurojë produkte, shërbime dhe aktivitete ndaj klientëve, nëpërmjet përsosjes së shërbimit, cilësisë, profesionalizmit, etikës, duke funksionuar si një shoqëri financiare, me qëllim optimizimin e kërkesave të klientëve, rritjen e kapitalit financiar, rritjen e vlerës së aksioneve, duke i siguruar klientët për mbështetje në çdo kohë, për kompensim të plotë dhe të drejtë për dëmet e mundshme;
- b) të ofrojë shërbime sipas standardeve europiane, duke konsoliduar pozicionin e saj dhe duke garantuar emër e reputacion tek partnerët rajonalë, europianë e më gjerë;
- c) të marrë reagime (feedback) nga klientët me forma e metoda bashkëkohore dhe reflektim të tyre, për të përmirësuar shërbimin.

VIZIONI

Të qenit lider në fushën e sigurimeve, bazuar në standarde europiane, që orientohet nga performanca e shtuar, në përputhje me kërkesat e palëve të interesuara, duke u mbështetur në filozofinë e vlerave, profesionalizmit, bazueshmërisë ligjore, reflektimit ndaj kërkesave të klientit dhe fokusimit tek ai.



***Eurosig është
lider në fushën e
sigurimeve, bazuar
në standarde
europiane***

VLERAT E SHOQËRISË

Shoqëria Eurosig ka një emër dhe përbën një vlerë të shtuar në industrinë e sigurimeve në Shqipëri dhe rajon. Përvoja 18 vjeçare në fushën e sigurimeve i ka konsoliduar këto vlera, duke i bërë të qëndrueshme dhe me ndikim të drejt-përdrejt në zhvillimet e shoqërisë.


Filozofia e Eurosigut për orientimin ndaj klientit, përbën një qasje që mbart vlera për tani dhe të ardhmen. Ne kemi krijuar marrëdhënie afatgjata besimi me punonjësit, klientët, grupet e interesit duke u përgjigjur kërkesave të tyre me shpejtësi dhe profesionalizëm. Në Eurosig punohet në grup, nxitet diversiteti, vlerësohen përpjekjet dhe puna orientohet drejt rezultatit.

Vlerë e shtuar e Eurosigut ndër vite është dhe përgjegjësia sociale, falë rolit të spikatur dhe vlerave altruiste të Presidentit të Grupit Financiar Eurosig-Insig-UBA, z. Kadri Morinaj.

Performimi i Eurosig në raport me industrinë e sigurimeve dhe historinë e saj në treg, rritja, zgjerimi dhe konsolidimi në tregun e sigurimeve në Shqipëri dhe rajon, zgjerimi i veprimtarisë financiare të Grupit edhe në tregun bankar përbëjnë një vlerë me ndikim pozitiv në performancën tonë në të ardhmen.



*Punohet në grup,
nxitet diversiteti,
vlerësohen përpjekjet
dhe puna orientohet
drejt rezultatit*



BURIMET NJERËZORE

Eurosig, si shoqëri e konsoliduar në tregun e sigurimeve, ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë me 19 degë, 12 agjenci dhe 272 punonjës në nivel qendror dhe vendor. Duke i konsideruar burimet njerëzore si një faktor të rëndësishëm dhe kapitalin intelektual për rritjen e biznesit tonë, ne investojmë sistematikisht në përzgjedhjen, trajnimin, vlerësimin, qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e punonjësve. Shtrirja e Eurosigut në të gjithë vendin, burimet njerëzore profesionale dhe me integritet, aftësitë e larta qeverisëse të ekipeve mbikëqyrëse dhe menaxheriale përbëjnë garanci për sukses dhe përballim të sfidave në të ardhmen.



VEPRIMTARITË KRYESORE TË EUROSIG

Shoqëria Eurosig ruan sandardet më të mira të produkteve të sigurimit, në përputhje me kërkesat e klientëve, pasi janë hartuar bazuar mbi produktet dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit. Eurosig gëzon të gjithë ekspertizën e nevojshme dhe ofron asistencë dhe praktikën më të mirë të trajtimit të dëmeve.

Eurosig ushtron veprimtari sigurimi në përputhje me klasat, për të cilat është licencuar nga AMF. Linjat kryesore të biznesit të Eurosig përfshijnë veprimtaritë për sigurimin dhe risigurimin, për trajtimin e dëmeve, për çështjet ekonomiko-financiare, për çështjet ligjore, për kontrollin e brendshëm dhe menaxhimin e riskut etj.

Veprimtari kryesore e Eurosig është realizimi i procesit të shitjes dhe marrjes në sigurim:

- për produktet e sigurimeve vullnetare, si Sigurimi i Aksidenteve Personale, Sigurimi i Shëndetit dhe Sëmundjeve, Sigurimi Kasko, Sigurimi i Pasurisë (nga zjarri dhe forcat e natyrës), Sigurimet ndaj Dëmtimeve dhe Humbjeve të Tjera të Pasurisë, Sigurimi i Garancive të Ofertave dhe të Kontratave, Sigurimi i Mallrave në Transport, Sigurimi i Përgjegjësisë të Anijeve dhe Mjeteve Lun-druese, Sigurimi i Përgjegjësisë (profesionale, publike, punëdhënësit), Sigurimi i Bankave BBB&ECC;
- për produktet e sigurimit të detyrueshëm, si Sigurimi i Detyrueshëm Motorik për Përgjegjësitë ndaj Palëve të Treta (DMTPL), Certifikata Motorike Ndërkombëtare e Sigurimit (Kartoni Jeshil), Sigurimet Kufitare etj.

Veprimtaritë e linjave të biznesit mbështeten nga një sistem dhe rrjet informatik bashkëkohor.

KLIENTËT E EUROSIG

Filozofia e Eurosig është e orientuar ndaj klientëve, duke synuar gjithmonë krijimin e një partneriteti afatgjatë me klientët tanë. Besimi që kemi krijuar ndër vite ka bërë që sot të numërojmë mes klientëve tanë shoqëri dhe institucione të rëndësishme për vendin, si banka dhe institucione financiare, si dhe kompani të mëdha biznesi, për të cilat shërbimi është ofruar i personalizuar dhe në kohë reale. Synimi jonë është të ofrojmë zgjidhje praktike dhe të shpejta lidhur me kërkesat e klientëve tanë, si dhe përgjigjia në kohë dhe në masë e dëmshpërblimeve, në rast dëmi. Për këtë qëllim, stafi i mirëtrajnuar dhe me aftësi të shkëlqyera teknike dhe komunikimi përcjell të njëjtën filozofi biznesi tek klientët.



***Ofrojmë zgjidhje
praktike dhe të
shpejta lidhur
me kërkesat e
klientëve tanë***



PARTNERËT E EUROSIG

Kompanitë e risigurimit, partnere të Eurosigt, kanë një ndikim të rëndësishëm në qëndrueshmërinë, inovacionin, fuqinë financiare të Eurosigt në tregun e sigurimeve. Pjesëmarrësit në kontratat e risigurimit të Eurosigt janë shoqëri risigurimi që përmbushin standardet ndërkombëtare të stabilitetit financiar, të listuara në bazën e vlerësimeve të agjencive ndërkombëtare të vlerësimit të kreditit si Standard and Poors, AM Best, Fitch në përputhshmëri dhe në zbatim të kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore, rregullatore dhe aktet e brendshme të Eurosigt.

Shoqëria Eurosigt ka investuar një kosto relativisht të lartë për risigurimet me kompani risigurimi prestigjioze, si Hannover Re, Polish Re, Generali Group, për të garantuar financiarisht detyrimet e mundshme dhe përgjegjësitë ndaj klientëve, si në risqet e sigurimit të pronës ashtu dhe në ato të sigurimeve motorike dhe të përgjegjësi.

Shoqëria Eurosigt bashkëpunon edhe me shoqëri të tjera risigurimi, të vlerësuara si të sigurt dhe stabël në tregun ndërkombëtar, si: AXA XL (XL Re Europe SE), vlerësuar me AA- sipas S&P; SCOR, vlerësuar me A- sipas AM Best; VOG Re vlerësuar me A+, sipas S&P; Sava Re vlerësuar me A- sipas S&P dhe AM Best; Trust Re vlerësuar me A- sipas S&P dhe AM Best.

EUROSIG

NËPËRMJET SHIFRAVE

Me gjithë kompleksitetin e krijuar nga ndikimi i faktorëve të jashtëm, viti 2022 konsiderohet i suksesshëm në realizimin e objektivave dhe prioriteteve tona. Disa nga treguesit kryesorë të vitit 2022, krahasuar me vitin 2021, janë:

- Volumi i primeve të shkruara bruto është 2,605,983,000 lekë ose 12.49% më shumë.
- Volumi i dëmeve të paguara është 694,819,000 lekë, me një rritje prej 16.79%.
- Volumi i sigurimeve vullnetare kundrejt totalit është 17.92%, me një rënie 2.2 pikë përqind.
- Për treguesin e volumit të primeve të shkruara bruto:
 - o në Sigurimin Motorik kemi rritje me 15.08%, zotërojmë 15.52% të tregut, renditemi në vendin e dytë;
 - o në produktet MTPL e Brendshme kemi rritje me 9.63%, zotërojmë 15.05% të tregut, renditemi në vendin e dytë;
 - o në Sigurimin Kartoni Jeshil kemi rritje me 42.57%, zotërojmë 24.68% të tregut,

*Viti 2022 ishte
i suksesshëm
në realizimin
e objektivave
& prioriteteve*



renditemi në vendin e dytë;

- o në Sigurimin Kufitare zotërojmë 14.78% të tregut, renditemi në vendin e tretë;
- o në Sigurimin Kasko zotërojmë 6.76% të tregut;
- o në Sigurimin Zjarri, Forcat e Natyrës dhe Dëmtimet e Tjera në Pronë kemi rritje me 10.33%;
- o në Sigurimin Aksidentet dhe Shëndeti zotërojmë 13.06% të tregut, renditemi në vendin e tretë;
- o në Sigurimin Shëndeti në Udhëtim kemi rritje me 16.18%, renditemi në vendin e tretë;
- o në Sigurimin e Përgjegjësisë Civile kemi rritje me 32.87%, renditemi në vendin e tretë;
- o në Sigurimin e Përgjegjësisë në Ndërtim kemi rritje me 37.47%, renditemi në vendin e tretë;

Volumi i dëmeve të paguara:

- o në Sigurimin Motorik është 604,604,000 lekë, me një rritje prej 47.77%;
- o në Sigurimin MTPL e Brendshme është 492,992,000 lekë, me një rritje prej 64.93%;
- o në Sigurimin Kartoni Jeshil është 66,315,000 lekë, me një rritje prej 20.98%;
- o në Sigurimin Zjarri, Forcat e Natyrës dhe Dëmtimet e Tjera në Pronë është 25,038,000 lekë, duke u zvogëluar me 78.98%.



ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I GRUPIT EUROSIG-INSIG-UBA

Sipas përcaktimeve në aktet ligjore dhe rregullatore, Grupi Financiar Eurosig-Insig-UBA funksionon i përbërë nga: shoqëria Eurosig sh.a Shqipëri, shoqëri mëmë; shoqëritë Insig Jo-Jetë sh.a Shqipëri, Insig Jetë sh.a Shqipëri, Eurosig sh.a Kosovë dhe Banka e Bashkuar e Shqipërisë, shoqëri të kontrolluara.

Shoqëritë e Grupit gëzojnë parametrat e gjendjes financiare për vitin 2022 në përputhje të plotë me kërkesat ligjore dhe rregullatore në fuqi.

TREGUESIT KRYESORË TË SHOQËRIVE TË SIGURIMIT TË GRUPIT PËR VITIN 2022 (në Lekë)

EMËRTIMI	VOLUMI I PRIMEVE TË SHKRUARA BRUTO	PESHA SPECIFIKE NDAJ TOTALIT	DËME TË PAGUARA BRUTO
EUROSIG SHQIPËRI	2,605,982,525	43%	694,819,093
EUROSIG KOSOVË	1,780,744,316	29%	838,293,958
INSIG JO-JETË SHQIPËRI	1,365,696,754	23%	389,041,319
INSIG JETË SHQIPËRI	298,922,001	5%	58,094,682
TOTALI	6,051,345,596	100%	1,980,249,052

- Krahasuar me vitin 2021, kemi rritje: Insig-Al Jetë sh.a. me 36.63%, Eurosig-KS sh.a. me 33.72%, Eurosig-Al sh.a. me 12.5% dhe Insig-Al sh.a. me 10.74%.
- Në Republikën e Shqipërisë: Eurosig dhe Insig së bashku zotërojnë 20.58% të tregut të sigurimeve të Jo-Jetës, duke u renditur në vendin e dytë, dhe 24.13% të tregut në sigurimet motorike, duke u renditur në vendin e parë; kurse Insig Jetë zotëron 17.68% të tregut të Jetës.



PËRGJEGJËSIA SOCIALE & PROMOVIMI I VLERAVE

Përgjegjësia sociale është një vlerë e shtuar e subjekteve të Grupit Financiar Eurosig-Insig-UBA. Falë angazhimit dhe kujdesit të vazhdueshëm të Presidentit, z. Kadri Morinaj, subjektet e Grupit janë të angazhuara për të maksimizuar ndikimin pozitiv në shoqëri dhe mjedisin ku ushtrojnë veprimtarinë e tyre. Një vëmendje të veçantë Grupi Eurosig-INSIG-UBA dhe Presidenti Morinaj kanë ndaj mjedisit kulturor, artistik, mediatik, ndaj shtresave në nevojë etj.

”

***Përgjegjësia sociale
është një vlerë e
shtuar e subjekteve
të Grupit Financiar
Eurosig-Insig-UBA***

Veprimtaritë kryesore në kuadër të përgjegjësisë sociale dhe promovimit të vlerave të Grupit Financiar Eurosig-INSIG-UBA janë:

Janar 2022

- Grupi Eurosig-Insig-UBA nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin Epoka, me qëllim rritjen e bashkëpunimit për zhvillimin e praktikave mësimore të studentëve dhe shkëmbimin e eksperiencave të përbashkëta. Ky bashkëpunim synon edhe promovimin e punimeve shkencore të shërbi-meve financiare inovatore për të gjithë llojet e investorëve, sjelljen e ideve inovatore në shërbim të politikave të zhvillimit për një vendimmarrje të drejtë dhe të mbështetur në punime kërkimore dhe shkencore.

Shkurt 2022

- Mbështetje me 5 tonë miell për familjet e bllokuara nga moti i keq në rajonin e Kukësit.
- Dhënia e 50 mijë eurove për popullin e Ukrainës, si kontribut për përballimin e vuajtjeve që po u shkaktohen nga lufta. Nga ky kontribut, 20 mijë euro u dhuruan specifikisht për shqiptarët që jetojnë prej shekujsh në Ukrainë, të cilët Presidenti Morinaj i ka vizituar para 20 vitesh.

“
50 mijë euro për
popullin e Ukrainës
për vuajtjet që
po u shkaktohen
nga lufta





**Ambasadori i
Ukrainës falenderon
Z. Morinaj për
ndihmën e dhënë**

Mars 2022

- Për kontributin e dhënë, presidenti i Grupit, Z. Kadri Morinaj, u falënderua nga ambasadori i Ukrainës në Tiranë, Z. Volodymyr Shkurov. Në pritjen e organizuar për nder të tij, Z. Morinaj garantoj ambasadorin ukrainas se “për çdo nevojë që do të keni, dera ime dhe e kompanive të Grupit Eurosig-Insig-UBA do të jetë e hapur”. Kjo mbështetje u duk edhe në Ditën e Bajramit të Madh (maj 2022), ku gratë dhe fëmijët ukrainas në Shqipëri festuan falë mbështetjes së presidentit Morinaj.
- Vlerësimi i Presidentit të Grupit, Z. Kadri Morinaj, me çmimin “Star of Business”, nga Asambleja Europiane e Biznesit (Europe Business Assembly-EBA) për arritjet në fushën e biznesit. Ekspertët kanë konkluduar se Grupi Eurosig-Insig-UBA ka arritjet më të mëdha, duke fituar kështu çmimin “TOP 100 Achievements”, që konsiderohet një çmim i përjetshëm nga EBA. EBA është një institucion i pavarur që prej 20 vitesh ka në fokus ekonominë, por edhe çështjet sociale e ato njerëzore.
- Mbështetje për koncertin e Malumas në Tiranë, si një ogur i mirë për nisjen e Pranverës në Shqipëri.
- Mbështetje për koncertin “Aromë Gruaje” të organizuar nga këngëtarja e madhe shqiptare Anxhela Peristeri.



Z. Kadri Morinaj:
Jam ndjerë i obliguar që Hasi të ketë në gjirin e vet, Pjetër Bogdanin, djalin e vet



Prill 2022

- Ngritja e përmendores së Pjetër Bogdanit, në Krumë të Hasit, në vlerësim të tij si një njeri i kulturës, artit, letërsisë dhe patriot i madh kombëtar e pararendës i Rilindjes Kombëtare.
- Pjesëmarrja e Presidentit të Grupit, Z. Kadri Morinaj, në eventin e Princeshës Murat Napoleon në Paris, organizuar nën patronazhin e Bashkisë Paris dhe UNHCR, në kuadrin e bamirësisë për të ndihmuar ngritjen e një spitali fushor në kufirin ukrainas, për t'u ardhur në ndihmë njerëzve të dëmtuar nga lufta. Në këtë event kishte shumë të ftuar nga e gjithë bota, kryesisht biznesmenë të suksesshëm dhe nga bota akademike.
- Shpërndarja e një mijë Kartave Rinore Europiane për gjimnazistët dhe studentët e kryeqytetit, në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës, në kuadër të zgjedhjes së Tiranës si "Kryeqyteti Evropian i Rinisë për 2022".

- Presidenti i Grupit Financiar Eurosig-Insig-UBA, Z. Kadri Morinaj, i dhuroi Komunitetit Mysliman xhaminë në Marikaj. Kjo Xhami mori emrin e një besimtari të devotshëm dhe të respektuar, që nga koha e komunizmit deri në frymën e tij të fundit, Tahir Morinaj, babait të aksionarëve kryesorë të Grupit, Z. Kadri Morinaj dhe Z. Xhevdet Morinaj. Në ceremoninë e zhvilluar, presidenti i Grupit, Z. Kadri Morinaj, theksoi: “Kjo është më e pakta që mund të bëjnë fëmijët për një baba kaq të përkushtuar ndaj nesh dhe Islamit. ... Uroj të jetë duke na parë i mrekulluar nga Parajsa, që një Xhami mban emrin e Tahir Morinaj!”.
- Mbështetje për talentin shqiptar, pilotin 16-vjeçar Andri Gjoka, në garat me makinat Karting, në Genova të Italisë, ku ai bëri një paraqitje mbresëlënëse.

Maj 2022

- Në Ditën Kombëtare në Ndhimë të Jetimëve, në një aktivitet me praninë e shumë personaliteteve, shoqatave dhe ambasadorëve të disa vendeve, Grupi Financiar Eurosig-Insig-UBA mori Çertifikatë Mirënjohje për ndihmën e pandalshme për jetimët në Shqipëri.
- Në ceremoninë e nënshkrimit të marrëveshjes me Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës, për bashkëpunimin në funksion të përvojave me interes të përbashkët, Presidenti i Grupit, z. Kadri Morinaj, evidentoi se “Fakulteti Ekonomik ka një rëndësi të veçantë për ne, pasi është furnizuesi kryesor për burimet tona njerëzore”. Me këtë rast, u prezantuan edhe 3 paketa promotionale me kosto minimale lidhur me sigurimin e apartamenteve dhe sigurimin e shëndetit.
- Mbështetje e edicionit të 23-të të kompeticionit më të madh të parashutizmit “Albania Open”. Fituesve të vendi të dytë dhe të tretë iu dorëzuan respektivisht Kupa Eurosig dhe Kupa Insig.
- Mbështetje me 3 milionë lekë për familjen Kola, në Fushë Arrëz, pas tragjedisë me tri viktima.



**Mbështetje e
edicionit të 23-të
të kompeticionit
të parashutizmit
“Albania Open”**

Qershor 2022

Qershor 2022 – Pjesëmarrja e Presidentit të Grupit Financiar Eurosig-Insig-UBA, z. Kadri Morinaj, në takimin që Klubi i Liderëve (Club Des Leaders) zhvilloi në Mynih, në Landin e Bavarisë. Në këtë takim, z. Morinaj pati një bisedim me interes reciprok edhe me Dukën e Bavarisë, z. Franz Bonaventura Adalbert Maria Herzog, një njohës mjaft i mirë i Shqipërisë dhe historisë tonë, dhe kontribues që bashkëpunimi mes dy popujve tanë të avancojë shumë vitet e fundit.

Mbështetje për turin e 79 çiklistik të Shqipërisë, ku 12 skuadra (tre shqiptare e nëntë të huaja) përshkruan 728 km përgjatë 5 ditëve. Grupi Eurosig-Insig-UBA është gjithmonë në mbështetje të sportit dhe të artit.

Mbështetje e Rally Albania, një nga kompeticionet më të mëdha të garave me makina në Shqipëri. Në një garë 7-ditore Grupi Eurosig-Insig-UBA mbështeti një prej ekipeve më të mira shqiptare, i cili u rendit në vendin e katërt.


Punonjës të Grupit Eurosig-INSIG-UBA morën pjesë në trajnimin “Përgjegjësia sociale, e ardhmja e botës”, në Tiranë, me ligjërues z. Ahmed Faraj, një nga drejtuesit e Boubyan Bank në Kuvajt. Pjesëmarrësit morën një informacion të zgjeruar mbi përgjegjësinë sociale, planifikimin e buxhetit për bamirësi etj.

Mbështetje e Konferencës Ndërkombëtare me temë: “Rikuperim, Rindërtim, Rishpikje për një Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Funkcional”, organizuar nga Fakulteti i Ekonomisë, në Universitetin e Tiranës. Në konferencë morën pjesë profesorë shqiptarë e të huaj, funksionarë të shtetit, guvernatorë, të cilët referuan tema me rëndësi në funksion të rimëkëmbjes dhe zhvillimit ekonomik të vendit dhe rajonit.

ECONOMICS



**Marrëveshje
me Fakultetin e
Ekonomisë për
përvojat me interes
të përbashkët**



PROF. DHORI KULE

Z. KADRI MORINAJ



Si promotorë të vlerave kombëtare, u renditëm përkrah kampionit të boksit, Florian Marku

Gusht 2022

- Mbështetje për organizimin e "ZÂ FEST", në kalanë e Rozafës, në Shkodrën e traditës dhe kulturës, ku për tre netë të bukura zemrat e pjesëmarrësve u mbushën me energji, dashuri dhe muzikë. Çdo moment ishte më shumë se magjik!
- Grupi Eurosig-Insig-UBA ishin të ftuar në festimin e 31-vjetorit të Pavarësisë së Ukrainës. Në praninë e shumë personaliteteve të shtetit, përfaqësive diplomatike etj. u ekspozuan edhe foto e piktura të luftës që po ndodh në Ukrainë.
- Grupi Financiar Eurosig-Insig-UBA, si promotor i vlerave kombëtare, edhe këtë herë u rendit në krah të kampionit shqiptar të boksit, z. Florian Marku. Ne kontribuam që kjo ndeshje e madhe boksi të zhvillohej në mënyrën më dinjitoze, duke u shfaqur në ekranet e gjithë botës, përmes platformës televizive "Sky". Me plis në kokë, fituesi Marku ngriti edhe njëherë Flamurin Kuq e Zi para gjithë botës.



Z. Morinaj për Luiza Gegën: Ju do ta keni derën tonë të hapur dhe do t'u gjendemi gjithmonë pranë



Shtator 2022

Në takimin e përzemërt të Presidentit të Grupit, Z. Kadri Morinaj, me kampionen e Europës, znj. Luiza Gega, u diskutuan vështirësitë dhe sakrificat që kampionia ka kaluar për të fituar Medaljen e Artë në garën 3 000 m. Z. Morinaj, duke vlerësuar maksimalisht vullnetin dhe këmbënguljen e znj. Gega për të ngritur flamurin shqiptar në Kampionatin European të atletikës, ndër të tjera tha: "... ne do t'ju mbështesim vazhdimisht, me qëllim që të vazhdoni stërvitjen dhe të arrini rezultate pozitive në kompeticionet e ardhshme. Ju do ta keni derën tonë të hapur dhe do t'u gjendemi gjithmonë pranë". Grupi Eurosig ofroi falas Sigurimin e Shëndetit dhe Aksidenteve Personale për znj. Luiza Gega, me mbulim deri në 50 000 euro në rast dëmtimi trupor apo sëmundje.

Përfaqësues të Grupit Eurosig-Insig-UBA dhe Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS) zhvilluan një takim të përbashkët pranë ambienteve të Eurosig. Qëllimi i takimit ishte kërkimi i pikëpamjeve mbi zhvillimin dhe profilin e riskut të sektorit shqiptar të sigurimeve, për një vlerësim të progresit të bërë në lidhje me ato që cilësohen si Parimet Themelore Ndërkombëtare në fushën e Sigurimeve (Insurance Core Principles).

Tetor 2022

- Në sallën e koncerteve të Katedrales Shën Shtjefni në Shkodër, me rastin e Festës së Zojës së Shkodrës, u dha një koncert nga Ansambli Koral JOY of SINGING. Ky Ansambël ka në përbërje persona të verbër dhe me shikim të dëmtuar. Gjatë koncertit, që u prit ngrohtësisht nga publiku, u evidentua edhe njëherë mbështetja e Eurosigs dhe Insig.
- Grupi Eurosigs-Insig-UBA ndërmori një fushtë sensibilizuese për kujdesin që gratë duhet të tregojnë për parandalimin e kancerit të gjirit.
- Mbështetje për edicionin letrar “Në prehër të Gjallicës”, organizuar nga Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve të Kukësit. Në këtë edicion, me çmimin e parë u nderua shkrimtari Agim Bajrami, kurse me çmimin “Talenti i ri” u nderuar z. Klark Kadri Morinaj.
- Grupi Eurosigs-Insig-UBA vendosi të jetë pranë kampioneve të ekipit të volejbolit të femrave të Skënderbeut të Korçës, duke i mbështetur ato financiarisht gjatë gjithë sezonit.
- Rrjeti AS@N, në bashkëpunim me Rrjetin “Barazi në Vendimmarrje”, organizuan Ditën e Solidaritetit dhe Aktivizimit Social. Grupi Eurosigs-Insig-UBA u krijoi mundësinë 40 të rinjve të njihen me kompanitë, duke marrë eksperiencë. Si pjesë e jona gjatë gjithë ditës, atyre iu akordua një pagesë ditore.



Grupi Eurosigs-Insig-UBA u krijoi mundësinë 40 të rinjve të njihen me kompanitë



**Mbështetje e
Edicionit të 12-të
të hedhjes me
parashutë Albania
COAST TRIP**




Nëntor 2022

- Drejtuesit dhe stafi i Eurosig gjithnjë kanë promovuar dhe kanë afruar studentë ekselentë për të kontribuar në kompani dhe për t'u rritur profesionalisht. Edona Morina, e sapodiplomuar në degën master Kontabilitet dhe Auditim, në Universitetin Bujqësor të Tiranës, dhe kryesuese e Studentëve të Ekselencës së Masterit, prej një viti është pjesë e Eurosig në pozicionin e Auditueses së Brendshme.
- Mbështetje e Edicionit të 12-të të Albania COAST TRIP, duke mundësuar organizimin e kampionateve të hedhjes me parashutë në Shqipëri. Megjithëse kishte konkurrentë nga shumë vende të botës, Kupa Vittorazi u fitua nga parashutisti shqiptar Xhonatan Islami, i ndjekur nga 2 pilotët çekë, Ondrej Zabochnik dhe Lukas Duda.
- Mbështetje financiare për krijimin e disa videove edukative dhe informuese, se si duhet të veprojmë në rast zjarri në ambientet tona. Videot u realizuan në bashkëpunim me Shoqatën Shqiptare për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin.
- Eurosig edhe njëherë tregoi mbështetjen për parashutizmin shqiptar. Këtë vit u organizua Gjiro Open Air, që përkoi me 110-Vjetorin e Pavarësisë. Mes një gare të fortë të parashutistëve nga Shqipëria, Kosova dhe shumë vende të tjera të botës, triumfuan në vend të parë dhe të dytë shqiptarët nga Kosova, Shkumbin Vula dhe Ardall Celina, ndërsa vendin e tretë e zuri gjermani Gerhard Depner.

Dhjetor 2022

- Mbështetje për koncertin e organizuar në Pallatin e Kongreseve nga Ministria e Mbrojtjes, në kuadër të 110-vjetorit të krijimit të Shtetit Shqiptar dhe përvjetorit të themelimit të Ushtrisë Shqiptare. Në këtë koncert performuan rreth 300 artistë nga kori, orkesstra simfonike e FA dhe bandat ushtarake nga Shqipëria, Kosova dhe vendet aleate të NATO-s. Të ardhurat e realizuara nga ky event shkuan në mbështetje të familjeve ukrainase me fëmijë të lënduar nga lufta.
- Presidenti i Grupit Eurosig-Insig-UBA, z. Kadri Morinaj, mbajti një leksion të hapur dhe zhvilloi një bashkëbisedim të ngrohtë me studentët e nivelit Master të Fakultetit të Ekonomisë, në Universitetin e Tiranës. Zoti Morinaj ishte i ftuar nga Prof. Dr. Sherif Bundo, i cili u kishte premtuar studentëve që do të ftonte një biznesmen me ndikim domethënës në industrinë financiare të vendit.
- Ansambli koral "JOY of SINGING", i cili ka në përbërje të tij persona të verbër dhe me shikim të dëmtuar, organizoi koncertin "Gëzimi i Krishtlindjes" në ambientet e Kishës Zemra e Krishtit në Tiranë. Koncerti u prit ngrohtësisht nga publiku që kishte mbushur sallën e Katedrales. Gjatë koncertit u evidentua edhe njëherë mbështetja e Grupit Eurosig-Insig-UBA. Presidenti Morinaj, i prekur nga performanca e këtyre artistëve u shpreh: "Ky koncert ishte një gjë shumë e bukur, madje koncerti më i bukur që kemi mbështetur deri tani ...".
- Edhe këtë vit Grupi Eurosig-Insig-UBA kontribuoi si Sponsor Gjeneral i Festivalit të Këngës në Radio Televizionin Shqiptar.
- Punonjësit e Grupit Eurosig-Insig-UBA kaluan një nga mbrëmjet më të bukura të fundvitit. Mes valltarëve profesionistë, grupeve polifonike, humorit, muzikës, apo këngëtarëve me nivel të lartë artistik, stafet e Grupit përjetuan një nga mbrëmjet më madhështore të vitit. U dhanë edhe çmimet dhe trofetë për vitin 2022: "Kompania më e Suksesshme e Grupit", "Punonjësi më i Mirë", "Kontribuesi më i Mirë dhe më Aktiv" etj.





Grupi Eurosig-Insig-UBA akordoi Bursa të plota për disa studentë të Universitetit Epoka



Veprimtari të shumta në kuadër të përgjegjësisë sociale dhe promovimit të vlerave të Eurosig u zhvilluan në periudhën e parë të vitit 2023, të cilat do të pasqyrohen në Raportin Vjetor 2023. Në mënyrë të përmblëdhur, ndër më kryesoret, evidentojmë:

JANAR 2023 – Grupi Eurosig-Insig-UBA nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin Epoka, me qëllim rritjen e bashkëpunimit për zhvillimin e praktikave mësimore të studentëve dhe shkëmbimin e eksperiencave të përbashkëta. Ky bashkëpunim synon edhe promovimin e punimeve shkencore të shërbimeve financiare inovatore për të gjithë llojet e investitorëve, sjelljen e ideve inovatore në shërbim të politikave të zhvillimit për një vendimmarrje të drejtë dhe të mbështetur në punime kërkimore dhe shkencore.

SHKURT 2023 – Grupi Eurosig-Insig-UBA akordoi 30 000 Euro në ndihmë të familjeve të dëmtuara nga tërmetet shkatërruese në Turqi. Presidenti i Grupit, z. Kadri Morinaj, shprehu keqardhje maksimale për situatën e krijuar dhe uroj që familjet e dëmtuara të rikuperohen sa më shpejt.

MARS 2023 – Kontribut për trajnimin e studentëve të Universitetit Epoka me njohuri rreth industrisë së sigurimeve dhe menaxhimit të riskut, zhvilluar më 24 janar – 18 shkurt 2023. Në ceremoninë e përmbylljes së trajnimit morën pjesë Presidenti i Grupit, z. Kadri Morinaj, Rektori i Universitetit Epoka, Prof. Dr.



**Mbi 50 punonjës
të Grupit Eurosig-
Insig-UBA u bënë
pjesë e trajnimit
I LOVE MY BUSINESS**

Ahmet Oztas, Menaxhimi i Lartë i Grupit Eurosig-Insig-UBA, si dhe pedagogë e studentë të Universitetit Epoka. Trajnimi paraqiti një mundësi të shkëlqyer për studentët e të gjitha programeve të studimit për të patur një qasje teorike mbi sigurimet, si dhe për mundësitë që ofrohen në tregun e punës nga industria e sigurimeve në Shqipëri. Referimi i temave u bë nga zonjat Agena Mema, Venera Xhillari, Anila Ibro, Areta Çuko dhe Albiola Tako, profesioniste në fushat e tyre dhe me ekspertizë mbi 15-vjeçare. Grupi Eurosig-Insig-UBA dha 5 çmime për studentët e vlerësuar më mirë nga ky trajnim, si dhe akordoi Bursa të Plota Masteri për disa studentë ekselentë. Në mbyllje të ceremonisë, Presidenti i Grupit, z. Kadri Morina, mbajti një fjalim inkurajues për studentët, duke evidentuar momentet kryesore në rrugëtimin e tij në fushën e biznesit. Ai theksoi: “Dyert e Grupit Eurosig-Insig-UBA janë të hapura për çdo student që ka dëshirë të punojë dhe të rritet profesionalisht”.

PRILL 2023 – Shumë punonjës të Grupit Eurosig-Insig-UBA morën pjesë në trajnimin I LOVE MY BUSINESS, një Event dy ditor LIVE nga Ermal Mamaqi dedikuar rritjes dhe zhvillimit në karrierë, biznes dhe jetë. I ftuar në këtë event, Presidenti i Grupit, z. Kadri Morina, foli për rrugëtimin e Tij të suksesshëm në biznes dhe u bëri thirrje të rinjve të mos emigrojnë, por të japin kontributin e tyre për t’u rritur profesionalisht dhe për ta bërë Shqipërinë një vend më të mirë për brezat që do vijnë.

PRILL 2023 – Pjesëmarrje në Panairin e Punës 2023, në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës, me qëllim nxitjen e gatishmërisë dhe përgatitjen për tregun e punës të studentëve të këtij fakulteti. Interesi dhe dëshira e studentëve për të qenë pjesë e Grupit Eurosig-Insig-UBA ishte shumë e lartë. Mbi 220 studentë aplikuan për t'u bërë pjesë e familjes tonë, si kandidatë potencialë për punësim apo praktikë mësimore.

PRILL 2023 – Mbështetje për Konferencën Ndërkombëtare “Sfidat në Ballkanin Perëndimor: Infrastruktura dhe Zhvillimi në Rajon”, të organizuar nga Universiteti EPOKA, së bashku me Këshillin Global të Dekanëve të Inxhinierisë (GEDC) dhe Federatën Ndërkombëtare të Shoqërive të Edukimit Inxhinierik (IFEES). Akademikë, drejtues të industrive, studiues, profesorë, doktorë, organe qeveritare dhe organizata joqeveritare morën pjesë në këtë konferencë ndërkombëtare inovative. Në një panel drejtuesish kompanish ndërkombëtare, ishte i ftuar edhe Presidenti i Grupit Eurosig-Insig-UBA, z. Kadri Morinaj, i cili shpjegoi sfidat dhe nevojën e zhvillimit të tregut, veçanërisht të industrisë së sigurimeve. Z. Morinaj shprehu shqetësimin e tij edhe për largimin e trurit dhe fuqisë punëtore nga Shqipëria.

PRILL 2023 – Grupi Eurosig-Insig-UBA shtroi një darkë madhështore tek Bar Restorant “Piazza” për pjesëmarrësit nga shumë vende të botës në Konferencën Ndërkombëtare “Sfidat në Ballkanin Perëndimor: Infrastruktura dhe Zhvillimi në Rajon”. Gjatë mbrëmjes Presidenti i Grupit, z. Kadri Morinaj, u vlerësua me një çmim të veçantë nga Dr. Ahmet Oztas (Rektor i Universitetit Epoka), Dr.



“
Marrëveshje
me Fakultetin e
Ekonomisë për
përvojat me interes
të përbashkët



Sunil Maharaj (President i GEDC) dhe Dr. Hans Hoyer (Drejt看 Ekzekutiv i IFEEES dhe GEDC) për kontributin, bujarinë dhe vlerat kombëtare të treguara gjatë dy ditëve të konferencës. Gjithashtu, z. Morinaj u vlerësua për mikpritjen nga Dr. Michael Milligan, President i ABET Engineering Accreditor – SHBA, nga Paul Gilbert, CEO of Quanser – Kanada etj.

MAJ 2023 – Pjesëmarrje në Panairin e Karrierës, me qëllim nxitjen e gatishmërisë dhe përgatitjen për tregun e punës të studentëve të Universitetit Epoka, një ndër universitetet më prestigjioze në vend. Studentëve iu ofrua mundësia për të qenë pjesë e stafeve të kompanive të Grupit Eurosig-Insig-UBA. Të shumtë ishin ata që aplikuan për t’u bërë pjesë e familjes tonë, si kandidatë potencialë për punësim apo praktikë mësimore.

MAJ 2023 – Mbështetje e Festivalit Folklorik “Hasi Jehon” në organizimin e Edicionit të 34-ët, i cili u mbajt në fshatin Gjonaj, në Kosovë. Presidenti i Grupit, z. Kadri Morinaj, përshëndeti këtë festival dhe konfirmoi mbështetjen edhe për vitet e ardhshme.

MAJ 2023 – Grupi Eurosig-Insig-UBA mundësoi organizimin e 5-vjetorit të krijimit të Këshillit të Ambasadorëve Shqiptarë. Në këtë event mori pjesë edhe Delegacioni i Këshillit të Ambasadorëve Amerikanë. Presidenti i Grupit, Z. Kadri Morinaj, u nderua nga Këshilli i Ambasadorëve Amerikanë me Medaljen “Benjamin Franklin, Ambasadori i Parë Amerikan”, për mikpritjen e veçantë dhe të ngrohtë në Shqipëri. Zoti Morinaj i siguroi Ambasadorët nga SHBA që dyert e tij do të jenë gjithmonë të hapura për ta.




”

Eurosig mundësoi eventin për 5-vjetorin e krijimit të Këshillit të Ambasadorëve Shqiptarë

PJESËMARRJET E EUROSIG SH.A. NË KAPITALIN E SHOQËRIVE TË TJERA

Eurosig sh.a zotëron 100% të kapitalit të shoqërive të sigurimeve Insig Jo-Jetë sh.a. dhe Insig Jetë sh.a., në Republikën e Shqipërisë, dhe Eurosig sh.a, në Republikën e Kosovës. Gjatë vitit 2022, Eurosig sh.a. rriti pjesëmarrjen e aksioneve pranë Bankës së Bashkuar të Shqipërisë nga 51.02% në 65.58%.

LISTA E AKSIONARËVE TË EUROSIG ME PJESËMARRJE INFLUENCUESE TË KAPITALIT



LISTA E ADMINISTRATORËVE TË EUROSIG

Administrator (Drejtor i Përgjithshëm) i Eurosig është z. Xhevdet KOPANI, i cili nuk është pjesëmarrës në kapitalin e shoqërisë.



**Auditimi i Brendshëm
në vazhdimësi ka
kontrolluar dhe
audituar ecurinë e
punës në Eurosig**

OPINION I SHKURTUAR MBI AUDITIMIN E BRENDSHËM

Auditimi i brendshëm për vitin 2022 në shoqërinë e sigurimeve “Eurosig sha” është zhvilluar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm dhe Manualin e Auditimit të Brendshëm, si dhe në zbatim të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, të Rregullores nr. 153, datë 23. 12. 2014, “Për veprimtarinë e Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe Komitetit të Auditimit në Shoqërinë e Sigurimit”, të Rregullores nr. 7, datë 30. 01. 2015, “Për Sistemin e Kontrollit të Brendshëm në Shoqërinë Eurosig sha” dhe të “Planit të Auditimit të Brendshëm për vitin 2022” të shoqërisë, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës.

Njësia e Auditimit të Brendshëm, në vazhdimësi gjatë gjithë vitit 2022, ka kontrolluar dhe audituar ecurinë e punës në fushat kryesore të veprimtarisë së Eurosig. Pas shqyrtimit dhe miratimit në Komitetin e Auditimit dhe Menaxhimit të Riskut, Raporti Vjetor i Auditimit të Brendshëm 2022 u shqyrtua dhe miratua edhe nga Këshilli Mbikëqyrës. Raporti u është shpërndarë për njohje dhe zbatim të gjitha strukturave të Eurosig.

Departamenti i Marrjes në Sigurim. Gjatë vitit 2022 kompania ka pasur rritje të primeve në masën rreth 12.5%. Raporti sigurime të detyrueshme/sigurime vullnetare është 82% me 18%, kundrejt objektivit të vendosur 74% me 26%. Nga analiza e këtij treguesi për vitet e fundit, vihet re një trend në rënie i tij, pa- varësisht objektivit të kompanisë dhe fokusit në rritjen e shitjeve të produkteve vullnetare. Nëse analizojmë sipas njësive të shitjes, rezulton se kontributin më të madh në shitje e kanë dhënë njësitë e Tiranës, Durrësi dhe Pogradeci. Pa- varësisht performancës së mirë të disa njësive, objektivi i vendosur lidhur me produktet vullnetare nuk është realizuar pothuajse në asnjë njësi.

Gjatë vitit 2022, është konstatuar rënia e shpenzimeve të marrjes në sigurim krahasuar me vitin e mëparshëm, kjo për shkak të rënies së nivelit të komision- eve të aplikuara, si rezultat i kufizimeve të vendosura nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, i cili ka përcaktuar nivelin maksimal të shpenzimeve të marrjes në sigurim për produktet motorike deri në 20%. Niveli i shpenzimeve është ulur, ndërkohë që shitjet rezultojnë me rritje, çka tregon se rënia e shpenzimeve nuk ka ndikuar negativisht në nivelin e shitjeve, ndaj ky është një tregues që duhet mbajtur në konsideratë me qëllim që shpenzimet e marrjes në sigurim të mba- hen në nivelin e duhur dhe të jenë efektive.

Është rritur kontrolli i ushtruar nga strukturat e marrjes në sigurim në bash- këpunim dhe me Drejtorinë e Administrimit të Shitjeve dhe, si rezultat i kësaj, ka pasur një përmirësim të dukshëm lidhur me: zbatimin e procedurave të marrjes në sigurim, kushtet e kontratave të sigurimit etj. Përg- jithësisht, është vlerësuar saktë risku i klientëve dhe përcaktimi i primeve është bërë në përputhje me riskun. Janë organizuar trajnime, si dhe është rritur bashkëpunimi me strukturat vendore në funksion të identifikimit të mundësive të zgjerimit të tregut. Të dhënat e shitjeve janë pasqyruar saktë në sistemin e brendshëm të kompanisë dhe janë kryer rakordimet përkatëse çdo muaj ndërm- jet strukturave të brendshme (Drejtorisë së Administrimit të Shitjeve dhe Departamentit Ekonomik). Raportimi periodik në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare është kryer kon- form udhëzimeve.



**Gjatë 2022
kompania ka
pasur rritje të
primeve në
masën rreth
12.5 për qind**

Drejtori të tjera të kompanisë. Gjatë vitit 2022, janë hartuar dhe miratuar një sërë aktesh të brendshme me qëllim që të arrihet përputhshmëria e plotë me bazën ligjore dhe rregullatore. Janë rishikuar struktura organizative e Grupit Financiar Eurosig-Insig-UBA dhe Rregullorja “Për organizimin dhe funksionimin e Grupit”, është përditësuar “Manuali i Marrjes në Sigurim” etj. Janë bërë përmirësime në Sistemin e Brendshëm në funksion të përshtatjes së tij me kërkesat e palëve të treta dhe strukturave të kompanisë, si dhe ofrimit të një shërbimi më të mirë për klientët. Janë të implementuar në sistem moduli i shitjeve, moduli i dëmeve dhe moduli financiar. Këto module janë të integruar me njëri-tjetrin, çka ka ndikuar në përmirësimin e procedurave të punës dhe në uljen e riskut të mashtrimit dhe gabimit njerëzor, si rezultat i transferimit automatik të të dhënave nga një modul në tjetrin.

Strukturat e Trajtimit të Dëmeve funksionojnë mbi bazën e rregulloreve, udhëzimeve dhe urdhrave të brendshëm të kompanisë. Gjatë vitit 2022 është arritur që, sipas udhëzimeve nga Drejtoria e Përgjithshme, të trajtohen e të dëmshpërblehen klientët brenda afateve të përcaktuara. Janë trajtuar me prioritet rastet e



klientëve, të cilët nuk kanë qenë dakord me dëmshpërblimet, të cilat janë diskutuar në komisionet e posaçme me qëllim që t'u shërbehet sa më mirë klientëve dhe të kryhet vlerësim sa më i drejtë. Përgjithësisht, praktikat janë plotësuar me dokumentacionin e nevojshëm dhe gjatë trajtimit rezulton se janë zbatuar kushtet e kontratave të sigurimit. Është rritur numri i praktikave të zgjidhura me marrëveshje, gjë që ka ndikuar në përmirësimin e treguesit të rezervës së dëmeve në proces gjyqësor, si dhe respektimin e afateve kohore të trajtimit të praktikave.

Drejtoria Juridike është angazhuar në ndjekjen e proceseve gjyqësore të kompanisë Eurosig, si dhe ndjekjen e proceseve gjyqësore të rasteve të Fondit të Kompensimit për llogari të Byrosë Shqiptare të Sigurimit. Stafi i juristëve kanë ndjekur të gjithë proceset gjyqësore të kompanisë dhe kanë bashkëpunuar me ekspertë të fushave përkatëse (mjek, vlerësuesi i dëmeve etj.), me qëllim mbrojtjen sa më të mirë të interesave të kompanisë. Përgjithësisht, rezultatet e gjyqeve kanë qenë në favor të kompanisë, gjë që tregon punën e kujdesshme të bërë edhe nga punonjësit e strukturave të trajtimit të dëmeve.

Statistika. Të dhënat lidhur me shitjet, anulimet, kthimet, dëmtimet e policave janë të pasqyruara saktë në sistemin e brendshëm të kompanisë dhe janë raportuar saktë në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare. Të dhënat lidhur me praktikat e dëmeve janë pasqyruar saktë në databazën e dëmeve, si dhe janë raportuar saktë në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare. Janë respektuar afatet e dërgimit të evidencave ndërmjet strukturave, si dhe afatet e dërgimit në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.

Mbrojtja nga Risku. Shoqëria Eurosig sh.a. gjatë vitit 2022 ka hartuar "Strategjinë për Menaxhimin e Riskut", në të cilën janë përcaktuar sistemi, politika dhe parimet e menaxhimit të riskut. Në këtë strategji është përcaktuar në mënyrë të plotë procesi i menaxhimit të riskut, përgjegjësitë dhe detyrat e strukturave të kompanisë për identifikimin dhe menaxhimin e risqeve. Në procesin e vlerësimit të risqeve janë të përfshira të gjitha strukturat e kompanisë, të cilat raportojnë në strukturën e menaxhimit të riskut çdo 3 muaj. Përfshirja e vet strukturave në këtë proces ka pasur impakt pozitiv në identifikimin e risqeve në



**Ka shënuar
rritje numri
i praktikave
të dëmeve të
zgjidhura me
marrëveshje**



kohë dhe marrjen e masave për reduktimin apo eliminimin e tyre.

Funksioni i Manaxhimit të Riskut ka hartuar “Raportin e Vetëvlerësimit të Riskut dhe Aftësisë Paguese”, në të cilin janë identifikuar dhe vlerësuar nivelet e risqeve, ndaj të cilave është e ekspozuar shoqëria, si dhe janë dhënë rekomandimet e nevojshme për menaxhimin e tyre, me qëllim reduktimin e risqeve të identifikuar, si dhe parandalimin e ekspozimit ndaj risqeve në të ardhmen.

Në përgjithësi ka funksionuar sistemi i kontrollit të brendshëm brenda departamenteve dhe njësive të audituara, si në drejtim të hartimit të procedurave, menaxhimit të shpenzimeve dhe administrimit të dokumentacionit. Ka pasur një përmirësim të procedurave të kontrollit të ushtruar nga Departamenti i Marrjes në Sigurim lidhur me zbatueshmërinë e procedurave të marrjes në sigurim, administrimin e policave dhe, si rezultat i kësaj, problematikat janë evidentuar përgjithësisht në kohë dhe janë marrë masa për zgjidhjen e tyre. Ky sistem me procedurat dhe verifikimet përkatëse ka ndikuar në identifikimin, kontrollin dhe administrimin e risqeve që mbulojnë dhe menaxhojnë departamentet dhe njësitë e audituara.



MONITORIMI, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I RISKUT QË NDËRMERR EUROSIG

Eurosig ka implementuar një sistem të plotë për menaxhimin e riskut të shpërndarë në të gjitha nivelet, për të identifikuar, vlerësuar, mbikëqyrur, menaxhuar dhe raportuar në vijimësi risqet me të cilat është përballur ose mund të përballlet Shoqëria. Strukturat e Eurosig zbatojnë elementët e këtij sistemi, duke u bazuar në kuadrin ligjor e rregullator në fuqi, si dhe në natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e veprimtarisë së Shoqërisë. Për rregullimin dhe normimin e punës së strukturave të Eurosig, në drejtim të pranimin dhe menaxhimit të riskut, organet qeverisëse kanë nxjerrë një paketë aktesh të brendshme, në përputhje me përcaktimet ligjore dhe rregullatore. Organet drejtuese, menaxhmenti dhe çdo punonjës ka të përcaktuar qartë përgjegjësitë dhe kufizimet e autoritetit të tij, në lidhje me riskun dhe menaxhimin e tij.

Sistemi i menaxhimit të riskut në Eurosig bazohet në mirëfunksionimin e organeve qeverisëse dhe të tre linjave të mbrojtjes: Funkzionet Operacionale, që përfaqësojnë linjën e parë të mbrojtjes dhe kanë përgjegjësinë bazë për menaxhimin e risqeve që lidhen me fushën e tyre të përgjegjësisë; funksionet e Menaxhimit të Riskut, të Aktuarit të Autorizuar dhe të Pajtueshmërisë, që përfaqësojnë linjën e dytë të mbrojtjes; funksioni i Auditimit të Brendshëm, i cili përfaqëson linjën e tretë të mbrojtjes.

Në Strategjinë për Menaxhimin e Riskut në Eurosig janë përcaktuar sistemi, politika dhe parimet e menaxhimit të riskut, procesi i menaxhimit të riskut, përgjegjësitë për menaxhimin e riskut, si dhe rrugët që do ndiqen për zbatimin e kësaj strategjie. Strukturat përgjegjëse të krijuara për të ushtruar funksionin e administrimit të riskut janë Komiteti i Auditimit&Menaxhimit të Riskut, Njësia e Auditimit, Drejtoria e Menaxhimit të Riskut, Komiteti i Investimeve, Komiteti i Risigurimit dhe Komiteti i Vlerësimit të Dëmeve.

Drejtoria e Menaxhimit të Riskut, nëpërmjet Drejtorit të Përgjithshëm, komunikon me Këshillin Mbikëqyrës dhe Komitetin e Auditimit&Menaxhimit të Riskut në lidhje me vlerësimin e ekspozimeve ndaj riskut dhe masat që duhen marrë për menaxhimin e tyre, vlerësimin e ndryshimit në profilin e riskut, vlerësimin e ngjarjeve të riskut, si dhe përcaktimin e veprimeve të përshtatshme për ndreqje të situatës.



Eurosig aplikon metodologji dhe praktika bashkëkohore për identifikimin, klasifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e risqeve

Eurosig aplikon metodologji dhe praktika bashkëkohore për identifikimin, klasifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e risqeve, në koherencë me kërkesat e AMF-së, të përcaktuara në Manualin e Mbikëqyrjes së Shoqërive të Sigurimit dhe akte të tjera rregullatore. Drejtoria për Menaxhimin e Riskut, në koordinim me strukturat qendrore dhe vendore, çdo vit identifikojnë risqet ndaj të cilëve është e ekspozuar veprimtaria e Eurosig dhe që përbëjnë kërcënim për realizimin e objektivave vjetore. Procesi vjetor i Menaxhimit të Riskut në Eurosig u finalizua me Raportin “Vetëvlerësimi i Riskut dhe Aftësisë Pagueuse për vitin 2022”. Raporti u është shpërndarë autoriteteve mbikëqyrëse, ekzekutive dhe menaxheriale.

Gjithashtu, sipas përcaktimeve në aktet rregullatore, u hartua edhe Raporti “Mbi Vlerësimin e Risqeve në Eurosig për vitin 2022”. Raporti, pas shqyrtimit dhe miratimit nga Komiteti i Auditimit&Menaxhimit të Riskut dhe Këshilli Mbikëqyrës, është dërguar në AMF.

Për vitin 2022, nga analiza e të gjitha risqeve të identifikuar dhe vlerësuar, rezulton:

- Risku i Kreditit, Risku i Normës së Interesit (i trajtuar te Risku i Tregut), Risku i Dizenjimit të Produktit dhe i Vendosijes së Çmimit (i trajtuar te Risku i Sigurimit), Risku Operacional (përkatësisht Risku i Trajtimit të Dëmeve dhe Risku i Mashtrimit), Risku i Likuiditetit, Risku Ligjor&Rregullator, Risku Strategjik, Risku i Drejtimit të Brendshëm&Menaxhimit dhe Risku i Aftësisë Pagueuse klasifikohen në nivelin i ulët.
- Risku i Tregut (përkatësisht Risku i Këmbimit të Monedhës së Huaj), Risku i Sigurimit (përkatësisht Risku i Marrjes në Sigurim dhe i Përgjegjësisë) dhe Risku i Teknologjisë së Informacionit (i trajtuar te Risku Operacional) klasifikohen në nivelin mesatar.
- Vlerësimi i Drejtimit të Brendshëm dhe Menaxhimit të Riskut në nivelin i fortë jep garanci për menaxhimin me efektivitet dhe zbutjen e risqeve ndaj të cilëve ekspozohet Eurosig.
- Sipas vlerësimeve të institucioneve rregullatore, treguesit kryesorë të stabilitetit financiar për vitin 2023 pritet të mbeten në kontroll; rritja ekonomike e vendit do të vijojë të ushqehet nga bilancet e shëndetshme të sektorit privat, nga reduktimi i pasigurisë dhe nga një ambient financiar ende akomodues. Shqetësimi kryesor për të ardhmen e afërt lidhet me paqartësitë dhe pasiguritë e rritura për shkak të zhvillimeve gjeopolitike.

Autoritetet qeverisëse dhe menaxheriale të Eurosig janë të angazhuara për ndjekjen me prioritet të çështjeve të evidencuara për secilin risk kryesor, veçanërisht për menaxhimin me efektivitet të risqeve të identifikuar si kërcënim për realizimin e objektivave të shoqërisë.

TREGUESIT E MJAFTUESHMËRISË SË DHE TË AKTIVEVE NË MBULIM TË

TREGUESI I MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT, MË 31. 12. 2022

Nr.	Emërtimi	Vlera në lekë
I	Kapitali bazë, Neni 76 i Ligjit 52/14 (I.a+I.b+I.c-II).	2,703,024,569
II	Elementet që nuk përfshihen në llogaritjen e kapitalit bazë: (II.a+II.b+II.c+II.ç).	0
III	Kapitali shtesë, neni 77 i Ligjit 52/14 (III.a+III.b+III.c+III.ç).	0
IV	Elementet e zbritshme në llogaritjen e kapitalit, neni 79 i Ligjit 52/14 (IV.a+IV.b+IV.c+V).	528,198,645
V	Aktivët jolikuide (V.a deri V.g).	524,278,645
V.h.	Elementë të tjerë të zbritshëm, sipas nenit 4 të kësaj rregulloreje (V.-h-1 deri V.h-10).	390,025,771
VI	Kapitali (Aftësia Pague).	2,174,825,924
VII	Kufiri minimal i aftësisë pague, sipas pikës 3 të nenit 80 të Ligjit Nr. 52/2014.	380,921,283
XIII	Fondi i garancisë, sipas nenit 81 të Ligjit Nr. 52/2014.	370,000,000
IX	Niveli i kërkuar i aftësisë pague, sipas pikës 2 të nenit 80 të Ligjit Nr. 52/2014.	571,381,925
X	Mbi (+)/nën (-) nivelin e kërkuar të Aftësisë Pague (VI-IX).	1,603,443,999
XI	Mjaftueshmëria e kapitalit.	I mjaftueshëm

KAPITALIT, TË LIKUIDITETIT

PROVIGJONEVE TEKNIKE

TREGUESI I LIKUIDITETIT

Treguesi i Raportit të Likuiditetit raportohet periodikisht në AMF, sipas përcaktimeve në aktet ligjore dhe rregullatore. Shoqëria Eurosig është likuide dhe zotëron normë shumë të mirë likuiditeti pasi rezultati i llogaritjes së normës së likuiditetit, referuar nenit 6, pika 1, të Rregullores “Mbi administrimin e likuiditetit nga shoqëritë e sigurimit”, rezulton më i lartë ose i barabartë me 1.

TREGUESI I AKTIVEVE NË MBULIM TË PROVIGJONEVE TEKNIKE (PT), MË 31. 12. 2022

Nr.	Emërtimi	Vlera e lejuar në mbulim të PT (në lekë)
I	Aktivët e lejuara në mbulim të provigjoneve teknike, të ndryshme nga ato matematike, sipas nenit 97 të Ligjit 52/14.	4,857,611,153
II	Investime të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike, të ndryshme nga ato matematike, për të cilat është marrë miratimi paraprak i Autoritetit.	-
III	Investime të tjera të lejuara sipas Rregullores nr. 19, datë 28.04.2015, neni 4.	930,194,993
IV	Totali i Investimeve (I+II+III).	5,787,806,146
V	Totali i Investimeve të Lejuara (Totali i “Vlera në fakt” zbritur “Investime mbi limitet e lejuara”).	5,642,711,732
VI	Provigjone teknike, të ndryshme nga ato matematike, bruto (VI.1 deri VI.5).	3,226,720,976
VII	Tepricë (+) /Mungesë (-) (V-VI).	2,415,990,757
VIII	Mbulimi në % (V/VI)	174.87%

OBJEKTIVAT PËR VITIN 2023

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

- 1) Rritja me 15%, krahasuar me vitin 2022, e volumit të primeve të shkruara bruto, duke garantuar rritje të kapitalit financiar, të performancës ekonomike, të aftësisë paguese, të rezervave, si dhe përsosur sistemin e kontrollit të brendshëm dhe sistemin e menaxhimit të riskut.
- 2) Në fundin e vitit 2023, raporti i volumit të primeve të shkruara bruto në sigurimin vullnetar me volumen e primeve të shkruara bruto në sigurimin e detyrueshëm të jetë në masën 23% me 77%.
- 3) Shpenzimet për vitin 2023 të jenë jo më shumë se 95% e të ardhurave.
- 4) Rritja e volumit të dëmeve të paguara duke synuar vlerësim të drejtë, pagesë të shpejtë, si dhe rritje deri në 30% të raportit të volumit të dëmeve të paguara me volumen e primeve të shkruara bruto, deri në fund të vitit 2023.
- 5) Vënia në funksionim e site paralel që do të përdoret për menaxhimin e shoqërisë në rastin e katastrofave natyrore; hartimi, miratimi dhe testimi i Planit të Vazhdueshmërisë së Biznesit në raste katastrofash.

OBJEKTIVAT SPECIFIKE

- 1) Nëpërmjet zhvillimit dhe drejtpeshimit të roleve të menaxhimit të performancës, të administrimit, të sipërmarrjes dhe të integritetit të sigurojmë që shoqëria Eurosig të jetë efektive, efiçente, proaktive dhe organike.
- 2) Zbatimi i proceseve qeverisëse të institucionalizuara, nxitja e mundësive të reja dhe menaxhimi proaktiv i ndryshimeve në tregun e sigurimeve, duke ruajtur vlerat themelore dhe avantazhin e Eurosig.
- 3) Forcimi i auditimit dhe sistemit të kontrollit të brendshëm.
- 4) Segmentimi i klientëve, duke u përqendruar fort tek produktet vullnetare, nëpërmjet burimeve njerëzore me formimin e duhur profesional, kombinuar me politika efektive marketingu.



Segmentim i klientëve, duke u përqendruar tek produktet vullnetare

- 5) Zbatimi rigoroz i politikave dhe procedurave standarde për marrjen në sigurim dhe risigurimin, me bazë riskun, duke synuar uljen e produkteve me humbje teknike.
- 6) Rishikimi dhe përmirësimi i kushteve të sigurimit të produkteve vullnetare, duke konsideruar problematikat e identifikuara në procesin e marrjes në sigurim dhe trajtimin e dëmeve.
- 7) Rishikimi i termave të marrëveshjeve të risigurimit, në lidhje me mjaftueshmërinë e mbulimit, duke reflektuar ndikimet e faktorëve të jashtëm dhe çështjet e identifikuara nga trajtimi periodik i dëmeve.
- 8) Rritja e bashkëpunimit të strukturave të Trajtimit të Dëmeve me strukturat qendrore dhe vendore, përditësimi i njohurive mbi legjislacionin dhe teknologjinë bashkëkohore në përdorim, me qëllim vlerësimin e drejtë dhe pagesën e dëmit brenda afateve të përcaktuara në aktet rregullatore.
- 9) Ulja e numrit të praktikave pezull, nëpërmjet trajtimit në afat, njoftimit të klientit në të gjitha format ligjore, si dhe pagesat në afatet ligjore të përcaktuara.
- 10) Rritja e efektivitetit të burimeve njerëzore në fushën e intervistimit të klientëve dhe investigimit të rasteve të dyshimta, me qëllim zbulimin e rasteve të mashtrimit.

- 11) Shfrytëzimi i të gjitha kapaciteteve të programit informatik e-Insure nga strukturat qendrore dhe vendore të Eurosig, duke bërë dhe zhvillimet dhe përmirësimet e nevojshme, sipas çështjeve të evidentuara nga menaxhmenti.
- 12) Fuqizimi i kapaciteteve të Teknologjisë së Informacionit të Eurosig nëpërmes vijimit të: zgjerimit të rrjetit të brendshëm, përmirësimit të sistemit të virtualizimit, përmirësimit të administrimit të informacionit dhe raporteve në sistemin e-Insure, përmirësimit të infrastrukturës së mbrojtjes nga sulmet kibernetike (Firewall), zhvillimeve të tjera dhe mirëmbajtjes së projektit “Shërbim Klienti”, vijimit të procesit të licencimeve dhe upgrade-imeve të pajisjeve informatike dhe rrjetit.
- 13) Menaxhimi i kujdesshëm i shpenzimeve në tërësi, veçanërisht i shpenzimeve të përgjithshme, me objektiv rritjen e fitimit, duke siguruar një aftësi paguese të qëndrueshme, si dhe aktive të mjaftueshme në mbulim të provigjoneve teknike.
- 14) Trajnimi periodik i burimeve njerëzore, me synim konsolidimin e arritjeve dhe avancimin e mëtejshëm në përputhje me Strategjinë e Eurosig.
- 15) Pjesëmarrja në veprimtari që kontribuojnë në qëndrueshmërinë mjedisore dhe sociale.

“
Zbatim rigoroz
i politikave dhe
procedurave
standarde për
marrjen në
sigurim



OPINIONI I SHOQËRISË AUDITUESE DHE PASQYRAT FINANCIARE SIPAS SNRF

Eurosig sh.a

**Pasqyrat Financiare Individuale dhe Raporti i Audituesit të Pavarur
Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022**

Përmbajtja

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

PASQYRA INDIVIDUALE E POZICIONIT FINANCIAR

PASQYRA INDIVIDUALE E FITIMIT OSE HUMBJES DHE E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE

PASQYRA INDIVIDUALE E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL

PASQYRA INDIVIDUALE E FLUKSEVE TË PARASË

SHËNIMET PËR PASQYRAT FINANCIARE INDIVIDUALE



Emin Duraku Str. Binjaket Build.
No.5, 1009, Tirana
Albania
Tel: +355 4 2222 889
www.mazars.al

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar: Menaxhimit dhe Aksionarëve të shoqërisë EUROSIG SHA

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare individuale ("Pasqyrat financiare") të Shoqërisë **EUROSIG sh.a.** (Shoqëria) të cilat përfshijnë pasqyrën individuale të pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2022, pasqyrën individuale të fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën individuale të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën individuale të flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2022, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Bazat për Opinion

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështje për t'u theksuar

Ne tërheqim vëmendjen në shënimin 2.4 të pasqyrave financiare individuale në të cilën paraqitet informacion mbi vendimin numër 80-2019-274 datë 01.02.2019 të marrë nga Gjykata Administrative e Shkallës së parë Tirane e cila ka pranuar padinë e Shoqërisë ndaj Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për shfuqizimin e aktit administrativ, nr. 162 datë 30.07.2018 të Bordit të AMF-së dhe masat e marra sipas atij vendimi, si edhe padinë për detyrimin ndaj AMF-së për njohjen e investimit të kryer në blerjen e aksioneve në shoqëritë e kontrolluara, si aktive në mbulim të provizioneve teknike dhe aftësisë paguese. Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 2254 (86-2019-2581) datë 12.07.2019, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, duke e kthyer atë në titull ekzekutiv, të detyrueshëm për zbatim. Për pasojë, prej 3 mujorit të dytë të vitit 2019 ka përfshirë në përllogaritjet e treguesve rregullatore investimet në shoqëritë e kontrolluara, gjë e cila ka ndikuar ndjeshëm në përmirësimin e treguesve rregullatorë. AMF ka bërë rekurs në Gjykatën e Lartë për këtë vendim. .



Informacione të tjera

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe publikimin e informacioneve të tjera. Informacione të tjera të marrë në datën e këtij raporti auditimi janë “Aneke shoqëruese suplementare”, por nuk përfshihen në pasqyrat financiare dhe raportin e auditimit

Opinionin ynë për pasqyrat financiare nuk përfshin informacione të tjera dhe ne nuk ofrojmë asnjë siguri mbi to.

Si pjesë e auditimit, është përgjegjësia jonë të lexojmë këto informacione të tjera dhe të vlerësojmë nëse, bazuar në informacionet e marra gjatë auditimit tonë, ai përmban ndonjë mospërputhje materiale me pasqyrat financiare ose ndonjë gabim material të dukshëm. Nëse konkludojmë se ekziston një gabim material të fakteve në informacione të tjera, duhet ta raportojmë atë fakt.

Sikurse është paraqitur në anekset suplementare Shoqëria ka llogaritur raportin e “Aktivet në mbulim të Provigjoneve Teknike” dhe raportin mbi “Mjaftueshmërinë e Kapitalit.

Ne nuk kemi asgjë për të raportuar në këtë drejtim.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare Individuale

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare individuale në përputhje me SNRF, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare individuale, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare Individuale

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare individuale në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre

mazars

rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.

- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënime shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënime shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare individuale dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

28 prill 2023



Teit Gjini
Auditues Ligjor

mazars

Emin Duraku Str., Binjaket Build.,
No.5, 1013, Tirana, Albania
NUIIS: K32123006W

Eurosig sh.a.

Pasqyrat Financiare Individuale më 31 dhjetor 2022

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

Pasqyra Individuale e Pozicionit Financiar më 31 dhjetor 2022

	Shënime	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
AKTIVE			
Aktive afat-gjata materiale	6	214,414	228,820
Aktive afat-gjata jomateriale	7	6,017	4,686
Të drejta të përdorimit të aseteve	8	75,005	10,854
Depozita me afat	9	486,673	490,410
Pjesa e risiguruesit në provigjionet e kontratave të sigurimit	10	364,933	289,362
Llogari të arkëtueshme nga sigurimi dhe risigurimi	11	119,640	56,265
Kosto të shtyra të marrjes në sigurim	12	341,024	472,824
Investime në shoqëri të kontrolluara	13	4,614,695	3,560,502
Investime në tituj kapitali të shoqërive të tjera	14	3,920	482,002
Aktive në proces		299,848	-
Aktive të tjera	15	172,226	198,523
Tatim fitim		7,097	-
Mjete monetare dhe ekuivalente	16	3,839	12,214
Totali i aktiveve		6,709,331	5,806,462
KAPITALI			
Kapitali i Nënshkruar	21	2,765,650	2,765,650
Rezerva rivlerësimi		154,345	154,345
Rezerva të tjera	22	10,334	10,334
Fitime / Humbje të akumuluar		(434,927)	(229,568)
Rezerva për investime		-	-
Fitimi / Humbja e vitit financiar		207,622	(205,359)
Totali i kapitalit		2,703,024	2,495,402
DETYRIMET			
Provigjione për kontratat e sigurimit	17	3,226,721	2,653,685
Detyrime të qirasë financiare	18	74,344	11,984
Të ardhura të papërfituara		56,659	-
Provizione të tjera		29,301	-
Llogari të pagueshme për sigurimin, risigurimin dhe të tjera	19	502,528	530,854
Detyrim për Fondi kompesimi	20	116,754	114,517
Detyrimi për tatimin mbi fitimin		-	20
Totali i detyrimeve		4,006,307	3,311,060
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		6,709,331	5,806,462

Shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 50 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare individuale.

Pasqyrat financiare individuale u miratuan nga bordi drejtues i Shoqërisë më 24 prill 2023, dhe janë firmosur në emër të tij nga Drejtori i Përgjithshëm dhe Drejtori Departamentit Ekonomik

Z. Xheydet Kopani

Drejtori i Përgjithshëm

**Zh.j. Anila Ibro**

Drejtori i Departamentit Ekonomik

Eurosig sh.a.

Pasqyrat Financiare Individuale më 31 dhjetor 2022

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

Pasqyra Individuale e Fitimit ose Humbjes dhe e të Ardhurave Gjithpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Primet e shkruara bruto	23	2,605,983	2,316,620
Primet e ceduara në risigurim	23	(126,310)	(81,362)
Total të ardhura	23	2,479,673	2,235,258
Ndryshimi në provigjionin e primeve të pafituara bruto (+/-)	23	(152,728)	(129,503)
Ndryshimi në provigjionin e primeve të pafituara, pjesa e risiguresve (+/-)	23	18,238	(4,943)
Prime të fituara neto	23	2,345,183	2,100,812
Të ardhura nga tarifat dhe komisionet-neto	24	7,322	4,779
Të ardhura financiare dhe nga investimet	25	(4,891)	13,138
Shpenzime financiare dhe nga investimet	25	(4,489)	(1,691)
Të ardhura neto		2,343,125	2,117,038
Dëme dhe përfitime të shlyera		(694,819)	(594,928)
Dëme dhe përfitime të shlyera risiguresi		87,645	147,971
Ndryshimi në provigjionin e dëmeve		(420,308)	(82,118)
Ndryshimi në provigjionin e dëmeve të risigurimit		57,333	(148,221)
Dëmet dhe përfitimet e shlyera të polic- mbajtësve, neto	26	(970,149)	(677,296)
Kosto të marrjes në sigurim	27	(781,762)	(914,861)
Shpenzime administrative	28	(495,096)	(461,493)
Zhvleresim i investimeve	14	185,000	(230,000)
Shpenzime të tjera operative	29	(38,996)	(19,098)
Totali i shpenzimeve		(1,130,854)	(1,625,452)
Fitimi/ (humbje) të tjera	30	(18,331)	(2,031)
Fitimi/humbja para tatimit		223,791	(187,741)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(16,169)	(17,618)
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(16,169)	(17,618)
Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë		-	-
Fitimi/humbja e vitit		207,622	(205,359)
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	55,979
Diferencat (+/-) nga rivleresimi i aktiveve afatgjata materiale			55,979
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	55,979
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		207,622	(149,380)

Shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 50 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare individuale.

Eurosig sh.a.

Pasqyrat Financiare Individuale më 31 dhjetor 2022

(Të gjitha shumatat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

Pasqyra Individuale e Ndryshimeve në Kapital më 31 dhjetor 2022

	Kapitali aksionar	Rezerva Rivlerësimi	Rezerva të tjera	Fitimet e Pashpërndara	Totali
Pozicioni financiar më 1 janar 2021	2,495,650	98,366	10,334	(229,568)	2,374,782
Emetimi i kapitalit të nënshkruar	270,000	-	-	-	270,000
Rritje/renie e rezervës së rivlerësimit	-	55,979	-	-	55,979
Totali i fitim/humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	(205,359)	(205,359)
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2021	2,765,650	154,345	10,334	(434,927)	2,495,402
Emetimi i kapitalit të nënshkruar	-	-	-	-	-
Rritje/renie e rezervës së rivlerësimit	-	-	-	-	-
Transferim i fitimeve në rezerva për investime	-	-	-	-	-
Totali i fitim/humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	207,622	207,622
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2022	2,765,650	154,345	10,334	(227,305)	2,703,024

Shënimetshpjeguese nga faqja 8 deri në 50 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare individuale.

Eurosig sh.a.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare Individuale

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

Pasqyra Individuale e Flukseve të Parasë më 31 dhjetor 2022

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
<i>Flukset e parasë nga aktivitetet operative</i>		
Fitimi para tatimit	207,622	(187,741)
Axhustime për zërat jo-monetare:		
Amortizimi i aktiveve afat-gjata	56,798	55,467
Të ardhura financiare dhe nga investimet	5,647	(13,138)
Rritje/ renie e pjesës së risiguruesit në provigjionet e kontratave të sigurimit	(75,571)	153,164
Fitimi operativ para ndryshimeve në kapitalin qarkullues	194,496	7,752
Rënie në llogaritë e arkëtueshme nga sigurimi dhe të tjera të arkëtueshme	(63,375)	9,088
Rënie në koston e shtyrë të marrjes në sigurim	131,800	(53,106)
(Rritje) në aktive të tjera	26,297	78,074
Rritje/(rënie) në provigjionet e kontratave të sigurimit	573,036	211,620
Renie në llogaritë e pagueshme për sigurimet, risigurimet dhe llogari të tjera	57,614	(391,362)
Detyrim për Fondin e kompesimi	2,237	18,919
Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative	922,105	(119,015)
Tatimi mbi fitimin i paguar gjatë vitit	(7,097)	(24,237)
Flukset monetare neto gjeneruar nga aktivitetet operative	915,008	(143,252)
<i>Aktivitetet investuese</i>		
Shtesa/pakesime të investimeve në shoqëri të kontrolluara	(576,111)	(182,497)
Shtesa/pakesime të Aseteve në proces	(299,848)	-
Blerje të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale	(9,061)	(11,371)
Shitje të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale	795	-
Renie/(rritje) në depozitat me afat	(1,910)	104,479
Shtesa e drejta në përdorim	(99,608)	
Interesa të arkëtuara	-	12,244
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues	(985,743)	(77,145)
<i>Aktivitetet financuese</i>		
Rritje renie në leasing financiar	-	(4,136)
Ndryshim në qerane financiare	62,360	(34,049)
Rritje kapitali	-	270,000
Shtesa/ (Shlyerje) për huatë të marra	-	(2,282)
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues	62,360	229,533
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	(8,375)	9,136
Mjetet monetare në fillim të periudhës	12,214	3,078
Mjetet monetare në fund të periudhës	3,839	12,214

Shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 50 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare individuale.

Eurosig sh.a.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare Individuale

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Eurosig Sh.a. ("Shoqëria") është shoqëri aksionare e themeluar në Shqipëri me vendodhje në Tiranë, rruga Papa Gjon Pali II. Shoqëria operon në tregun e sigurimeve duke ofruar produkte sigurimi jo-jete në territorin e Republikës së Shqipërisë. Veprimtaria e Shoqërisë është subjekt i ligjit numër. 52 'Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit', të datës 22 maj 2014 ("Ligji mbi sigurimet").

Aktiviteti kryesor përfshin ofrimin e shërbimeve të sigurimit në aktivitetin jo-Jetë për sigurimin e aksidenteve; sëmundjeve, mjeteve toksore, mjete lëvizje mbi shina, avione, anije, mallra në transport, zjarri dhe forca natyrore, dëmtime të tjera të pasurisë, sigurim i përgjegjësive civile dhe sigurimet e garancive.

Struktura e aksionerëve të Shoqërisë është si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Z. Kadri Morina	58.21 %	58.21 %
Shoqëria "Euro-Alba.Ea" Sh.p.k	25.69%	25.69%
Z. Xhevdet Morina	15.82%	15.82%
Z. Ylli Merkaj	0.28%	0.28%
Totali	100.00%	100.00%

Shoqëria nuk është e listuar në ndonjë bursë.

Drejtimi i Shoqërisë

Drejtimi i Shoqërisë gjatë vitit 2022 deri në datën e nënshkrimit të këtij raporti përbëhet nga:

Z.Xhevdet Kopani Drejtor i Përgjithshëm

Zj.Anila Ibri Drejtor i Departamentit Ekonomik

Znj. Akena Mema Drejtor i Departamentit të Marrjes në Sigurime, Risigurim dhe Marrëdhënieve me Jashtë

Z.Agim Hysko Drejtor i Departamentit të Dëmeve

Zj. Romeo Baçe Aktuar i Autorizuar

Këshilli Mbikqyrës

Këshilli mbikqyrës i Shoqërisë në 31 dhjetor 2022 përbëhet nga:

Z. Vasil Pilo	Kryetar
Z. Saimir Boka	Anëtar
Z. Aleksander Biberaj	Anëtar

Eurosig sh.a.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare Individuale

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

2. BAZAT E PËRGATITJES**2.1 Bazat e përputhshmërisë**

Pasqyrat financiare individuale janë përgatitur në përputhje me kërkesat e raportimit financiar për shoqëritë e sigurimit në Shqipëri. Kuadri kontabël i aplikuar është i bazuar në politikat kontabël të listuara në shënimin 4, të cilat janë të bazuara në vlerësimin, paraqitjen, dhe parimet kontabël sipas Standarteve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), përveç mungesës së konsolidimit të Investimit në Shoqëri të Kontrolluara. Më poshtë paraqiten parimet kryesore të politikave kontabel të aplikuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare individuale.


Shoqëria përgatit pasqyra financiare të konsoliduara në përputhje me SNRF për Grupin Eurosig Sh.a, i cili përfshin Eurosig sh.a në Shqipëri, Eurosig sh.a. në Kosovë, Insig jo-jetë sh.a dhe Insig Jetë sha.

Eurosig Kosovë është shoqëri e kontrolluar e grupit Eurosig Sh.a. Më 24 shkurt 2017, BQK mori vendimin për vendosjen e një administratori të përkohshëm në shoqërinë Eurosig KS me qëllim rikuperimin e stabilitetit të pozicionit financiar të shoqërisë. Koha e administrimit të përkohshëm zgjati deri më 30 qershor 2019. Me vendimin e datës 26 korrik 2019, nr 44-19/2019 të BQK-së “Për përfundimin e administrimit të përkohshëm të sigurvecit, sigurveci “Eurosig” Kosovë del nga administrimi i përkohshëm.

Më 13 mars 2019, Shoqëria e kontrolluar Insig Sh.a realizoi shitjen e 100% të aksioneve të filialit Eurosig AD, Shkup te Grazer Wechselseitige Versicherung Aktiengesellschaft Herrengasse 18-20, 8010 Graz, Austria me numër identifikimi FN 37748 me çmimin 6.2 milionë. Shoqëria ka investime në tituj kapitali të shoqërive Insig Jete Sh.a dhe që nga data 1 gusht 2019 ka investuar në tituj kapitali të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë. Në pasqyrat financiare të konsoliduara, shoqëritë e kontrolluara, në të cilat Grupi kontrollon në mënyrë direkte ose jodirekte më shumë se gjysmën e të drejtave të votës, ose zotëron të drejtën për të ushtruar kontroll mbi aktivitetet e tyre, konsolidohen plotësisht.

Më 26 maj 2020 është firmosur marrëveshja për revokimin e kontratës së shitjes së aksioneve të Insig Jete date 10.05.2017. Në bazë të marrëveshjes së revokimit, Eurosig sha ka kthyer shumën prej 20,000 mije Lek palës blerëse dhe ka marrë në këmbim 90% të aksioneve për vlerën 333,000 mijë Lek. Më 31 dhjetor 2022 shoqëria Eurosig sha kontrollon 100% të aksioneve të shoqërisë Insig Jetë sha.

Paraqitja skematike e Grupit Eurosig:



Eurosig sh.a.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare Individuale

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

2. BAZAT E PËRGATITJES (vazhdim)

Pasqyrat financiare të konsoliduara paraqiten në faqen zyrtare të Shoqërisë. Përdoruesit e këtyre pasqyrave financiare individuale duhet të lexojnë këto pasqyra si pjesë përbërëse të pasqyrave financiare të konsoliduara të Grupit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 për të marrë informacion mbi pozicionin financiar, performancën financiare dhe ndryshimet në pozicionin financiar të grupit në tërësi.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare individuale janë përgatitur në bazë të kostos historike.

2.3 Monedha funksionale dhe e prezantimit

Pasqyrat financiare individuale janë paraqitur në Lek, e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

2.4 Përdorimi i vlerësimit dhe i gjykimit profesional

Përgatitja e pasqyrave financiare individuale kërkon që drejtuesit të kryejnë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe bazat e llogaritjes rishikohen vazhdimisht. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimet rishikohen dhe në periudha të ardhshme që rishikimi ndikon. Më në veçanti, informacione në lidhje me vlerësimet e pasigurta dhe gjykimet profesionale në aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt të konsiderueshëm në vlerat e njohura në pasqyrat financiare individuale përshkruhen në shënimet 10 dhe 17.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe janë bazuar në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë, përfshirë edhe pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme, të cilat besohet se janë të përshtatshme dhe relevant për rrethanat aktuale. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën gjatë së cilës vlerësimi është rishikuar nëse rishikimi ndikon vetëm atë periudhë kontabël ose në periudhën gjatë së cilës vlerësimi është rishikuar dhe periudha të ardhshme nëse rishikimi ndikon të dyja periudhat si aktuale dhe të ardhshme.

Pretendimet dhe përfitimet e policë-mbajtësit

Vlerësimi i detyrimeve që lindin nga dëme të ndodhura nga kontratat e sigurimeve është vlerësimi kontabël më kritik i Shoqërisë. Vendimi i Shoqërisë për humbjet e raportuara dhe të paraportuara dhe vendosja e rezervës dhe rimarrja nga risigurimet, rishikohen dhe përditësohen çdo vit, dhe ndryshime që rezultojnë nga ky vlerësim pasqyrohen në humbjet ose fitimet. Proçesi nuk mbështetet në supozimin që eksperiencat e mëparshme të rregullara për efektet e zhvillimeve dhe trendave aktualë, është një bazë e besueshme për parashikimin e ngjarjeve të ardhshme.

Llogaritë e arkëtueshme të sigurimit

Llogaritë e arkëtueshme të sigurimit dhe të tjera njihen me kosto duke zbritur humbjet nga zhvlerësimi. Vlerësimi i zbritjeve për humbjet nga zhvlerësimi është gjithashtu një vlerësim kritik i realizuar nga drejtimi. Në çdo datë raportimi bëhet një vlerësim nëse llogaritë e arkëtueshme të sigurimit duhet të zhvlerësohen. Llogaritë e arkëtueshme të sigurimit të cilat kanë indikatorë për zhvlerësim zhvlerësohen, me përjashtim nëse ka një probabilitet të lartë që do të arkëtohen. Ky probabilitet ekziston nëse Shoqëria ka marrëdhënie afatgjata me klientët ose kur Shoqëria blen të mira dhe shërbime nga i siguruari dhe të arkëtueshmet përcaktohen si shumë neto. Llogaritë e arkëtueshme të sigurimit me vonesë më pak se një vit vlerësohen individualisht në rastet kur ato kanë vlerë të konsiderueshme dhe zhvlerësohen plotësisht nëse ekzistojnë

Eurosig sh.a.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare Individuale

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

2. BAZAT E PËRGATITJES (vazhdim)**2.4 Përdorimi i vlerësimit dhe i gjykimit profesional (vazhdim)**

informacione që nuk do të mblidhen. Llogaritë e arkëtueshme me vonesë më pak se një vit vlerësohen gjithashtu në grup duke u bazuar në vjetërsinë e tyre. Përqindja e provigjionit që aplikohet për çdo kategori vjetërsie të llogarive të arkëtueshme me vonesë më pak se një vit përfaqëson vlerësimin më të mirë të drejtimit mbi humbjet e ardhshme dhe bazohen mbi experienat e rimarrjes së viteve të mëparshme dhe të eksperiencave të tregut.

Vlerësimi i detyrimeve të kontratës së sigurimit

Për kontratat e sigurimit të jo-jetës, vlerësimet bëhen si për koston e pritshme përfundimtare të kërkesave të raportuara në deklaratën e datës së gjendjes financiare dhe për koston e pritshme përfundimtare të kërkesave të ndodhura por jo të raportuara ende në Deklaratën e datës së pozicionit financiar ("IBNR"). Kostoja përfundimtare e kërkesave të papaguara është vlerësuar duke përdorur një gamë të kërkesave të teknikave standarde të projektimit.

Supozimi kryesor në themel për këto teknika është se për një kompani pretendimet e kaluara si përvojë zhvillimi mund të përdoren për projektin e zhvillimit të kërkesave të ardhshme dhe kostot përfundimtare. Si të tilla, këto metoda nxjerrin zhvillimin e paguar dhe humbjet e shkaktuara, shpenzimet mesatare për kërkesë dhe numrat e kërkesave të bazuar në zhvillimin e vërejtur vitet e mëparshme dhe raportet për humbje që priten.

Zhvillimi historik dhe pretendimet historike është analizuar kryesisht nga vitet e aksidentit, por mund edhe të analizohen më tej nga zona gjeografike, si dhe nga linja të rëndësishme të biznesit dhe llojet e kërkesave. Gjykimi cilësor shtesë është përdorur për të vlerësuar shkallën në të cilën tendencat e kaluara nuk mund të zbatohen në të ardhmen, në mënyrë që të arrijë në koston e vlerësuar përfundimtare të kërkesave që paraqesin rezultatin e mundshëm nga rangun e rezultateve të mundshme, duke marrë parasysh të gjitha pasigurive të përfshira.

Parimi i vijimësisë

AMF më anë të vendimit të Bordit numer 162 datë 30.07.2018, i ka kërkuar Shoqërisë anulimin e shtimit të kapitalit të Eurosig Sh.a, Kosovë në vlerën prej 300 mijë euro, pasi ky transaksion nuk është në përputhje me vendimin nr. 148 datë 27.10.2017 të Bordit të AMF-së. Vendimi nr.148 datë 27.10.2017 i Bordit të AMF-së parashtron masat administrative, ndër të tjera, ndalimin e transaksioneve me palet e lidhura dhe punonjësit si edhe hartimin e planit për përmirësimin e treguesve rregullatorë të Shoqërisë. Shoqëria ka ankimuar pranë Gjykatës Administrative të shkallës së parë Tiranë vendimin nr. 162, datë 30.07.2018 të Bordit të AMF duke kërkuar mbi baza ligjore që Autoriteti Mbikëqyrës të njohë investimet e kryera për blerjen e aksioneve në shoqëritë e kontrolluara, si aktive të përshtatshme në mbulim të provigjioneve teknike dhe aftësinë paguese të shoqërisë. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me anë të vendimit numër 80-2019-274 datë 01.02.2019, ka pranuar padinë e Shoqërisë ndaj Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për shfuqizimin e aktit administrativ, nr. 162 datë 30.07.2018 të Bordit të AMF dhe masat e marra sipas atij vendimi si edhe ka vendosur detyrimin e AMF të njohë investimet e kryera në blerjen e aksioneve në shoqëritë e kontrolluara si aktive në mbulim të provigjioneve teknike dhe aftësinë paguese të shoqërisë.

Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 2254 (86-2019-2581) datë 12.07.2019, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, duke e kthyer atë në titull ekzekutiv, të detyrueshme për zbatim. Për pasojë, prej 3 mujorit të dytë të vitit 2019 shoqëria ka përfshirë në përlllogaritjet e treguesve të analizës financiare investimet në aksione në shoqëritë e kontrolluara, gjë e cila ka ndikuar ndjeshëm në rezultatin e treguesve rregullatorë të analizës financiare. AMF ka bërë rekurs në Gjykatën e Lartë për këtë

Eurosig sh.a.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare Individuale

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

2. BAZAT E PËRGATITJES (vazhdim)**2.4 Përdorimi i vlerësimit dhe i gjykimit profesional (vazhdim)**

Vendim.

Drejtimi i ka përgatitur këto pasqyra financiare individuale sipas parimit të vijimësisë. Në krijimin e këtij gjykimi, drejtimi ka kryer një analizë të detajuar duke konsideruar të gjitha faktet dhe rrethanat e mundshme si dhe pozicionin financiar të Shoqërisë, treguesit ligjore, likuiditetin, pozicionin në treg dhe vendimet strategjike të investimit.

2.5 Ndryshimet në politikat kontabël

Politikat e adoptuara të kontabilitetit janë në përputhje me ato të vitit të kaluar financiar. Ndryshimet që rrjedhin nga përmirësimet në SNRF nuk kanë ndonjë ndikim në politikat kontabël, pozicionin financiar apo në ecurinë e Shoqërisë.

3. APLIKIMI I STANDARTEVE NDERKOMBETARE TE RAPORTIMIT FINANCIAR TE REJA DHE TE RISHIKUARA**3.1. Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale**

Nga njoftimet kontabël e shpallura, për standardet që hyjnë në fuqi nga 1 janari 2022, nuk ka pasur ndryshime që të kenë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të njësisë ekonomike. Standarde dhe ndryshime të tjera që janë efektive për herë të parë në 2022 dhe mund të zbatohen për njësinë ekonomike janë:

- Referenca në Kuadrin konceptual (Ndryshimet në SNRF 3)
- Koncesionet e qirasë të lidhura me Covid 19 përtej datës 30 qershor 2021 (Ndryshime në SNRF16)
- Aktivitet afatgjatë materiale, impiantet dhe pajisjet: të ardhurat përpara përdorimit të synuar (Ndryshimet në SNK 16)
- Kontratat me humbje - Kostoja e përmbushjes së një kontrate (Ndryshimet në SNK 37)
- Përmirësimi vjetor (cikli 2018-2020)
- Filial si adoptues për herë të parë (Ndryshimet në SNRF 1)
- Tarifat në testin '10 përqind' për mosnjohjen e pasiveve financiare (Ndryshimet në SNRF 9)
- Tatimi në matjet e vlerës së drejtë (Ndryshimet në SNK 41).

Këto ndryshime nuk kanë një ndikim të rëndësishëm në këto Pasqyra Financiare dhe për këtë arsye nuk janë paraqitur.

3.2. Standardet dhe interpretimet të lëshuara, por ende nuk janë adoptuar

- Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit ka publikuar një sërë standardesh dhe interpretime që janë efektive në periudhat e ardhshme kontabël, të cilat kompania ka vendosur të mos i zbatojë paraprakisht. Kompania planifikon të zbatojë këto standarde dhe interpretime kur ato të hyjnë në fuqi.
- Standardet dhe interpretimet e mëposhtme janë lëshuar, por nuk janë të detyrueshme për periudhën aktuale të raportimit të përfunduar më 31 dhjetor 2022:
- Paraqitja e informacioneve shpjeguese të politikave kontabël (Ndryshimet në SNK 1 dhe Deklarata e Praktikës IFRS 2) - Në fuqi nga 1 janari 2023
- Përkufizimi i Vlerësimeve Kontabël (Ndryshimet në SNK 8) - Në fuqi nga 1 janari 2023
- Tatimi i shtyrë në lidhje me aktivet dhe detyrimet që lindin nga një transaksion i vetëm (Ndryshimet në SNK 12) - në fuqi nga 1 janari 2023
- SNRF 17 – Kontratat e Sigurimeve – Në fuqi më 1 janar 2023

Eurosig sh.a.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare Individuale

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL**4.1 Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale sipas kursit të këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare të cilat janë njohur me kosto historike përkthehen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat që lindin nga kurset e këmbimit njihen në të ardhura ose humbje.

Produktet e sigurimit të Shoqërisë klasifikohen në momentin e krijimit, për arsye kontabël, si kontrata sigurimi. Një kontratë, e cila klasifikohet si kontratë sigurimi mbetet e tillë derisa të gjitha të drejtat dhe detyrimet shuhen ose pushojnë së ekzistuari. Kontrata nën të cilat Shoqëria pranon të marrë një rrezik sigurimi të rëndësishëm nga një palë tjetër (policë- mbajtësi) duke rënë dakort të kompensojë policë- mbajtësin ose përfitues të tjerë për një ngjarje të caktuar të pasigurtë (ngjarja siguroese), e cila ka efekte negative dhe ndikon në policë- mbajtësin apo përfituesit e tjerë, klasifikohet si kontratë sigurimi. Rreziku i sigurimit është i ndryshëm nga rreziku financiar. Rreziku financiar është rreziku i ndryshimeve të ardhshme të mundshme në një ose më shumë norma interesi specifike, çmimet e letrave me vlerë, çmimet e komoditeteve, kursi i këmbimit, indekset e çmimeve ose të normave, vlerësimi i aftësisë kredituese apo indekset e kreditimit ose variabla të tjerë, të siguruar në rastin e variablave jo-financiarë kur variabli nuk është specifik për një palë në kontratë. Kontratat e sigurimit mund të transferojnë një pjesë të rrezikut financiar.

4.2 Njohja dhe matja e kontratave*Kontratat e përgjithshme të sigurimit*

Detyrimet e sigurimit janë llogaritur në mënyrë të veçantë për të gjitha produktet e sigurimit dhe janë të përbëra nga primet e angazhimeve të ardhshme (të pafituara), rreziku i angazhimeve të ardhshme (të pambaruara) dhe humbjet e angazhimeve të ardhshme (të papaguara në datën e mbylljes të vitit financiar).

Detyrimet e sigurimit (provizionet) paraqesin vlerësime të pagesave të ardhshme për dëmet e raportuara dhe të paraportuara. Shoqëria nuk i skanton detyrimet e sigurimit. Çdo ndryshim në vlerësim është reflektuar në rezultatet e operacioneve në periudhën në të cilën vlerësimet janë ndryshuar. Vlerësimi i detyrimeve të sigurimit është një proces kompleks që lidhet me pasiguritë dhe kërkon përdorimin e vlerësimeve dhe gjykimeve të informuara. Shoqëria ka përdorur kërkesat e legjislacionit shqiptar të sigurimeve për të përcaktuar detyrimet e sigurimit.

Prime të krijuara nga aktiviteti i përgjithshëm i sigurimit

Primet e shkruara bruto përbëjnë shumat e detyruara gjatë vitit financiar në përputhje me sigurimin direkt, pavarësisht faktit se këto shuma mund t'i përkasin plotësisht ose pjesërisht një periudhe kontabël të mëpasshme. Primet prezantohen bruto nga detyrimet e komisioneve ndaj ndërmjetësve dhe nuk përfshijnë tatimet dhe detyrime tatimore të bazuara tek primet. Primet janë fituar që nga data e lidhjes me rrezikun, për periudhën e dëmshpërblimit, në bazë të rrezikut të nënshkruar.

Rezerva për primin e pafituar

Rezerva e primit të pafituar në të gjitha segmentet e biznesit përfshin atë pjesë të primeve të shkruara bruto, e cila vlerësohet të fitohet në vitet financiare pasardhëse, duke përdorur metodën ditore në bazë proporcionale

Eurosig sh.a.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare Individuale

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (vazhdim)**4.2 Njohja dhe matja e kontratave (vazhdim)**

1/365, e rregulluar nëse nevojitet në mënyrë që të reflektojë çdo ndryshim të ndodhjes së rrezikut gjatë periudhës së mbuluar nga kontrata. Megjithatë të gjitha produktet e Shoqërisë kanë rrezik linear dhe asnjë rregullim për ndryshime të rrezikut nuk është bërë. Primi i pafituar është ajo pjesë e primit, e cila lidhet me periudha pas datës së raportimit. Primi i pafituar llogaritet nga primet e nënshkruara, të cilat prezantohen bruto nga detyrimet e komisioneve ndaj ndërmjetësve dhe përjashtojnë tatimet dhe detyrimet doganore të bazuara tek primet. Kostot e shtyra të marrjes në sigurim njihen më vete si aktive.

Kostot e shtyra të marrjes në sigurim

Kostot e shtyra të marrjes në sigurim dhe të ardhurat e shtyra të komisioneve përfaqësojnë pjesën e kostove të marrjes në sigurim të ndodhur dhe të ardhurat e marra që përputhen me rezervën e primit të pafituar. Ato përcaktohen si pjesë e kostove të blerjes dhe të ardhurës nga komisionet e risigurimit, të vendosura si përqindje në planin teknik të sigurimit dhe lidhen me periudhën midis fundit të periudhës së raportimit dhe datës së shuarjes së kontratës së sigurimit.

Kostot aktuale të marrjes në sigurim dhe të ardhurat nga komisionet e risigurimit njihen plotësisht si shpenzime dhe të ardhura të periudhës.

Sipas udhëzimit nr. 12 datë 04.04.2017 për taksat kombëtare, taksa e primit evidentohet veçmas nga primi i shkruar. Në rolin e agentit të taksës mbi primet e shkruara, shoqëria e sigurimeve është përgjegjëse për llogaritjen, deklarimin, mbledhjen dhe pagesën e taksës së primit të shkruar për llogari të organit tatimor.

Shuma totale e primeve të shkruara të faturuara gjatë muajit, si dhe taksa prej 10% e tyre deklarohet dhe paguhet nga shoqëria e sigurimeve deri në datën 15 të muajit pasardhës, për të cilin janë faturuar primet e sigurimit, në deklaraten mujore të taksave kombëtare.

Dëmet të krijuara nga aktiviteti i përgjithshëm i sigurimit

Dëmet e ndodhura përbëhen nga kostot e mbylljes dhe trajtimit të dëmeve të paguara dhe të papaguara që lindin nga ngjarje të ndodhura gjatë vitit financiar sëbashku me rregullime të provigjionit të dëmeve të vitit të mëparshëm. Në përputhje me legjislacionin shqiptar, dëmet e refuzuara gjithashtu njihen si pjesë e dëmeve të papaguara për një periudhë 2-vjecare. Dëmet e papaguara vlerësohen duke rishikuar dëmet individuale dhe duke provigjonuar dëmet e ndodhura por ende të paraportuara, efekti i ngjarjeve të parashikuara të brendëshme dhe të jashtëme, të tilla si ndryshimet e procedurave në trajtimin e dëmeve, inflacioni, tendencat juridike, ndryshimet legjislative dhe eksperiencat e mëparëshme. Provizoni për dëmet e papaguara nuk skontohej. Rregullimet për provizionin e dëmeve të viteve të mëparëshme reflektohen në pasqyrat financiare të periudhës në të cilën bëhen rregullimet dhe paraqiten më vete nëse janë materiale. Nderkohë që Bordi i Drejtorëve konsideron se detyrimet e sigurimit për dëmet dhe marrjet nga risigurimi janë të drejta, detyrimi përfundimtar mund të ndryshojë si rrjedhojë e informacioneve dhe ngjarjeve të mëvonshme dhe mund të rezultojë në një rregullim të shumës së dhënë. Rregullimet për detyrimet e sigurimit reflektohen në pasqyrat financiare në periudhën në të cilën bëhet rregullimi.

Angazhimet për dëmet në proces gjyqësor

Një pjesë e konsiderueshme e dëmeve janë në proces gjyqësor dhe për të cilat Shoqëria ka regjistruar detyrimin përkatës në bazë të vlerësimeve të drejtimit.

Eurosig sh.a.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare Individuale

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (vazhdim)**4.3 Risigurimi**

Shoqëria cedon primet e siguruara dhe rrezikun në rrjedhën normale të biznesit me potencialin e humbjes neto nëpërmjet diversifikimit të rrezikut që krijohet nga linjat e biznesit të MTPL dhe pasurisë.

Risigurime të tilla përfshijnë tejkalimin e humbjeve nga marrëveshjet fakultative. Vetëm kontratat që përfshijnë transferimin e një pjese të konsiderueshme të rrezikut të sigurimit dhe atij kohor regjistrohen si aktive të sigurimit. Marrëveshjet e risigurimit nuk e çlirojnë Shoqërinë nga detyrimet direkte ndaj policëmbajtësit. Detyrimet e risigurimit përfshijnë llogari të pagueshme për kontrata të jashtëme risigurimi dhe njihen si shpenzime kur u mbaron afati.

Primet e risiguruara për risigurimin e ceduar njihen si shpenzim në mënyrë që të jenë konsistente me njohjen e primeve të lidhura me kontratat e sigurimit. Për sigurimin e përgjithshëm të biznesit, primet e risigurimit shpenzohen në periudhën në të cilën mbulimi i risigurimit jepet në bazë të modeleve të rrezikut të risiguar. Pjesa e pashpenzuar e primit të risigurimit të ceduar përfshihet në aktivet e risiguruara. Shuma e njohur si aktiv i risiguar matet në mënyrë që të jetë konsistente me matjet e provigjonit të mbajtur në përputhje me kontratat e sigurimit.

Llogaritë e arkëtueshme nga risigurimi përfshijnë komisionet e risigurimit nga primet e ceduar risigruarit dhe të arkëtueshme nga Shoqëria risigruare në përputhje me dëmin e paguar. Këto janë klasifikuar si llogari të arkëtueshme dhe paraqiten të veçanta, nëse ka.

Aktivitet e risiguruara vlerësohen për zhvlerësim në datën e raportimit. Një aktiv konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka evidencë objektive, si rezultat i një ngjarje të ndodhur pas njohjes fillestare, që Shoqëria mund të mos marrë të gjitha shumat që i detyrohen dhe ngjarja ka një impakt besueshmërisht të matshëm në shumat që Shoqëria do të marrë.

4.4 Testi i mjaftueshmërisë së detyrimeve

Në çdo datë raportimi Shoqëria bën një test të mjaftueshmërisë së rezervave të dëmeve. Testet e para që realizohen janë Analiza e Raportit të Dëmeve dhe Analizën e Zhvillimit të provizoneve të dëmeve. Analiza e raportit të dëmeve realizohet çdo vit në mënyrë individuale për linjat kryesore të biznesit. Llogaritjet realizohen më vete për dëmet si dhe për dëmet që përfshijnë kostot e blerjeve si dhe kosto të tjera të jashtme për trajtimin e dëmeve. Në realizimin e kësaj analize Shoqëria merr në konsideratë vlerësimet aktuale të fluksve monetare dalëse. Shoqëria nuk i skonton këto flukse monetare pasi pjesa më e madhe e dëmeve priten të zgjidhen brenda një viti.

Për më tepër, Shoqëria kryen çdo vit analizën e zhvillimit të provizoneve të dëmeve për të përcaktuar metodologjinë e rezervës. Kjo analizë kryhet në mënyrë të veçantë por dhe të kombinuar për RBNS (të raportuara por ende të pambyllura) dhe IBNR (të ndodhura por të paraportuara). Në rastet kur analiza paraqet parregullsi të theksuara, rregullime të caktuara i bëhen metodologjisë së rezervës.

Nëse një mungesë identifikohet ajo i alokohet fitimit ose humbjes duke krijuar një provizion për rrezikun e paskaduar nga humbjet që lindin nga Testi i Mjaftueshmërisë së Detyrimeve.

i) Njohja

Shoqëria fillimisht njeh kreditë dhe paradhëniet, të arkëtueshme dhe huatë në datën kur lindin të drejtat dhe detyrimet përkatëse. Të gjitha detyrimet dhe aktivitetet tjera financiare njihen fillimisht në datën e transaksionit në të cilën Shoqëria bëhet palë e detyrimeve kontraktore të instrumentit.

Eurosig sh.a.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare Individuale

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (vazhdim)**4.4. Testi i mjaftueshmërisë së detyrimeve (vazhdim)***Çregjistrimi*

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar nëse humbet të drejtat kontraktuale mbi flukset e ardhshme të parasë ose transferon të drejtat për të marrë flukset kontraktuale të parasë nga aktivet financiare në transaksione në të cilat i gjithë rreziku dhe përfitimet nga aktivet financiare është transferuar. Çdo interes nga aktivi financiar i transferuar që është krijuar ose mbajtur nga Shoqëria njihet si aktiv ose detyrim i veçantë.

Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale shuhen, anulohen ose maturohen.

4.5 Instrumentet Financiare*ii) Netimi*

Aktivët dhe detyrimet financiare mund të netohen dhe tepricat neto të paraqiten në bilanc vetëm kur Shoqëria ka të drejta ligjore për të netuar shumat dhe ka për qëllim të arkëtojë ose të mbyllë aktivin apo detyrimin neto në të njëjtën kohë. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten të netuara vetëm kur lejohet nga standartet e kontabilitetit, ose për fitime dhe humbje që lindin nga transaksione me natyrë të njëjtë përgjatë aktivitetit të Shoqërisë.

iii) Matja e kostonë së amortizuar

Kosto e amortizuar e një aktivi apo detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi financiar është matur në njohjen fillestare, duke zbritur këstet e paguara, plus ose minus amortizimin kumulativ që rezulton nga përdorimi i metodës së interesit efektiv për ndonjë diferencë midis vlerës së njohur në fillim dhe vlerës në maturim si dhe humbjet nga rënia në vlerë.

iv) Matja me vlerë të drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare është bazuar në çmimet e publikuara të tregut dhe treguesve të instrumentave financiarë në tregjet aktive. Për të gjithë instrumentat e tjerë financiarë vlera e drejtë është përcaktuar duke përdorur teknika vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë teknika të tilla si vlera reale neto, metoda e aktualizimit të flukseve, krahasimi me instrumenta të tjerë të ngjashëm për të cilat çmimet përcaktohen në tregjet aktive, si dhe modele të tjera vlerësimi.

v) Identifikimi dhe matja e rënies në vlerë

Në çdo datë raportimi Shoqëria vlerëson nëse ka evidenca objektive për rënien në vlerë të aktiveve financiare. Aktivët financiarë pësojnë rënie në vlerë kur evidenca objektive dëshmon që një ngjarje me pasojë humbje ka ndodhur pas vlerësimit të mëparshëm të aktivit, si dhe kjo ngjarje ndikon në flukset e ardhshme monetare të vlerësueshme në mënyrë të besueshme.

Shoqëria merr në konsideratë evidenca për rënien në vlerë të aktiveve financiare specifike ose në grup. Të gjitha aktivet individualisht të rëndësishme testohen veçmas për humbjen e mundshme në vlerë. Të gjitha aktivet e rëndësishme që nuk konsiderohet të kenë rënë në vlerë vlerësohen më pas kolektivisht për ndonjë rënie në vlerë që ka ndodhur por nuk është identifikuar. Aktivët që individualisht nuk janë të rëndësishme grupohen dhe vlerësohen së bashku për rënie në vlerë me aktive me karakteristika të ngjashme (të mbajtura me kosto të amortizuar).

vi) Identifikimi dhe matja e rënies në vlerë (vazhdim)

Si evidencë objektive për rënie të mundshme në vlerë të aktiveve mund të përmendet mosshlyerja në kohë apo shkelja e termave nga një debitor, ristrukturimi i një kredie/paradhënie të dhënë nga Shoqëria me terma të cilat në kushte të tjera nuk do të ishin konsideruar; tregues për falimentimin e mundshëm të një debitori ose të dhëna të tjera të dukshme lidhur me një grup aktivesh si ndryshimi në përqendrim në statusin e arkëtueshmërisë së një debitori ose kreditori, apo kushte ekonomike që ndikojnë në përqendrimin grupit të aktiveve.

Eurosig sh.a.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare Individuale

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (vazhdim)**4.6 Mjete monetare dhe ekuivalente me to**

Mjetet monetare dhe ekuivalentë me to përfshijnë balancat e gjendjes në arkë, mjetet monetare të depozituara në banka të nivelit të dytë dhe investime afatshkurtra me likuiditet të lartë dhe me maturitet deri në tre muaj ose më pak që nga momenti i blerjes.

4.7 Depozitat me afat

Depozitat me afat paraqiten në pasqyrën individuale të pozicionit financiar me shumën e principalit të tyre dhe klasifikohen sipas maturitetit. Depozitat me afat me maturitet fillestar më të vogël se tre muaj klasifikohen si ekuivalentë të mjeteve monetare, ato me maturitet mbi tre muaj klasifikohen si investime në depozita me afat.

4.8 Letra me vlerë

Letrat me vlerë janë investime në borxh, të cilat Shoqëria ka për qëllim dhe aftësinë t'i mbaje deri në maturim dhe klasifikohen si të mbajtura deri në maturim. Investimet të cilat kanë pagesa fikse ose të përcaktuara dhe të cilat kanë për qëllim të mbahen deri në maturim maten me kosto të amortizuar, minus provizionet për rënien nga vlera. Kosto e amortizuar llogaritet duke marrë në konsideratë çdo prim apo zbritje gjatë blerjes.

4.9 Llogari të arkëtueshme sigurimi dhe të tjera

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerë të drejtë dhe më tej maten me kosto të amortizuar minus humbjet nga zhvlerësimi dhe përfshijnë paratë e mbajtura nga agjentët. Të arkëtueshmet nga sigurimi vlerësohen për zhvlerësim në çdo datë raportimi.

Të tjera

Aktivitet të tjera financiare jo derivative maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus humbjet nga zhvlerësimi.

Kontabilizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare diskutohet në shënimin 3.12.

4.10 Njohja e të ardhurave*i) Primet*

Politikat kontabël në lidhje me të ardhurat nga kontratat e sigurimit janë sqaruar në shënimin 4.2.

ii) Të ardhura nga qiraja

E ardhura nga qiraja njihet në bazë të të drejtave të konstatuara.

Kostot e marrjes në sigurim përcaktohen si kosto që lindin prej blerjes së kontratave të reja të sigurimit, përfshirë këtu kosto direkte si komisionet e blerjes dhe kostot e përpilimit të dokumentit të sigurimit, por edhe shpenzimet të pjesshme administrative të lidhura me procesimin e propozimit dhe lëshimin e policës.

Kostot e trajtimit të dëmeve konsistojnë në shpenzimet e jashtme të trajtimit të dëmeve dhe nuk përfshijnë shpenzimet të brendshme të mbulimit të dëmeve të cilat konsiderohen të jenë të parëndësishme krahasuar me kostot e jashtme. Kostot direkte të marrjes në sigurim shtyhen përgjatë kohëzgjatjes së policës përmes një metode konsistente me llogaritjen e provizionit të primit të pafutur dhe paraqiten bruto nga detyrimi përkatës i sigurimit, si një aktiv. Kostot e shtyra të marrjes në sigurim amortizohen sistematikisht përgjatë kohëzgjatjes së kontratës dhe testohen për zhvlerësim në çdo datë raportimi. Çdo shumë që nuk rimerret konsiderohet shpenzim.

Eurosig sh.a.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare Individuale

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (vazhdim)**4.11 Shpenzimet***i) Shpenzimet operative*

Shpenzimet operative njihen kur ndodhin.

ii) Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore

Shoqëria paguan vetëm kontribute të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të cilat sigurojnë të ardhura pensioni për punonjësit pas daljes në pension si edhe ato shëndetësore për kujdesin shëndetësor. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit ligjor minimal për pensionet në kuadër të juridiksionit respektiv dhe planit të kontributeve të përcaktuar. Kontributet e Shoqërisë në planin e pensionit i ngarkohen pasqyrës individuale së humbje fitimeve kur ato ndodhin.

4.12 Të ardhura dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat e fondeve të investuara në depozita bankare dhe fitimet nga kurset e këmbimit.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesave të huamarrjeve dhe humbjet nga kurset e këmbimit. Fitimet dhe humbjet nga kurset e këmbimit raportohen bruto. Të ardhurat nga interesat njihen në bazë të të drejtave të konstatuara, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

4.13 Aktive afatgjata materiale*i) Njohja dhe matja**Ndërtesat*

Ndërtesat shprehen me shuma të rivlerësuar. Shumat e rivlerësuar janë vlera të bazuara në vlerësimet e përgatitura nga vlerësuesit e jashtëm profesionistë. Çdo tepricë rivlerësimi kreditohet në rezervën e rivlerësimit në kapital. Në masën që çdorënie e rivlerësimit ose humbja nga zhvlerësimi më parë është njohur në fitim ose humbje, një rritje rivlerësimi kreditohet në fitim ose humbje me pjesën e mbetur të rritjes të njohur në të ardhurat e tjera përmbledhëse.

Nëserënia në vlerë aktivitetit të rivlerësuar është më e madhe sesa rivlerësimet e meparshme atëhere ajo njihet në fitim ose humbje. Çdo tepricë e rivlerësimit që mbetet në kapitalin neto në nxjerrjen jashtë përdorimit të aktivitetit transferohet në fitimin e pashpërndarë.

Pajisje elektronike, instalimet, automjetet, dhe pajisje të tjera (përfshirë mobilje dhe pajisje)

Pajisjet elektronike, instalimet, automjetet dhe pajisjet e tjera (që përfshijnë pajisje dhe mobilje) fillimisht njihen me koston e blerjes, duke përfshirë kostot që mund t'i atribuohen drejtpërdrejtë sjelljes së aseteve në vendin dhe gjendjen e nevojshme për përdorimin e synuar nga drejtimi i Shoqërisë. Pajisjet elektronike, instalimet automjetet dhe pajisjet e tjera (që përfshijnë pajisje dhe mobilje) përfshijnë gjithashtu pronën me qira të mbajtur nën një qira financiare. Pajisjet elektronike, automjetet dhe pajisjet e tjera (që përfshijnë pajisje dhe mobilje) më pas maten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi.

Humbjet dhe fitimet nga nxjerrja jashtë përdorimit të një elementi të paisjeve përcaktohen përmes krahasimit të të ardhurave të gjeneruara nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën e mbetur të pajisjes, dhe njihen neto brenda të ardhurave të tjera në pasqyrën individuale e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Eurosig sh.a.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare Individuale

(Të gjitha shumatat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (vazhdim)**4.13 Aktive afatgjata materiale (vazhdim)***i) Kosto të mëtejshme*

Kosto e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbetur të elementit nëse pritët që prej këtij zëvendësimi të rrjedhin përfitime të ardhshme ekonomike për Shoqërinë dhe nëse kjo kosto mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të riparimit të përhershëm të pajisjeve njihen në pasqyrën individuale e të ardhura shpenzimeve kur ato ndodhin.

ii) Zhvlerësimi

Toka, parapagimet dhe aktivet në process nuk zhvlerësohen. Zhvlerësimi i ndërtesave dhe përmirësimeve infrastrukturore realizohet përmes metodës lineare mbi jetë gjatësinë e vlerësuar të aktivitetit, ndërsa zhvlerësimi i aktiveve të tjera realizohet përmes metodës së vlerës së mbetur aplikuar mbi jetëgjatësinë e vlerësuar të aktiveve.

Normat e vlerësuara të zhvlerësimit janë si më poshtë:

Ndërtesa	5%
Kompjutera	25%
Furnitura dhe pajisje	20%
Mjete transporti	20%
Përmirësime të ambjenteve të marra me qira	10%

iii) Zhvlerësimi

Vlera e mbetur, nëse është e rëndësishme, rivlerësohet në mënyrë të përvitshme. Përmirësimet e qiramarrjeve kapitalizohen dhe zhvlerësohen për më të voglën midis jetës së dobishme dhe kohëzgjatjes së qirasë.

4.14 Aktive jo materiale

Aktivitet e patrupëzuara të blera nga Shoqëria, të cilat kanë jetë të dobishme të pafundme, maten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe rëniet në vlerë të akumuluar. Norma e zhvlerësimit është 25% me metodën e vlerës së mbetur.

i) Shpenzimet e mëvonshme

Shpenzimet e mëvonshme kapitalizohen vetëm kur ato rrisin përfitimet ekonomike të ardhshme të trupëzuara në aktivin specifik me të cilin lidhen. Të gjitha shpenzimet e tjera, përfshirë shpenzimet për emrin e mirë të gjeneruar nga brenda dhe të markave, njihen në fitimin ose humbjen e vitit kur ato ndodhin.

ii) Zhvlerësimi

Zhvlerësimi njihet në pasqyrën individuale e të ardhurave dhe shpenzimeve sipas metodës së vlerës së mbetur, duke u bazuar në kërkesat ligjore për normat e zhvlerësimit të aktiveve të patrupëzuara, një muaj pas blerjes së aktivitetit.

Jeta e dobishme e aktiveve rivlerësohet, dhe rregullohet nëse është e nevojshme, në çdo datë raportimi. Shtesat dhe humbjet nga dalja jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar të ardhurat me vlerën e mbartur dhe përfshihen në pasqyrën individuale e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Eurosig sh.a.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare Individuale

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (vazhdim)**4.15 Aktivet me të drejtë përdorimi dhe qiratë financiare (SNRF 16)**

Njësia ekonomike vlerëson nëse një kontratë është ose përmban një qira në fillim të kontratës. Një qira përmban të drejtën për të përfutur përdorimin dhe për të marrë në thelb të gjitha përfitimet ekonomike të një aktivi të identifikuar për një periudhë kohe në këmbim të flukseve dalëse.

Në datën e fillimit të qirasë, njësia ekonomike njeh një aktiv të së drejtës së përdorimit dhe një detyrim qiraje në pasqyrën e pozicionit financiar të njësisë ekonomike. Aktivi i së drejtës së përdorimit matet me kosto, i cili përbëhet nga matja fillestare e detyrimit të qirasë, çdo kosto fillestare direkte e kryer nga njësia ekonomike, një vlerësim i çdo kostoje për të çmontuar dhe hequr aktivin në fund të qirasë, dhe çdo pagesë qiraje e bërë para datës së fillimit të qirasë (neto nga çdo zbritje e marrë). Njësia ekonomike zhvlerëson të drejtën e përdorimit të aktivit mbi një bazë lineare nga data e fillimit të qirasë deri në më të hershmen midis fundit të jetës së dobishme të aktivit të së drejtës së përdorimit dhe afatit të qirasë. Njësia ekonomike gjithashtu zhvlerëson aktivin e së drejtës së përdorimit kur ekzistojnë tregues të tillë.

Në datën e fillimit, njësia ekonomike mat detyrimin e qirasë me vlerën aktuale të pagesave të qirasë të papaguara në atë datë, e skontuar me normën shtesë të huamarrjes së njësisë ekonomike, pasi që kontratat e qirasë negocohen me palët e treta nuk është e mundur të përcaktohet norma e interesit që nënkuptohet në qira.

Norma rritëse e huamarrjes është norma e vlerësuar që njësia ekonomike duhet të paguajë për të marrë hua të njëjtën shumë gjatë një afati të ngjashëm, dhe me siguri të ngjashme për të marrë një aktiv me vlerë ekuivalente. Pagesat e qirasë të përfshira në matjen e detyrimit të qirasë përbëhen nga pagesa fikse (përfshirë në substancë fikse), pagesa të ndryshueshme bazuar në një indeks ose normë, shuma që pritet të paguhet nën një garanci të vlerës së mbetur dhe pagesa që vijnë nga opsionet të cilat kanë një bazë të arsyeshme që do të ushtrohen.

Pas matjes fillestare, pasivi do të zvogëlohet nga pagesat e qirasë që shpërndahen midis ripagimeve të principalit dhe kostove financiare. Kostoja financiare është shuma që prodhon një normë konstante periodike interesi në pjesën e mbetur të detyrimit të qirasë.

Çdo fitim ose humbje në lidhje me përfundimin e pjesshëm ose të plotë të qirasë njihet në fitim ose humbje. Aktivi i së drejtës së përdorimit rregullohet për të gjitha modifikimet e tjera të qirasë.

4.16 Investime në ndërtesa dhe pasuri të paluajtshme

Investimet në ndërtesa dhe pasuri të paluajtshme fillimisht maten me kosto historike, përfshirë edhe kostot e trasaksionit. Menjëherë pas njohjes fillestare, investimet në pasuri të paluajtshme maten me kosto historike minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi në datën e raportimit. Investimet në ndërtesa dhe pasuri të paluajtshme çregjistrohen në rastin kur ato nxirren nga përdorimi ose kur investimi në pasuri të nuk përdoret më dhe nuk priten më të ardhura nga nxjerrja e tij apo përdorimi. Zhvlerësimi në ndërtesat e investueshme përllogariten duke përdorur metodën e vlerës së mbetur dhe normën e vlerësimit me 5%.

4.17 Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, me përjashtim të aktiveve tatimore të shtyra, shqyrtohet në çdo datë bilanci për të përcaktuar nëse ekziston ndonjë tregues për rënie në vlerë. Në qoftë se ekziston ndonjë tregues i tillë atëherë vlerësohet vlera e rikuperushme e aktivit. Një humbje nga rënia në vlerë njihet nëse vlera e mbartur e një aktivi ose njësia e tij e gjenerimit të mjeteve monetare tejkalon shumën e tij të

Eurosig sh.a.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare Individuale

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (vazhdim)**4.17 Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare (vazhdim)**

rikuperueshme. Njësia gjeneruese e mjeteve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare të pavarura nga aktive dhe grupe të tjera. Humbja nga rënia në vlerë njihet në pasqyrën individuale e të ardhurave dhe shpenzimeve. Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e një njësie gjeneruese të mjeteve monetare është vlera më e lartë midis vlerës në përdorim dhe vlerës reale pasi janë zbritur kostot eshitjes.

Në përlllogaritjen e vlerës në përdorim, flukset e pritshme për t'u arkëtuar aktualizohen duke përdorur një normë para efektit të taksës, e cila reflekton vlerësimet momentale të tregut për vlerën në kohë të parasë si edhe rreziqet specifike që lidhen me aktivin. Humbja nga zhvlerësimi e njohur në periudhat e mëparshme rishikohet në çdo datë raportimi nëse ka tregues që humbja është pakësuar ose nuk ekziston më. Humbja nga zhvlerësimi rikthehet nëse ka patur një ndryshim në vlerësimin e përdorur për të përcaktuar vlerën e realizueshme. Humbja nga zhvlerësimi kthehet vetëm në masën, me të cilën vlera e mbartur e aktivit nuk do të tejkalonte vlerën e mbartur të tij e cila do të ishte përcaktuar si vlera neto pas amortizimit nëse nuk do ishte njohur humbja nga zhvlerësimi.

4.18 Tatimi

Shpenzimet e tatim fitimit përfshijnë tatimin aktual dhe atë të shtyrë. Këto shpenzime njihen në humbje dhe fitime me përjashtim të rasteve kur njohja bëhet direkt në kapital apo të tjera të ardhura përmbledhëse.

i) Tatimi aktual

Tatimi aktual është tatimi që pritët të paguhet mbi të ardhurën e tatueshme të vitit, duke përdorur normat në fuqi në datën e raportimit, si dhe çdo rregullim për tatimin e pagueshëm të viteve të mëparshme. Shuma e tatimit aktual të pagueshëm ose të arkëtueshëm është vlerësimi më i mirë i shumës së tatimit që pritët të paguhet ose të merret që reflekton pasiguri lidhur me tatimet mbi të ardhurat, nëse ka. Matet duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që konsiderohet në fuqi në datën e raportimit. Aktivët dhe pasivët tatimore aktuale janë kompensuar vetëm nëse plotësohen disa kritere.

(ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë është llogaritur në përputhje me diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerës së përdorur për qëllime tatimore. Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit të mund të përdoren humbjet tatimore të papërdorura dhe kreditimet tatimore të papërdorura. Aktivët tatimore të shtyra janë rishikuar në çdo datë raportimi dhe janë pakësuar për pjesën mbi të cilën nuk është më e mundur të realizohet përfitimi fiskal. Aktive tatimore të shtyra të panjohura rivlerësohen në çdo datë raportimi dhe njihen në masën që bëhet e mundur që fitime të ardhshme të tatueshme do jenë të disponueshme kundrejt të cilave ato mund të përdoren. Shuma e tatimit të shtyrë llogaritet në normën e tatimit që pritët të aplikohet në diferencat e përkohshme kur ato rimerren, bazuar në legjislacionin tatimor në fuqi ose që hyn në fuqi në datën e raportimit. Matja e tatimit të shtyrë reflekton pasojat tatimore që do duhet të ndiqen nga mënyra se si Shoqëria pret, në datën e raportimit, të rikuperojë ose shlyejë vlerën e mbartur të aktiveve ose detyrimeve të veta. Aktivit tatimor i shtyrë kompensohet me detyrimin tatimor të shtyre vetëm në qoftë se kritere të caktuara përmbushen.

Eurosig sh.a.

Shënime shpjeguese për Pasqyrat Financiare Individuale

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

5. Gjykime të rëndësishme kontabël në zbatimin e politikave kontabël të shoqërisë

Këto shënime shpjeguese i shtohen shpjegimeve në lidhje me manaxhimin e rrezikut financiar (shënimi 35) dhe manaxhimit të rrezikut të sigurimit.

Shoqëria kryen vlerësime dhe supozime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që kryhen në përgjithësi ndryshojnë nga rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe gjykimet të cilat mbartin rrezikun e krijimit të ndonjë sistemimi të rëndësishëm në vlerën e mbetur të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit financiar në vijim diskutohen më poshtë.

Burimet kryesore të pasigurisë së vlerësimeve

Provizionet për humbjet e kredisë

Aktivitet paraqiten me kosto të amortizuar dhe rishqyrtohen për zhvlerësim bazuar në përshkrimet e politikës kontabël në shënimin 4, mbi zhvlerësimin e aktiveve financiare. Komponenti individual në totalin e provizioneve aplikohet ndaj dëmeve të vlerësuara individualisht për provigjion dhe bazohet në vlerësimet më të mira të manaxhimit mbi vlerën aktuale të flukseve monetare të pritshme për t'u arkëtuar. Në vlerësimin e këtyre flukseve monetare, manaxhimi kryen vlerësimet të situatës financiare të palës përkatëse dhe vlerës së realizueshme neto të kolateralëve mbështetës.

Vlerësimi i pasigurisë në lidhje me provigjionet

Vlerësimet më të rëndësishme në lidhje me pasqyrat individuale financiare të shoqërisë lidhen me provizionet. Shoqëria zbaton parimin e kujdesit të arsyeshëm në lidhje me provizionimin dhe aplikon rregulla dhe rregullore të përcaktuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Shqipërisë si edhe ato të përshkruara në shënimin 4. Shoqëria punëson matematicienë në pozicionin e aktuarit.

Politika e Shoqërisë është bërja e provizionit për rrezikun e paskaduar që krijohet nga sigurimet e jo-jetës ku dëmet dhe shpenzimet administrative të cilat mund të lindin pas fundit të vitit financiar në lidhje me kontrata të lidhura para asaj date priten të tejkalojnë primet e pafituar dhe atë të vlefshëm sipas këtyre kontratave. Drejtimi është i besimit se niveli i rezervave teknike është i mjaftueshëm. Manaxhimi i rrezikut të sigurimit paraqitet në detaje në shënimin 5, ndërkohë provizionet e kontratave të sigurimit analizohen në shënimin 17.

Drejtimi i Shoqërisë është i mendimit se nuk ka rreziqe të rëndësishme në lidhje me sa më sipër në datën e raportimit.

Gjykime të rëndësishme kontabël të bëra në zbatim të politikave kontabël të shoqërisë përfshijnë:

Manaxhimi i rrezikut të sigurimit

Shoqëria është ekspozuar ndaj rrezikut aktuarial dhe atij të marrjes në sigurim që krijohen nga gama e gjërë e produkteve të ofruara të jo-jetës (sigurime motorrike, sigurime të marinës, sigurime të pronës, sigurime të mallrave të transportit, sigurime të ndërtimit, sigurime të përgjegjësisë civile, sigurime të garancisë). Rreziku i sigurimit lidhet me pasigurinë e tregut të sigurimeve. Komponentët kryesorë të rrezikut të sigurimit janë rreziku i primit dhe rreziku i rezervës. Këto lidhen me përshtatshmërinë e niveleve të primeve dhe përshtatshmërinë e provigjioneve në lidhje me detyrimet e sigurimeve dhe kapitalit. Rreziku i primit është i pranishëm kur polica emetohet para ndodhjes së çdo ngjarjeje të siguruar. Rreziku ka të bëjë me faktin që shpenzimet dhe humbjet që ndodhin mund të jenë më të larta se primi i marre.

Eurosig sh.a.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare Individuale

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

5. Gjykime të rëndësishme kontabël në zbatimin e politikave kontabël të shoqërisë (vazhdim)

Rreziku i rezervës paraqet rrezikun që niveli absolut i rezervave teknike është i gabuar ose që dëmet e ndodhura do të ndryshojnë nga mesatarja statistikore. Rreziku i marrjes në sigurim për jo-jetën përfshin edhe rrezikun e katastrofës, i cili përfshin ngjarjet e parregullta të cilat nuk janë mjaftueshmërisht të mbuluara nga primet dhe rezerva e rrezikut.

Manaxhimi i rrezikut

Shoqëria manaxhon rrezikun e sigurimit përmes kufijve të marrjes në sigurim, procedurave të aprovimit për transaksionet që përfshijnë produktet e reja apo tejkalojnë limitet e vendosura, çmimin, dizenjimin e produktit dhe manaxhimin e risigurimit.

Të gjitha kontratat e jo-jetës (përveç pasurisë dhe aksidenteve) janë me natyrë vjetore dhe marrësit në sigurim kanë të drejtë të ndryshojnë termat dhe kushtet e kontratës në rinovim.

Shoqëria risiguron një pjesë të rreziqeve që merr në sigurim për të kontrolluar ekspozimin e saj ndaj humbjeve dhe për të mbrojtur burimet kapitale. Shoqëria hyn në marrëveshje risigurimi përpjestimore ose jo për të reduktuar ekspozimin neto ndaj rreziqeve të veçanta në aksidente, pasuri, transport, mjetemotorike, MTPL. Risigurimi i ceduar përmban risk kredie dhe risigurimi që mund të rimerret raportohet pas zbritjes të zërave që njihen si të pa mbledhshëm.

Përqendrimi i rrezikut të sigurimit

Një aspekt kryesor i rrezikut të sigurimit me të cilin përballet Shoqëria është shtrirja e përqendrimit të rrezikut të sigurimit, i cili përcakton shtrirjen e ndikimit në detyrimet e shoqërisë së një ose disa ngjarjeve të veçanta. Këto përqendrime mund të lindin nga një kontratë e vetme sigurimi ose nëpërmjet një numër kontratash të lidhura nga të cilat mund të lindin detyrime të rëndësishme. Një aspekt i rëndësishëm i përqendrimit të rrezikut të sigurimit është fakti që ai mund të lindë nga akumulimi i rreziqeve brenda një numri klasash të ndryshme sigurimi.

Përqendrimet e rreziqeve mund të lindin rrallë nga ngjarje shumë të rënda si shkatërrimet natyrore, në situata kur Shoqëria është e ekspozuar ndaj ndryshimeve të papritura në tendenca, për shembull, ndryshime të papritura në sjelljen e policmbajtësve; ose kur risqe të rëndësishme konfliktesh apo ligjore mund të sjellin një humbje të vetme të madhe, ose të kenë një efekt të shpërndarë në shumë kontrata.

Rreziqet e marra në sigurim nga Shoqëria janë të përqendruara në Shqipëri.

Përqendrimi i rreziqeve të sigurimit para dhe pas risigurimit në lidhje me llojin e rrezikut të sigurimit të pranuar, duke iu referuar vlerës së mbetur të dëmeve dhe përfitimeve të ndodhura (risigurimi bruto dhe neto) që vijnë nga kontratat e sigurimit, përmbledhet më poshtë me shënimin 17.

Drejtimi është i mendimit se nuk ka përqendrim të rëndësishëm në ndonjë grup të caktuar policmbajtësish duke marrë parasysh kritere sociale, profesionale, moshe, ose kritere të tjera të ngjashme me këto.

- Mundësia më e madhe e humbjeve të rëndësishme për Shoqërinë vjen nga ngjarjet katastrofike, si dëme nga stuhi, rrëshqitje, përmytje apo tërmete. Teknikat dhe supozimet që shoqëria përdor për llogaritjen e këtyre rreziqeve janë si më poshtë:
- Matja e përqendrimit gjeografik.
- Vlerësimi maksimal i humbjeve të mundshme.
- Risigurimi.

Eurosig sh.a.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare Individuale

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

5. Gjykime të rëndësishme kontabël në zbatimin e politikave kontabël të shoqërisë (vazhdim)*Supozimet kryesore që kanë efektin më të madh në aktivet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e njohura të sigurimit*

Provizioni bëhet në datën e raportimit për kostot përfundimtare të pritshme të shlyerjes për të gjitha dëmet e ndodhura në lidhje me ngjarje deri në atë datë, pavarësisht nëse janë të raportuara apo jo, bashkë me shpenzimet e administrimit të dëmeve, minus shumat e paguara.

Detyrimi për dëmet e raportuara por jo të paguara (RBNS) vlerësohet si i ndarë rast pas rasti duke i dhënë rëndësinë e duhur shkaqeve të dëmit, informacionit të marrë nga vlerësuesit e humbjes dhe nga të dhënat historike të përmasave të dëmeve të ngjashme. Rezervat e rasteve rishqyrtohen rregullisht dhe përditësohen kur ka informacion të ri.

Vlerësimi i dëmeve të ndodhura por të pa-raportuara (IBNR) është përgjithësisht subjekt i një shkalle më të lartë pasigurie sesa për dëmet të raportuara. Provizionet e IBNR janë kryesisht të vlerësuara nga aktuarët e Shoqërisë duke përdorur teknika statistikore, përmes të cilave të dhënat historike përdoren në mënyrë që të bëhet një vlerësim i kostove përfundimtare të dëmeve.

Metoda bazë për vlerësimin e IBNR është metoda zinxhir, e cila përdor të dhëna historike për të vlerësuar pjesët e paguara dhe ato që kanë ndodhur në koston përfundimtare të dëmit. Metoda e përdorur varion nga viti i aksidentit që merret për bazë, produkti dhe zhvillimet historike të dëmeve.

Duke qenë se këto metoda përdorin informacion historik të zhvillimit të dëmeve ato supozojnë se modeli i zhvillimit historik të dëmeve do të ndodhë përsëri në të ardhmen. Ka disa arsye përse kjo gjë nuk është e thënë të ndodhë duke qenë se identifikimi i ngjarjes varet nga modifikimi i metodave. Arsyetë tilla përfshijnë:

- tendencat ekonomike, ligjore, politike dhe sociale (që rezultojnë në nivelet e ndryshme rritjeje nga ajo e pritshme);
- ndryshime përbërjen e kontratave të marra në sigurim;
- luhatje të rastësishme, duke përfshirë ndikimin e humbjeve të mëdha.

Provizionet për IBNR janë fillimisht të vlerësuara në nivel bruto dhe më pas kryhet një llogaritje e veçantë për të vlerësuar masën e mbulimeve të risigurimit.

Supozimet të cilat kanë efektin më të madh në matjen e detyrimit për sigurimin e jo-jetës janë si më poshtë:

Norma e dëmeve të pritshme

Normat e dëmeve të pritshme është norma e dëmeve të pritshme për të ndodhur ndaj primeve të fituara. Supozimet në lidhje me normat e dëmeve të pritshme për vitet më të fundit të aksidenteve, sipas produktit, kanë ndikimin më të madh në nivelin e provigjioneve.

Distanca kohore

Për produktet me distancë kohore midis ndodhjes së dëmeve, niveli i provigjioneve influencohet shumë nga vlerësimi i zhvillimit të dëmeve nga viti më i fundit i zhvillimit për të cilin të dhënat historike janë të vlefshme deri në shlyerjen më të fundit. Këta faktorë vlerësohen me kujdes bazuar në eksperiencë.

Skontimi

Provizionet e jo-jetës nuk skontojnë.

Testimi i mjaftueshmërisë së detyrimeve

Detyrimet e sigurimeve llogariten duke përdorur supozime historike.

Testimi i mjaftueshmërisë së detyrimeve për sigurimin e jo-jetës është i kufizuar në pjesën e pafituar të kontratave ekzistuese. Ky testim kryhet duke krahasuar vlerën e pritshme të shpenzimeve të dëmeve kundrejt periudhës së pafituar të policave efektive në datën e raportimit me shumën e primeve të pafituar në lidhje me

Eurosig sh.a.

Shënime shpjeguese për Pasqyrat Financiare Individuale

(Të gjitha shumatat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

5. Gjykime të rëndësishme kontabël në zbatimin e politikave kontabël të shoqërisë (vazhdim)

këto polica pas zbritjes së kostove direkte. Duke zbatuar parimin e prudences, për këtë qëllim Shoqëria përfshin edhe shpenzimet administrative në kalkulum. Flukset e pritshme monetare në lidhje me dëmet dhe shpenzimet vlerësohen duke iu referuar eksperiencës gjatë pjesës së skaduar të kontratës duke rregulluar me humbjet e rëndësishme individuale të cilat nuk pritet të ndodhin.

Testimi kryhet në bazë portofoli. Nëse testi tregon se detyrimi është i mjaftueshëm, e gjithë diferenca njihet në të ardhura dhe shpenzime. Bazuar në këtë testim për 31 dhjetor 2022 Shoqëria ka njohur rezerva shtesë në formën e rezervave të primit të paskaduar.

Ndeshmëria e vlerës aktuale të fitimeve të ardhshme ndaj ndryshimeve në elementë të rëndësishëm

Faktorë që do të kishin ndikimin më të madh në detyrimet e sigurimeve në sigurimet e jo-jetës janë të lidhur me ndryshimet e tendencave të shpenzimeve për polica, ligjore, ekonomike dhe sociale. Drejtimi është i besimit se kuantifikimi i ndeshmërisë të rezervave të jo-jetës ndaj elementëve të mësipërm nuk është praktik.

Kushtet e kontratave të sigurimeve që kanë ndikim material në shumën, kohën dhe pasigurinë e flukseve të ardhshme të parasë

Shoqëria ofron lloje të ndryshme të sigurimit të jo-jetës, kryesisht sigurimin e mjeteve motorike për detyrimet ndaj palëve të treta, aksidentet, shëndetin, pasurinë, sigurimin kasko, detyrimet e përgjithshme dhe sigurimin e mallrave në transport (kargo). Kontratat mund të nënshkruhen për një periudhë fikse një-vjeçare ose mund të jenë te papërcaktuara në vijimësi duke i dhënë të drejtën njëres palë apo tjetres ta prishë kontratën sipas rastit. Shoqëria është gjithashtu e aftë të rikompensojë rrezikun duke rregulluar primin në intervale kohe jo më të mëdha se një vit. Shoqëria mund të vendosë zbritje për mbulimin dhe të refuzojë dëme që mund të jenë mashtrime.

Dëmet e ardhshme të sigurimeve janë burimi kryesor i pasigurisë e cila ndikon shumën dhe kohën e flukseve të ardhshme të parasë. Shuma e pagesës për një dëm të veçantë është e limituar nga shumata e siguruar, e përcaktuar në policën e sigurimit. Një tjetër burim i rëndësishëm i pasigurisë vjen nga rregullimet ligjore të cilat i japin të drejtën mbajtësit të policës të reklamojë dëmet e tij para dekretit të kufizimit, e cila është efektive 3 vjet nga data kur mbajtësi i policës bëhet i vetëdijshëm për dëmin por jo më vonë se 5 vjet nga fillimi i vitit në vijimësi të vitit kur ngjarja ka ndodhur. Kjo anë është veçanërisht e rëndësishme në rastet e një pamundësie të përkohshme që rrjedh nga siguri i aksidentit dhe dëmtimeve personale nga siguri i detyrimeve ndaj palëve të treta, për shkak të vështirësisë së vlerësimit të periudhës ndërmjet ndodhjes së ngjarjes dhe konfirmimit të efekteve përhershme. Karakteristikat e llojeve të veçanta të sigurimeve, nëse ato ndryshojnë në mënyrë thelbësore nga veçoritë e përmendura më sipër, janë të përshkruara më poshtë.

Sigurimi i mjeteve motorike

Portofoli i mjeteve motorike përfshin si MTPL ashtu dhe kasko. Sigurimi MTPL mbulon si dëmtimet trupore dhe ato pasurore. shoqëria nuk ofron siguri për dëmet e shkaktuara jashtë vendit për personat e siguruar, sistemi i kartonit jeshil.

Eurosig sh.a.

Shënime shpjeguese për Pasqyrat Financiare Individuale

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

5. Gjykime të rëndësishme kontabël në zbatimin e politikave kontabël të shoqërisë (vazhdim)

Kushtet e kontratave të sigurimeve që kanë ndikim material në shumën, kohën dhe pasigurinë e flukseve të ardhshme të parasë

Dëmet e pasurisë në dëmet MTPL dhe kasko raportohen dhe shlyhen përgjithësisht brenda një kohe të shkurtër pas ngjarjes së aksidentit. Raportimi dhe pagesa për dëmtimet trupore nga ana tjetër kërkon një kohë më të gjatë për t'u finalizuar. Këto dëmtime janë më të vështira për t'u vlerësuar. Këto dëme mund të shlyhen në formën e një shume të vetme apo nëpërmjet shumave të përvitshme.

Shuma e dëmeve në lidhje me dëmtimet trupore dhe humbjet përkatëse të fitimit ndikohen nga praktikat gjyqësore.

MTPL rregullohet me ligjin për sigurimin e përgjegjësive nga mjetet motorike ndaj palëve të treta dhe nga detyrime të tjera ligjore për sigurimet. Tarifat dhe shumat minimale të siguruara rregullohen me ligj. Policmbajtësit kanë të drejtën e bonuseve përveç rasteve të dëmeve për rinovimin e polices së tyre kur plotësohen kushtet.

Sigurimi kasko ka të bëjë me sigurim standard kundër dëmtimeve; pagesa e demit kufizohet nga shuma e siguruar.

Dëmet njihen normalisht direkt dhe mund të shlyhen pa vonesa.

Sigurimi i pasurisë

Sigurimi i pasurisë ndahet në linjat industriale dhe personale. Për linjat industriale, shoqëria përdor teknikat e manaxhimit të rrezikut për identifikimin e rreziqeve dhe analizën e humbjeve si dhe bashkëpunon me risiguruesit. Sigurimi i pasurisë personale konsiston në sigurimin e ndërtesës dhe përmbajtjeve të saj.

Dëmet njihen normalisht direkt dhe mund të shlyhen pa vonesa.

Sigurimi i përgjegjësive

Mbulongjithëllojet e përgjegjësive dhe përfshin përgjegjësinë e zhdëmtimeve tregtare dhe profesionale si dhe përgjegjësinë personale.

Ndërkohë që mbulimi i shumicës së përgjegjësive të përgjithshme nënshkruhet në bazë të demit, disa mbulime sigurohen në bazë të ngjarjes.

Sigurimi i aksidenteve

Shitet tradicionalisht si skemë për grupe punonjësish ose si një shtesë ndaj produkteve MTPL.

Shëndeti në udhëtim

Mbulon gjithë dëmtimet dhe aksidentet e tjera personale gjatë udhëtimeve jashtë vendit.

Eurosig sh.a.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare Individuale

(Të gjitha shumatat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

6. Aktive afatgjatë materiale

	Toka, troje dhe terrene	Ndërtesa	Instalime, mobilje dhe pajisje	Automjete	Permireshime të ambienteve të marra me qera	Totali
Kosto						
Gjendja më 1 janar 2021	-	109,248	322,033	156,142	103,226	690,649
Shtesa		1,200	5,139	3,226	-	9,565
Rivleresime		37,050				37,050
Pakësime						-
Gjendja më 31 dhjetor 2021	-	147,498	327,172	159,368	103,226	737,264
Shtesa	-	-	6,365	-	-	6,365
Rivleresime	-	-	-	-	-	-
Pakësime	-	-	-	(2,126)	-	(2,126)
Gjendja më 31 dhjetor 2022	-	147,498	333,537	157,242	103,226	741,503
Amortizimi i akumuluar						
Gjendja më 1 janar 2021	-	15,737	291,878	120,401	79,064	507,080
Amortizimi i vitit		5,389	6,590	7,417	1,208	20,604
Pakësime		(19,240)	-	-	-	(19,240)
Gjendja më 31 dhjetor 2021	-	1,886	298,468	127,818	80,272	508,444
Amortizimi i vitit		7,287	6,025	6,311	1,148	20,771
Pakësime		-	-	(2,126)	-	(2,126)
Gjendja më 31 dhjetor 2022	-	9,173	304,493	132,004	81,420	527,089
Vlera neto kontabël						
Gjendja më 31 dhjetor 2021	-	145,612	28,704	31,550	22,954	228,820
Gjendja më 31 dhjetor 2022	-	138,325	29,044	25,239	21,806	214,414

Vlera e drejtë e ndërtesave është përcaktuar nga vlerësues të jashtëm, të pavarur, të cilët janë të pajisur kualifikime profesionale të njohura si edhe kanë eksperiencë të kohëve të fundit lidhur me vendndodhjen dhe kategorinë e pasurisë subjekt vlerësimi. Matja e vlerës së drejtë për këto prona është kategorizuar sipas nivelit 3 të vlerës së drejtë. Në bazë të testit të vlerës të kryer nga Shoqëria më 31 dhjetor 2022, nuk rezultoi nevojë për zhvlerësim të këtyre ndërtesave.

Me anë të vendimit të asamblesë së aksionarëve në datë 14 shtator 2021 shoqëria ka kthyer asetet ndërtues të blera nga Insig jo jetë me vlerë neto 205,317 mijë lekë.

Eurosig sh.a.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare Individuale

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

7. Aktive afatgjata jomateriale

	AAJM	Total
Me kosto		
Gjendja më 1 janar 2021	20,054	20,054
Shtesa	1,494	1,494
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2021	21,548	21,548
Shtesa	1,900	1,900
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2022	23,448	23,448
Amortizimi		
Gjendja më 1 janar 2021	16,470	16,470
Amortizimi i vitit	392	392
Kthim amortizimi	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2021	16,862	16,862
Amortizimi i vitit	570	570
Kthim amortizimi	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2022	17,432	17,432
Gjendja neto më 31 dhjetor 2021	4,686	4,686
Gjendja neto më 31 dhjetor 2022	6,017	6,017

8. Të drejta të përdorimit të aseteve

Lëvizjet e aktiveve në përdorim për vitin 2022 janë si më poshtë:

Vlera bruto	Ndertesë
1 janar 2021	102,997
shtesa	6,078
pakesime	(9,015)
Gjendja më 31 dhjetor 2021	100,060
Shtesa	101,905
Pakesime	(3,500)
Gjendja më 31 dhjetor 2022	198,465
Zhvlerësimi i akumuluar	
1 janar 2021	61,808
shtesa	34,471
pakesime	(7,073)
Gjendja më 31 dhjetor 2021	89,206
Shtesa	35,457
Pakesime	(1,203)
Gjendja më 31 dhjetor 2022	123,460
Vlera Neto me 31 dhjetor 2021	10,854
Vlera Neto me 31 dhjetor 2022	75,005

Eurosig sh.a.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare Individuale

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

9. Depozita me afat

Depozitat me afat në banka përbëhen nga depozita dhe interesi i maturuar përkatës. Depozitat janë me afat maturimi më shumë se 1 vit, kanë norma fikse interesi dhe në bazë të detyrimeve ligjore janë të gjitha të depozituara në bankat shqiptare.

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Depozita me afat në banka	486,673	490,410
	486,673	490,410

Sipas monedhave

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Depozita me afat		
LEK	476,150	476,092
EUR	485	485
Interes i përlogaritur/(parapagime)	10,038	13,833
	486,673	490,410

Normat e interesit nga depozitat paraqiten më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
LEK	0.6% - 6.0%	1.9% - 3.20%
EUR	0.03% - 0.55%	0.01% - 1.00%

Bazuar në kërkesat e vendimit nr. 2, më datë 23 janar 2006, për aprovimin e rregullores “Mbi rregullimin dhe limitet e investimit të kapitalit të kompanive të sigurimit” të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, kompanitë e sigurimit nuk u lejohet të investojnë në të njëjtën bankë lokale mbi 25% të kapitalit të tyre. Shoqëria gjate vitit, me miratimin paraprak të AMF-së, ka transferuar depozitat midis bankave të ndryshme brenda Republikës së Shqipërisë. Analiza e depozitave sipas bankave paraqitet si më poshtë:

Sipas bankave	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Intesa San Paolo/ Veneto Bank	48,813	48,813
First Investment Bank (“FIB”)	117,474	117,389
Union Bank	114,676	114,676
Credins Bank	458	485
United Bank of Albania (“UBA”)	175,882	175,882
Tirana Bank	19,332	19,332
	476,635	476,577

Eurosig sh.a.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare Individuale

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

10. Pjesa e risiguruesit në provizionet e kontratave të sigurimit

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Jo-jetë		
Pjesa e risiguruesit në provigjionet e primeve të pafituara	29,086	10,848
Provigjone të dëmeve, pjesa e risiguruesve	335,847	278,514
	<u>364,933</u>	<u>289,362</u>

a) Analiza e rezervës së risiguruesit për primet e pafituara sipas produktit:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Të tjera vullnetare	17,079	3,890
Zjarri dhe rreziqet shtesë	12,007	6,958
	<u>29,086</u>	<u>10,848</u>

b) Analiza e rezervës të risiguruesit për dëmet:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Motorike (MTPL)	26,282	-
Të tjera vullnetare	114,230	120,760
Karton Jeshil	178,468	157,454
Zjarri dhe rreziqet shtesë	16,867	300
	<u>335,847</u>	<u>278,514</u>

Shoqëria ka njohur rezerva të risiguruesit për dëmet me 31 dhjetor 2022 bazuar me kontratat e risigurimit dhe vlerësimin e dëmeve.

11. Llogari të arkëtueshme nga sigurimi dhe risigurimi

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Të drejta nga kontrata të sigurimit		
- nga polic - mbajtësit (bruto)	268,270	204,895
Minus: Fondi i provigjionit për humbjet kreditore	(148,630)	(148,630)
	<u>119,640</u>	<u>56,265</u>

Lëvizjet në fondin e provizionit paraqiten si më poshtë :

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Gjendja me 1 janar	148,630	146,091
Rimarrje zhvleresimi	-	-
Shtesa	-	2,539
Gjendje me 31 dhjetor	<u>148,630</u>	<u>148,630</u>

Eurosig sh.a.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare Individuale

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

12. Kosto te shtyra të marrjes në sigurim

Si pjesë e aktiviteteve të Shoqërisë disa kosto janë të shtyra (komisionet). Një analizë e kostove të shtyra është paraqitur në tabelën më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Ne 1 janar	472,824	419,718
Rritje / (Renie) ne kosto të marra në sigurim	(131,800)	53,106
Me 31 dhjetor	341,024	472,824

Rënie e kostove të shtyra nga viti paraardhës vjen si rezultat i uljeve të komisioneve të agjenteve, kërkesë kjo nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare.

13. Investime në shoqëri të kontrolluara

Më 14 maj 2015, Shoqëria përfundoi një marrëveshje për blerjen 100% të 100,000 aksioneve të Dardania sh.a një shoqëri sigurimi që vepron në Republikën e Kosovës. Vlera nominale për aksion ishte 30 Euro, çmimi i rënë dakord ndërmjet palëve ka qenë i barabartë me 3,000 mijë Euro (421,680 mijë Lek). Sipas marrëveshjes së blerjes së aksioneve, çmimi i blerjes u pagua në dy këste prej 2,851 mijë euro transferuar më 16 mars 2015 dhe 149 mijë euro më 20 nëntor 2015. Në dhjetor 2015, Dardania Sh.a ndërroi emrin në Eurosig Kosova Sh.a. Më 18 prill 2016, Shoqëria injektoi kapital shtesë në para në vlerën prej 1,210 mijë Euro në Eurosig sh.a – Kosova. Më 8 qershor 2018, Shoqëria injektoi kapital shtesë në para në vlerë të prej 300,000 mijë Euro në Eurosig sh.a – Kosova. Më 25 qershor 2018, Shoqëria injektoi kapital shtesë në natyrë në vlerë prej 1,500,000 mijë Euro në Eurosig sh.a – Kosova.

Gjatë vitit 2021 Shoqëria rriti kapitalin në para me 1,000,000 Euro nëpërmjet pagesës më datë 30 qershor 2021.

Më 24 shkurt 2017, BQK mori vendimin për vendosjen e një administratori të përkohshëm në shoqërinë Eurosig KS me qëllim rikuperimin e stabilitetit të pozicionit financiar të shoqërisë. Me vendimin e datës 26 korrik 2019, nr 44-19/2019 të BQK “Për përfundimin e administrimit të përkohshëm të siguruesit, siguruesi “Eurosig” Kosovë doli nga administrimi i përkohshëm.

Në vitin 2016, Shoqëria përfundoi një marrëveshje për blerjen 100% të 100,000 aksioneve të Insig sh.a një shoqëri sigurimi që vepron në Shqipëri. Më 1 Qershor 2016, Eurosig sh.a bazuar në kontratën e shitblerjes së aksioneve të Insig sh.a u bë aksioner i vetëm i kësaj kompanie. Vlera nominale për aksion ishte 600,000 Lek; çmimi i rënë dakord ndërmjet palëve ishte i barabartë me vlerën nominale të aksioneve të blera ose 2,222,122 mijë lekë. Sipas marrëveshjes së blerjes së aksioneve, çmimi i blerjes u pagua në tre këste prej 238,000 mijë Lek ; 1,954,122 mijë Lek dhe 30,000 mijë Lek.

Shoqëria, me anë të vendimit të Aksionareve numër 16, datë 23 dhjetor 2016 vendosi:

- 1) miratimin e ndarjes së Shoqërisë Insig sh.a në dy Shoqëri pritëse të themeluara rishtazi: Insig sh.a (shoqëri sigurimi jo-jete) dhe Insig Jete sh.a
- 2) miratimin e marrëveshjes së ndarjes së Shoqërisë Insig sh.a në dy shoqëri pritëse të themeluara rishtazi Insig sh.a (shoqëri sigurimi jo-jete) dhe Insig Jete.

Ndarja hyri në fuqi në datë 1 janar 2017. Shoqëria Insig Jeta u krijua me një kapital prej 370 000 mijë lekë i përbërë nga 616 aksione, me vlerë nominale 600,649.35 për aksion, 100% të zotëruara nga Eurosig Sh.a.

Eurosig sh.a.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare Individuale

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

13. Investime në shoqëri të kontrolluara (vazhdim)

Më 31 dhjetor 2022 shoqëria zotëron 100% të aksioneve të Insig jetë sha.

Të dhënat mbi Investimet e kontrolluara në Shoqëri tregohen si më poshtë:

Emri	Adresa	Aktiviteti Kryesor	2022 % e pjesemarrjes	Vlera 000 LEK	2021 % e pjesemarrjes	2021 Vlera 000 LEK
Eurosig Kosova Sh.a	Rr. Suljman Vokshi Nr 4 Prishtine, Kosove	Shoqëri Sigurimesh	100%	1,303,380	100%	1,118,380
Insig Jo-Jete Sh.a	Rr.Jul Variboba Nr. 21, Tirane, Shqipëri	Shoqëri Sigurimesh	100%	1,852,122	100%	1,852,122
Insig Jete Sh.a	Rr Labinoti, Nr 77 Tiranë, Shqipëri	Shoqëri Sigurimesh	100%	590,000	100%	590,000
United Bank of Albania	RR. Dritan Hoxha, Nd. 11, H.3, Njesia Bashkiake Nr. 7, Tirane 1023, Shqipëri	Shoqëri Sigurimesh	66%	869,193	51%	-
				4,614,695		3,560,502

14. Investimi në tituj kapitali të shoqërive të tjera

Më 31 korrik 2019, u aprovua nga asambleja e aksionereve blerja e 9% të aksioneve të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë për çmimin 115,000,000 Lek. Kontrata e shitblerjes së kuotave u realizua me 1 gusht 2019. Më 17 dhjetor 2019, asambleja e aksionerëve e Bankës së Bashkuar të Shqipërisë vendosi rritjen e kapitalit me 1 milion USD. Eurosig kreu pagesën e 90,200 USD me datë 30.12.2019.

Më 7 prill 2021 u aprovua nga asambleja e aksionarëve blerja e 8,027 aksioneve pranë Bankës së Bashkuar të Shqipërisë me një çmim total prej 168,567 USD. Kontrata e shitblerjes së kuotave u realizua më datë 09 qershor 2021. Më 28 tetor 2021 u aprovua nga asambleja e aksionarëve blerja e 12,673 aksioneve pranë Bankës së Bashkuar të Shqipërisë me një çmim total prej 266,133 USD. Kontrata e shitblerjes së kuotave u realizua më datë 07 dhjetor 2021. Më 10 nëntor 2021 u aprovua nga asambleja e aksionarëve blerja e 12,848 aksioneve pranë Bankës së Bashkuar të Shqipërisë me një çmim total prej 269,808 USD. Kontrata e shitblerjes së kuotave u realizua më datë 13 nëntor 2021. Më datë 19 shkurt 2021, asambleja e aksionerëve e Bankës së Bashkuar të Shqipërisë vendosi rritjen e kapitalit me 894,094 USD. Eurosig kreu pagesën e më datë 19 shkurt 2021. Më datë 09 korrik 2021, asambleja e aksionerëve e Bankës së Bashkuar të Shqipërisë vendosi shitjen e 30% të aksioneve të ISDB kundrejt Eurosig sha sipas kontratës nr 3493 no kol. 1967 datë 09.07.2021. Eurosig kreu pagesën më datë 29 korrik 2021 shumën prej 412,496,857 lek. Banka e Shqipërisë ka aprovuar kalimin e aksioneve.

Në bazë të kontratës midis Eurosig sha dhe Ithmaar Bank B.S.C date 03 tetor 2022 me nr. 5754, Eurosig sha ka blere 4.303% të aksioneve të zotëruara nga Ithmaar Bank B.S.C ne vleeën 405.536 USD, me çmim 16USD/ aksion.

Në dhjetor të vitit 2022 Banka e Bashkuar e Shqipërisë ka kryer emetimin e aksioneve të reja dhe rritje të kapitalit të saj aksionar. Aksionet e reja u janë ofruar aksionarëve të Bankës. Në kushtet ku asnjë prej aksionarëve ekzistues të Bankës nuk ka ekzekutuar të drejtën e tyre për blerjen e aksioneve të reja, Eurosig sha ka kryer blerjen e 100% të aksioneve të reja të emetuara. Numri i aksioneve të reja të emetuara është 191.034 aksione me çmimi i blerjes prej 16 USD/aksion. Pas këtij transaksioni Eurosig sha zotëron 65.58% të aksioneve të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë.

Eurosig sh.a.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare Individuale

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

14. Investimi në tituj kapitali të shoqërive të tjera (vazhdim)

Analiza e investimeve në tituj kapitali paraqitet si më poshtë për të dy vitet:

Emri	Aktiviteti Kryesor	2022 % e pjesemarrjes	2022 Vlera 000 LEK	2021 % e pjesemarrjes	2021 Vlera 000 LEK
United Bank of Albania	Banke	-	-	51%	482,002
Eurosig Invest	Shoqeri Investimi	49%	3,920	-	-
			3,920		482,002

15. Aktive të tjera

Dëme me paditë e regresit lidhen me pagesa të kryera nga Shoqëria për të shlyer dëme të shkaktuara nga një palë e pasiguarur dhe që priten të arkëtohen si rrjedhojë e vendimeve gjyqësore. Këto pagesa janë kryer në vijim të direktivave të Byrosë Shqiptare të Sigurimeve si dhe në përputhje me kuadrin rregullator përkatës. Këto padi janë në procese gjyqësore të nisura nga Banka Shqiptare e Sigurimeve dhe përfaqësuara në gjykatë nga vetë Shoqëria.

Debitorë të tjerë, agjentët e Eurosig, paraqet vlerën e financimeve të dhëna agjentëve të punësuar me qëllim përballimin e operacioneve të shitjeve të detyrueshme për muajt në vijim.

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Parapagime	-	-
Shpenzime të shtyra	690	318
	690	318
Debitor	337	392
Garanci per kartonin jeshil	66,329	61,184
Debitorë të tjerë, agjentët e Eurosig	342,514	286,986
Zhvlerësime për te arketueshme nga agjentët	(266,986)	(266,986)
Dëme me padi regresi	1,583	1,537
Garanci bankare	14,651	-
Debitore per fond kompesnimi	4,408	12,645
Parapagime ndaj pronarit	8,700	102,447
Aktive te tjera financiare	171,536	198,205
	172,226	198,523

Eurosig sh.a.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare Individuale

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

16. Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Arka	455	538
LEK	455	538
EUR	-	-
Llogari rrjedhëse në banka	3,384	11,676
LEK	2,670	8,822
EUR	681	2,806
USD	33	48
	3,839	12,214

17. Provizione për kontratat e sigurimit

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Provizione për primet e pafituara	1,306,196	1,153,468
Rezerva për demet e raportuara por te pashlyera-RBNS	1,492,188	1,200,760
Rezerva për dëme e ndodhura të pa-raportuara-IBNR	428,337	299,457
	3,226,721	2,653,685

a) Analizë e lëvizjes së provizioneve për primet e pafituar

	2022 Bruto	2022 Risigurim	2022 Neto
Gjendje më 1 janar	1,153,468	10,848	1,142,620
Prime e shkruar gjatë vitit	2,605,983	(126,310)	2,732,293
Minus: Prime të fituar gjatë vitit	(2,453,255)	144,548	(2,597,803)
Gjendje më 31 dhjetor	1,306,196	29,086	1,277,110

Analiza e primeve sipas produktit paraqitet në shënimin 22 të këtyre pasqyrave financiare.

b) Analizë e lëvizjeve të rezervave për dëmet pezull-RBNS

	2022 Bruto	2022 Risigurim	2022 Neto
Gjendje më 1 janar	1,200,760	278,514	922,246
Dëme gjatë vitit	292,123	57,245	234,877
Dëme e paguara	(695)	88	(607)
Gjendje më 31 dhjetor	1,492,188	335,847	1,156,516

	2022 Bruto	2022 Risigurim	2022 Neto
Gjendje më 1 janar	299,457	-	299,457
Ndryshimi gjatë vitit	128,880	-	128,880
Gjendje më 31 dhjetor	428,337	-	428,337

Eurosig sh.a.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare Individuale

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

17. Provizione për kontratat e sigurimit (vazhdim)**Analiza e Provizioneve bruto RBNS e pastër sipas produkteve**

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Motorike (MTPL)	603,875	346,439
Kufitare	4,122	2,280
Shëndeti në udhëtim dhe aksidentet	35,766	44,035
Të tjera vullnetare	245,991	236,330
Motorike (kasko)	50,418	32,044
Karton Jeshil	487,026	381,060
Zjarri dhe rreziqet shtesë	64,990	74,058
	1,492,188	1,116,246

Analiza e Provizioneve bruto IBNR e pastër sipas produkteve

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Motorike (MTPL)	383,339	237,750
Kufitare	8,271	11,659
Shëndeti në udhëtim dhe aksidentet	6,164	7,941
Të tjera vullnetare	4,082	6,665
Motorike (kasko)	1,582	4,379
Karton Jeshil	21,048	20,142
Zjarri dhe rreziqet shtesë	3,851	10,921
	428,337	299,457

c) Maturimet e mbetura për detyrimet e sigurimeve, bazuar në flukset e pritshme

2022	Më pak se 1 vit	Nga 1 deri 5 vjet	Nga 5 deri 10 vjet
Detyrime sigurimi			
UPR & URR	1,411,755		
RBNS & IBNR	1,614,737	200,229	
	2,798,384	428,337	-
2021	Më pak se 1 vit	Nga 1 deri 5 vjet	Nga 5 deri 10 vjet
Detyrime sigurimi			
UPR & URR	1,153,468		
RBNS & IBNR (shënimi 24)	1,319,313	163,596	-
	2,472,781	163,596	-

Eurosig sh.a.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare Individuale

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

18. Detyrime të qirasë financiare

Shoqëria lidhi një marrëveshje qiraje financiare më 2015 me Credins Leasing për blerjen e tre automjeteve. Tabela në vijim paraqet një analizë të kushteve dhe afateve të marrëveshjeve. Në vitin 2017 Shoqëria lidhi një marrëveshje qiraje financiare me me Landlease sh.a për blerjen e një automjeti. Pronësia e automjeteve në fund të afatit të kontratave të qirasë i kalon shoqërisë.

Në vitin 2019 Shoqëria ka vlerësuar dhe njohur qiratë që më parë janë klasifikuar si qera operative në përputhje me SNRF 16 siç tregohet në shënimin 4 të pasqyrave financiare.

Qiratë financiare paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Qira financiare nga bankat	-	-
Qira financiare IFRS 16	74,344	11,750
Interesa të matuaruar për IFRS 16	-	234
	74,344	11,984

Një analizë e pagesave minimale të paanullueshme të qirasë më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 është si në vijim:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Më pak se një vit	34,598	9,460
Nga një vit deri në pesë vjet	39,746	2,746
Më shumë se pesë vjet	-	-
Shpenzime të pritshme nga interesi		(222)
	74,344	11,984

19. Llogari të pagueshme për sigurimin, risigurimin dhe të tjera

Detyrime ndaj Insig Sh.a bazohet në marrëveshjet e huasë midis Eurosig Sh.a dhe Insig sh.a me datë 21 Qershor 2016 të rinovuar në 2017 me një afat të pacaktuar dhe në marrëveshjen e datës 26.07.2019 me afat 10 vjeçar. Huatë nuk mbartin interes.

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Furnitore	191,604	142,858
Kontrata risiguruesi të pagueshme	83,427	44,016
Taksa dhe kontribute të pagueshme	28,489	24,601
Të pagueshme ndaj punonjesve	12,152	9,992
Të pagueshme ndaj Insig Sh.a	38,984	261,861
Të pagueshme ndaj Insig Jete Sh.a	82,427	-
Të tjera llogari të pagueshme	65,445	47,526
	502,528	530,854

Eurosig sh.a.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare Individuale

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

20. Rezerva për fond kompensimi

Rezerva për fondin e kompensimit me 31 dhjetor 2022 dhe 2021, paraqitet si mëposhte:

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
Gjendja në fillim vitit	114,517	95,597
Rritja ne rezerva	2,237	18,920
Gjendja në fund viti	116,754	114,517

21. Kapitali aksioner

	<u>31 dhjetor 2022</u>	<u>31 dhjetor 2021</u>
	%	%
Z. Kadri Morina	58.21%	58.21%
Shoqeria "Euro-Alba.Ea" sh.p.k.	25.69%	25.69%
Z. Xhevdet Morina	15.82%	15.82%
Z.Ylli Merkaj	0.28%	0.28%
	100.00%	100.00%

Struktura e aksionerëve të shoërisë ka ndryshuar si rrjedhojë e Vendimit të Asamblesë së Akionerëve Nr. 10. datë 23,07,2021 "Për disa ndryshime në statutin e shoqërisë Eurosig sh.a si rezultati i zmadhimit të kapitalit askionar" ku vendosi zmadhimin e kapitalit nëpërmjet emëtimit të aksioneve të reja nga aksionerët e shoqërisë. kapitali themeltar është bërë 2,495,650,000 lek nga 2,765,650,000 lek. Sipas Vendimit Nr. 4252, Datë 23.07.2021, për zmadhimin e kapitalit themeltar të shoqërisë, kapitali i shoqërisë "Eurosig" Sha do të zmadhohet nëpërmjet emetimit të aksioneve të reja në vlerën 270 milion leke, të pagueshme me kontribut në mjete monetare nga aksionari ekzistues, me perfaqesues ligjor z. Gazmend Neza, duke rritur kapitalin e shoqërisë nga 2,495,650,000 leke në 2,765,650,000 leke.

Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, me anë të vendimit nr. 5, datë 27.01.2021, për miratimin e ndryshimit të statutit të shoqërisë së sigurimit "Eurosig" Sha, si rezultat i zmadhimit të kapitalit themeltar, vendosi miratimin e ndryshimit të statutit si rezultat i rritjes së kapitalit.

22. Rezerva të tjera

Rezerva të tjera në 31 dhjetor 2022 konsistojnë në rezervë ligjore në përputhje me ligjin 52, më datë 22 maj 2014.

23. Primet

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</u>
Primet e shkruara bruto	2,605,983	2,316,620
Primet e shkruara të ceduar në risigurim	(126,310)	(81,362)
Ndryshimi në primet e pafituara	(152,728)	(129,503)
Ndryshimi bruto në primet e pafituar dhe RBNS, pjesa e risiguresit	18,238	(4,943)
	2,345,183	2,100,812

Eurosig sh.a.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare Individuale

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

23. Primet (vazhdim)**Analizë sipas produktit**

31 dhjetor 2022	Risiguruesi	Ndryshimi bruto në UPR	Ndryshimi UPR Risig.	Primet e fituar neto	Dëmet e paguara
Motorike (MTPL)	(20,538)	(83,383)	-	1,510,761	493,048
Kufitare	-	(626)	-	81,182	2,612
Shëndeti në udhëtim dhe aksidentet	-	1,629	-	182,800	64,847
Të tjera vullnetare	(17,922)	(56,438)	13,190	54,180	25,513
Motorike (kasko)	(9,800)	3,623	-	78,911	42,686
Karton Jeshil	(37,909)	(8,868)	-	395,805	66,113
Zjarri dhe rreziqet shtesë	(40,141)	(8,665)	5,048	41,544	-
Totali jo-jetës	(126,310)	(152,728)	18,238	2,345,183	694,819

31 dhjetor 2021	Risiguruesi	Ndryshimi bruto në UPR	Ndryshimi UPR Risig.	Primet e fituar neto	Dëmet e paguara
Motorike (MTPL)	(18,905)	(43,022)	-	1,410,973	298,897
Kufitare	-	(1,375)	-	65,760	4,267
Shëndeti në udhëtim dhe aksidentet	-	(30,645)	-	193,364	5,576
Të tjera vullnetare	(9,633)	(24,494)	(7,342)	34,226	153,761
Motorike (kasko)	-	(5,411)	-	76,803	51,175
Karton Jeshil	(20,587)	(13,891)	-	275,966	54,834
Zjarri dhe rreziqet shtesë	(32,237)	(10,665)	2,400	43,719	26,417
Totali jo-jetës	(81,362)	(129,503)	(4,943)	2,100,812	594,928

Shpenzimet e marrjes në sigurim dhe shpenzimet e tjera shpërndahen sipas produkteve të ndryshme bazuar në përpjestimin e primit bruto për produkt ndaj primeve totale bruto.

Eurosig sh.a.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare Individuale

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

24. Të ardhura nga tarifat dhe komisionet-neto

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Komisione risigurimi dhe bashkësigurimi	(9,602)	(5,196)
Shpenzime komision i ndermjetesimi te risiguruesit	2,280	417
	(7,322)	(4,779)

25. Të ardhura financiare dhe nga investimet

Të ardhurat nga interesi lidhen me të ardhurat nga depozitat që përfshihen në zërin kredi dhe të drejta të tjera, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat afat-shkurtra që përfshihen në zërin mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre.

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Të ardhura nga interesi	5,647	(13,037)
Të ardhura nga dividendë	-	-
Të ardhura/ shpenzime te tjera	(756)	(101)
Total te ardhura financiare	4,891	(13,138)
Shpenzime per qira financiare	-	49
Shpenzime interesi ne perputhje me IFRS 16	4,489	1,642
Te tjera	-	-
Total shpenzime financiare	4,489	1,691

Shpenzimet e interesit lidhen me marrëveshje qeraje me Landeslease Sh.a për blerjen e pesë mjeteve të transportit, interesa të përlllogaritura në përputhje me kërkesat e SNRF 16.

26. Dëmet dhe përfitimet e shlyera të polic-mbajtësve, neto

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Dëmet e paguara		
Bruto	694,819	594,928
Pjesa e risiguruesit	(87,645)	(147,971)
Ndryshime në rezervën e dëmeve		
Bruto	420,308	82,118
Pjesa e risiguruesit	(57,333)	148,221
	970,149	677,296

Analiza e rezervave të dëmeve sipas produkteve paraqitet në shënimin 17 të këtyre pasqyrave financiare.

Eurosig sh.a.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare Individuale

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

27. Kosto të marrjes në sigurim

Sipas udhëzimit nr. 12 datë 04.04.2017 për taksat kombetare, taksa e primit evidentohet veçmas nga primi i shkruar. Në rolin e agentit të taksës mbi primit e shkruara, shoqëria e sigurimeve është përgjegjëse për llogaritjen, deklarimin, mbledhjen dhe pagesën e taksës së primit të shkruar për llogari të organit tatimor. Shuma totale e primeve të shkruara të faturuara gjatë muajit, si dhe taksa prej 10% e tyre deklarohet dhe paguhet nga shoqëria e sigurimeve deri në datën 15 të muajit pasardhës të muajit, për të cilin janë faturuar primit e sigurimit, në deklaratën mujore të taksave kombëtare.

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Shpenzime për komisione të paguara	645,305	967,967
Shpenzime të tjera të marrjes në sigurim	136,457	(53,106)
Totali shpenzimeve të marrjes në sigurim	781,762	914,861

28. Shpenzime administrative

Gjatë vitit 2022, numri mesatar i punonjësve ishte 265 (2021: 271 punonjës).

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Shpenzime personeli	187,390	165,725
Shperblime per punonjesit	10,665	7,729
Kontribute per autoritetet vendase	88,128	84,577
Amortizimi	56,798	55,468
Shpenzime promocioni	30,812	25,216
Shpenzime nga te trete	14,016	15,816
Shpenzime udhetimi	30,584	14,206
Shpenzime ligjore	4,589	9,451
Telekomunikacion	7,995	8,801
Riparime dhe mirembajtje	11,375	7,905
Taksa dhe tarifa vendore	7,771	6,538
Shperblime te Bordit Mbiqeqyres	5,475	4,779
Shpenzime informatike	3,739	4,137
Shpenzime kancelarie	3,858	2,017
Shpenzime qeraje	1,155	1,015
Sherbime te tjera	30,746	34,131
Shpenzime per provizione	-	13,982
	495,096	461,493

Shpenzimet për promocion lidhen me kostot për porositjen dhe prodhimin e produkteve të natyrës reklamuese duke përfshirë këtu dhurata me logon e Shoqërisë, dhurata promovionale të shpërndara në panairë dhe evente si dhe produkte zyre me logon e Shoqërisë. Në kontributet për autoritet vendase përfshihen shpenzimet për fondin e kompesimit si edhe kontributi vjetor prej 1.5% i të ardhurave të Shoqërisë për AMF. Shpenzime e auditimit për vitin 2022 janë 3,795,516 Lek (2021: 3,540,180 Lek). Shoqëria nuk ka marrë shërbime shtesë nga shoqëri të tjera të licensuara për të dhënë shërbime auditimi.

Eurosig sh.a.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare Individuale

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

28. Shpenzime administrative (vazhdim)

Struktura e stafit të shoqërisë është si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Drejtues	5	5
Rrjeti i shitjes	156	162
Demet	15	15
Administratore	59	59
Të tjerë	30	30
Total	265	287

29. Shpenzime të tjera operative

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Taksa regjistrimi	291	251
Komisione bankare	8,857	8,234
Penalitete dhe gjoba	29,848	10,613
	38,996	19,098

30. Fitimi/ (humbje) të tjera

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Fitime nga kurset e këmbimit	(31,704)	(5,605)
Humbje nga kurset e këmbimit	61,119	16,714
Të ardhura të tjera	(11,084)	(9,078)
Humbje nga rimarrja e Insig Jete	-	-
Fitime/ (humbje) të tjera- neto	18,331	2,031

Eurosig sh.a.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare Individuale

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

31. Tatimi mbi fitimin

Tatimi i shtyrë lidhet me diferencat e perkohshme që rezultojnë nga implementimi i SNRF 16 dhe është përlogaritur me normat tatimore në fuqi 15%.

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
<i>Fitimi kontabel para tatimit</i>	223,791	(187,741)
Tatimi i fitimit me normat ligjore (15%)	33,569	(28,161)
Revokim kontrate ndertese		
Tatimi revokim kontrate ndertese		
Te ardhura te patatueshme	185,000	
Shpenzime te panjohura	69,002	305,194
Tatimi për shpenzimet e pazbritshme	10,350	45,779
Shpenzimi i tatim fitimit për vitin	16,169	17,618
Tatim fitimi i shtyre	-	-
Shpenzime totale tatimi mbi fitimin	16,169	17,618

32. Palët e lidhura

Palët konsiderohen të lidhura nëse njëra palë ka mundësinë të kontrollojë palën tjetër ose të ushtrojë influencë të rëndësishme mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare apo vendimeve të tjera. Palët e lidhura përfshijnë aksionarët, drejtorët dhe entitete të lidhura me Shoqërinë.

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Shitje		
Te ardhura Insig sh.a	-	-
Te ardhura Insig Jete sh.a	-	-
	-	-
Blerje		
Blerje AAM dhe shpenzime Insig sh.a		
Shperblime te Bordit Mbikeqyres	-	4,779
Paga Administratori	-	3,600
	-	8,379
Te arketueshme		
Te arketueshme ndaj Insig sh.a	-	-
Parapagime ndaj pronarit	8,700	102,447
	8,700	102,447

Eurosig sh.a.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare Individuale

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

32. Palët e lidhura (vazhdim)

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Te pagueshme		
Të pagueshme Insig sh.a	-	-
Të pagueshme ndaj Insig Sh.a	38,984	286,204
Të pagueshme ndaj Insig Jete Sh.a	82,427	
	121,411	286,204

Përfitimet e mëpasshme, bazuar në pagesa aksionesh dhe përfitimet afatgjata nuk aplikohen meqë përfitime të tilla nuk ofrohen.

33. Angazhimet dhe pasiguritë*Angazhimet e qiramarrjes*

Angazhimet e qiramarrjes, bazuar në kontrata vjetore të lidhura për qira zyrash, janë analizuar në shënimin 4 të pasqyrave financiare.

Çështjet gjyqësore

Përgjatë rrjedhës të zakonshëm të biznesit, Shoqëria është përfshirë në pretendime dhe veprime ligjore të ndryshme. Sipas opinionit të drejtimit, zgjidhja përfundimtare e këtyre çështjeve nuk do të ketë efekt negativ material në pozicionin financiar të Shoqërisë apo ndryshimin e aktiveve neto. Çështjet ligjore janë të zakonshme në të cilat paditësit nuk bien dakord me vlerësimin e dëmit të bërë nga Shoqëria.

Drejtimi i vlerëson pretendimet duke përdorur ekspertizë të jashtme dhe të brendshme përfshirë këtu edhe konsulencën ligjore. Drejtimi beson se këto vlerësime janë të përshtatshme por megjithatë pranon se rezultati final mund të jetë një shumë më e madhe ose më e vogël se sa ajo e parashikuar.

AMF më anë të vendimit të Bordit numer 162, i ka kërkuar Shoqërisë anulimin e shtimit të kapitalit të Eurosig SH.a, Kosovë në vlerën prej 300 mijë euro, pasi ky transaksion nuk është në përputhje me vendimin nr. 148 datë 27.10.2017 të Bordit të AMF-së. Vendimi nr. 148 datë 27.10.2017 i Bordit të AMF-së parashtron masat administrative, ndër të tjera, ndalimin e transaksioneve me palët e lidhura dhe hartimin e planit për përmirësimin e treguesve rregullatorë të Shoqërisë.

Shoqëria ka ankimuar vendimin nr. 162 të Bordit të AMF pranë gjykatës administrative të shkallës së parë Tiranë. Gjykata administrative e shkallës së parë Tiranë, me anë të vendimit numër 80-2019-274 datë 01.02.2019, ka pranuar padinë e Shoqërisë ndaj Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për shfuqizimin e aktit administrativ, nr. 162 datë 30.07.2018 të Bordit të AMF dhe masat e marra sipas atij vendimi si edhe detyrimin ndaj AMF për njohjen e investimit të kryer në blerjen e aksioneve në shoqëritë e kontrolluara si aktive në mbulim të provigjioneve teknike dhe aftësisë paguese.

Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 2254 (86-2019-2581) datë 12.07.2019, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, duke e kthyer atë në titull ekzekutiv, të detyrueshme për zbatim. Për pasojë, prej 3 mujorit të dytë të vitit 2019 ka përfshirë në përllogaritjet e treguesve rregullatorë investimet në shoqëritë e kontrolluara, gjë e cila ka ndikuar ndjeshëm në përmirësimin e treguesve rregullatorë. AMF ka bërë rekurs për këtë vendim.

Eurosig sh.a.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare Individuale

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

33. Angazhimet dhe pasiguritë (vazhdim)*Legjislacioni tatimor*

Ligji Shqiptar për tatimet dhe doganat është objekt interpretimesh të ndryshme dhe ndryshimesh, të cilat mund të ndodhin shpesh. Interpretimi nga ana e manaxhimit të këtyre ndryshimeve ashtu si ato aplikohen në transaksionet dhe veprimtarinë e shoqërisë mund të kundërshtohen nga Autoritetet përkatëse.

Autoritetet tatimore shqiptare mund të mbajnë një qëndrim kundërshtues në lidhje me interpretimin e tyre të legjislacionit dhe vlerësimeve, dhe është e mundur që megjithëse transaksionet dhe aktivitetet nuk janë kundërshtuar në të shkuarën të mund të kundërshtohengjithësesi.

Si rezultat i kësaj, mund të ketë vlerësime për tatime shtesë të rëndësishme, gjoba dhe interesa përkatës. Periudhat fiskale mund të qëndrojnë të hapura për t'u rishikuar nga autoritetet në lidhje me taksat deri në pesë vjet prej vitit të rishikimit.

34. Manaxhimi i rrezikut financiar

Transaksionet me instrumentat financiarë rezultojnë në marrjen e rreziqeve financiare nga Shoqëria. Këto përfshijnë rrezikun e tregut, rrezikun e kredisë (duke përfshirë rrezikun e risigurimit) dhe rrezikun e likuiditetit. Secili nga këto risqe financiare është përshkruar më poshtë, bashkë me një përmbledhje të mënyrave që ndjek Shoqëria për manaxhimin e këtyre rreziqeve.

a. Rreziku i tregut*Rreziku i tregut përfshin tre lloje rreziku:*

- rreziku i monedhës – rreziku që vlera e një instrumenti financiar mund të luhatet nga ndryshimet e normave të këmbimit valutor.
- rreziku i vlerës së drejtë të normës së interesit – rreziku që vlera e një instrumenti financiar mund të luhatet për shkak të ndryshimeve në tregun e normave të interesit.
- rreziku i çmimit – rreziku që vlera e një instrumenti financiar mund të luhatet si rezultat i ndryshimeve të çmimeve të tregut, nëse këto ndryshime janë shkaktuar nga faktorë specifik për instrumentat e veçantë apo emetuesit e tyre ose faktorë që ndikojnë të gjitha instrumentat e tregtuara në treg.

Rreziku i tregut përfaqëson jo vetëm mundësinë për humbje por edhe për fitim.

i) Përputhshmëria e aktiveve/detyrimeve

Shoqëria manaxhon aktivet e saj duke përdorur një mënyrë që balancon cilësinë, diversifikimin, kompensimin e aktiveve/detyrimeve, likuiditetin dhe kthimin e investimit. Qëllimi i procesit të investimit është optimizimi i të ardhurave pas tatimit nga investimi dhe të ardhurave totale të rregulluara me rrezikun, duke siguruar që të gjitha aktivet dhe detyrimet manaxhohen në bazë të flukseve monetare dhe afatit. Bordi mbikqyrës kontrollon dhe aprovon portofolët periodikisht, duke vendosur instruksionet dhe limitet e investimit, dhe duke mbikqyrur procesin e manaxhimit të aktiveve/detyrimeve. Kujdes i jepet dhe përputhjes me rregullat e përcaktuara nga ligji.

Eurosig sh.a.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare Individuale

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

34. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Shoqëria cakton portofolin e aktiveve të synuar për çdo produkt kryesor sigurimi, të cilat përfaqësojnë strategjitë e investimit të përdorura për të financuar me fitueshmëri detyrimet e saj brenda niveleve të caktuara të rrezikut. Këto strategji përfshijnë objektiva për kohëzgjatjen efektive, likuiditetin, sektorin e përqëndrimit të aktiveve dhe cilësinë e kreditimit. Vlerësimet e përdorura për të përcaktuar shumën e përafërt dhe kohën e pagesave për ose në emër të policmbajtësve për detyrimet e sigurimit rivlerësohen rregullisht.

Shumë nga këto vlerësime janë subjektive dhe mund të ndikojnë aftësinë e shoqërisë për të arritur qëllimet dhe objektivat e saj në lidhje me manaxhimin e aktiveve/detyrimeve.

ii) Rreziku i normës së interesit

Ekspozimi i shoqërisë ndaj rrezikut të tregut për ndryshimet në normat e interesit është i përqendruar në portofolin e saj të investimeve. Operacionet e shoqërisë janë të ekspozuara ndaj rrezikut të luhatjes së normave të interesit në masën që aktivet që perfitojnë interes dhe detyrimet që mbartin interes maturohen ose ri-vlerësohen në kohë të ndryshme apo në shuma të ndryshme.

Shoqëria është gjithashtu e ekspozuar ndaj rrezikut të ndryshimit të flukseve të ardhshme të parasë që vijnë nga ndryshimet në normat e interesit të tregut. Ky risk është i kufizuar duke marrë në konsideratë që pjesa më e madhe e investimeve të shoqërisë që japin interes në ditën e raportimit kanë normë fikse interesi. Shoqëria monitoron këtë ekspozim nëpërmjet kontrolleve periodike të pozicioneve të aktiveve dhe detyrimeve. Shënimi 32 më poshtë paraqet analizën e rivlerësimit të normave të interesit në datën e raportimit për aktivet dhe detyrimet financiare të shoqërisë.

iii) Rreziku i kursit të këmbimit

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut valutor nëpërmjet transaksioneve në valutë. Ky është rreziku që vlera e instrumentit financiar mund të luhetet për shkak të ndryshimeve në normat e kursit të këmbimit. Ekspozimi ndaj këtij rreziku në datën e raportimit konsiderohet si i ulët përderisa aktivet dhe detyrimet e shoqërisë, përveç depozitave në bankë në Eur dhe USD, janë të paraqitura në LEK. Ndjeshmëria ndaj rrezikut valutor llogaritet nga manaxhimi dhe është paraqitur në shënimin 33.h.

Eurosig sh.a.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare Individuale

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

34. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**b. Rreziku kreditor**

Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kreditimit paraqitet nga vlerat e mbetura të aktiveve të lidhura, të paraqitura në tabelën më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Depozitat me afat	486,673	490,410
Te arketueshme nga aktiviteti i sigurimit	268,270	204,895
Rezerva per deme e risiguruesit	364,933	289,362
Aktive te tjera financiare	438,522	465,191
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre	3,839	12,214
	1,562,237	1,462,072

Portofoli i Shoqërisë në një shtrirje afat-shkurtër dhe investimet e tjera janë subjekt i rrezikut të kredisë. Ky risk përcaktohet si një humbje potenciale në vlerën e tregut si rezultat i ndryshimeve të pafavorshme në aftësinë e një huamarrësi për të ripaguar borxhin. Shoqëria e manaxhon këtë risk nëpërmjet analizave të kujdesshme të nënshkrimit dhe rishikimeve të bordit drejtues dhe mbledhjeve të vazhdueshme për rishqyrtimin e zhvillimeve.

Shoqëria nuk ka një politikë kreditimi të caktuar megjithatë monitoron ekspozimin ndaj rrezikut të kredisë vazhdimisht. Shoqëria ka adoptuar një politikë mbrojtëse ndaj rrezikut të investimeve.

Më poshtë janë paraqitur të drejtat për primet nga policmbajtësit dhe debitorë të tjerë, më 31 dhjetor 2022 dhe 2021:

2022

0 - 90 ditë	91- 180 ditë	181- 365 ditë	mbi 365 ditë	Totali
89,744	24,945		153,581	268,270

2021

0 - 90 ditë	91- 180 ditë	181- 365 ditë	mbi 365 ditë	Totali
30,828	5,868	7,172	161,027	204,895

Kreditë dhe të drejtat e tjera përbëhen kryesisht nga depozitat në bankat lokale, të pa klasifikuara nga institucione ndërkombëtare si edhe të drejta të tjera financiare për arkëtim sic paraqiten në shënimin 16.

b. Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit rritet në financimet e përgjithshme të aktiviteteve kryesore të shoqërisë dhe në manaxhimin e pozicionit. Ai përfshin si pamundësinë për financimin e aktiveve në maturimin me normat e caktuara ashtu dhe të rrezikut të pamundësisë për të likuiduar një aktiv me një çmim të arsyeshëm dhe brënda një afati kohor të caktuar.

Shoqëria zotëron një portofol me aktive likuide si pjesë e strategjisë së manaxhimit të rrezikut të likuiditetit, për të siguruar aktivitet të vazhdueshëm dhe përmbushje të kërkesave ligjore. Pozicioni i likuiditetit të Shoqërisë është i mirë dhe të gjitha kërkesat e detyrueshme për shlyerjen e dëmeve janë përmbushur gjatë vitit.

Shënimi 33 (ë) paraqet analizën e maturitetit të raportimit për aktivet dhe detyrimet financiare të Shoqërisë.

Eurosig sh.a.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare Individuale

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

34. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**b. Rreziku i likuiditetit (vazhdim)**

Shënimi 17 paraqet analizën e maturitetit në lidhje me provizjonet teknike të Shoqërisë.

c. Vlera e drejtë

Vlera e drejtë tregon shumën me të cilën një aktiv mund të shkëmbehet apo një detyrim të shlyhet në një transaksion në kushtet e tregut. Drejtimi është i besimit se vlera e mbetur e kredive dhe të drejtave të tjera nuk është shumë e ndryshme nga vlera e tyre e drejtë, duke supozuar se të gjitha pagesat mbi ekspozimet e pazhvierësuar do të mblihen sipas kontratës, në sajë të maturitetit afat-shkurtër dhe natyrës së investimeve të cilat janë tejet likuide. Vlerat e drejta e depozitave me afat ne bankë paraqitet si më poshtë:

Vlera e drejtë	Vlera e mbetur 2022	Vlera e mbetur 2021
Depozita me afat	476,635	476,579

Drejtimi beson se vlera e drejtë e të gjithë aktiveve dhe detyrimeve financiare janë pothuajse sa vlera kontabël.

d. Manaxhimi i kapitalit

Objekti kryesor i Shoqërisë në manaxhimin e kapitalit është përmbushja e kërkesave të përshkruara nga Autoriteti Mbikqyrjes Financiare si rregullatori tregut të sigurimeve në Republikën e Shqipërisë.

Struktura e kapitalit të Shoqërisë konsiston në kapital që i atribuohet mbajtësve të kapitalit të Shoqërisë, dhe përfshin kapitalin e paguar, rezervat dhe fitimin e mbajtur. Shoqëria menaxhon kapitalin për të siguruar që të mbajë nivelet e kërkuara të kapitalit që siguron vijueshmërinë e aktivitetit dhe përputhshmërinë me kërkesat për kapital të rregullatorëve, ndërsa maksimizon kthimin ndaj aksionerëve përmes optimizimit të raportit të borxhit me kapitalin. Bazuar në treguesit e përlogaritur Shoqëria është brenda limitit ligjor.

e. Analiza e maturitetit

Tabelat e mëposhtme analizojnë aktivet financiare të shoqërisë që janë subjekt i SNK 39 më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 duke i grupuar sipas maturitetit nga data e raportimit deri në datën e maturimit të kontratës përveç si vijon. Maturitet e mbetura kontraktuale të vlerësuar të provizioneve të sigurimeve janë analizuar shënimin 17.

Eurosig sh.a.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare Individuale

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

34. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**e. Analiza e maturitetit (vazhdim)**

	Deri në 3 muaj	Deri në 6 muaj	6 - 12 muaj	1 - 2 vjet	2 - 5 vjet	Më tepër	Totali
2022							
Aktive financiare							
Depozita me afat	151,181	20,175	105,711	144,700	64,906	-	486,673
Të drejta nga sigurimi	95,844	4,690	14,869	152,867	-	-	268,270
Risiguruesit	12,680	10,513	5,893	-	335,847	-	364,933
Aktive të tjera financiare	162,499	40,000	80,000	156,023			438,522
Mjete monetare	3,839						3,839
Aktive financiare gjithsej	426,043	75,378	206,473	453,590	400,753	-	1,562,237
Provizione për kontratat e sigurimit	323,578	-	2,551,274	325,457	26,142	270	323,578
Detyrime qiraje financiare	-	15,905	56,935	1,504			74,344
Detyrime nga sigurimi dhe risigurimi	270,044	87,958	69,641	74,884			502,528
Detyrime financiare gjithsej	270,044	103,863	126,576	76,388	-	-	2,139,109
Hendeku i maturitetit	155,999	(28,485)	79,897	377,202	400,753	-	(576,872)

g) Analiza e ndryshimit të normave të interesit

Tabelat e mëposhtme pasqyrojnë aktivet financiare të Shoqërisë të analizuaras sipas riçimitit të përcaktuar si më e hershmja midis maturimit kontraktual dhe riçimitit kontraktual.

Tabelat janë vlerësime të manaxhimit për rrezikun e normave të interesit të Shoqërisë për 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021, që sigurojnë disa tregues të ndjeshmërisë së fitimeve të Shoqërisë nga lëvizja e normave të interesit.

Eurosig sh.a.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare Individuale

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

34. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

2022	Nuk sjellin interes	Me norma fikse	Totali
Aktivet financiare	-	-	-
Depozita me afat	-	486,673	486,673
Të drejta nga sigurimi	268,270	-	268,270
Risiguruesit	364,933	-	364,933
Aktive të tjera financiare	438,522	-	438,522
Mjete monetare	3,839	-	3,839
Totali aktive financiare	1,075,564	486,673	1,562,237
Provizione për kontratat e sigurimit	3,226,721	-	3,226,721
Detyrime qiraje financiare	74,344	-	74,344
Kredi	-	-	-
Detyrime nga sigurimi dhe risigurimi	502,528	-	502,528
Totali detyrime financiare	3,803,593	-	3,803,593
Hendeku i normës së interesit	(2,728,029)	486,673	(2,241,356)

2021	Nuk sjellin interes	Me norma fikse	Totali
Aktivet financiare			
Depozita me afat	-	490,410	490,410
Të drejta nga sigurimi	204,895	-	204,895
Risiguruesit	289,362	-	289,362
Aktive të tjera financiare	465,191	-	465,191
Mjete monetare	12,214	-	12,214
Totali aktive financiare	766,767	490,410	1,257,177
Provizione për kontratat e sigurimit	1,500,217	-	1,500,217
Detyrime qiraje financiare	11,984	-	11,984
Kredi	-	-	-
Detyrime nga sigurimi dhe risigurimi	530,854	-	530,854
Totali detyrime financiare	2,043,055	-	2,043,055
Hendeku i normës së interesit	(1,071,393)	490,410	(580,983)

Eurosig sh.a.

Shënimet shpjeguese për Pasqyrat Financiare Individuale

(Të gjitha shumatat janë në mijë Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

34. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**h. Rreziku i monedhës**

Aktivet financiare të shoqërisë janë emërtuara si vijon për 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021.

2022	LEK	EUR	USD	Total
Aktivet financiare				
Depozita me afat	483,473	3,200		486,673
Të drejta nga sigurimi	68,279	139,173	60,818	268,270
Risiguruesit	11,062	353,872		364,933
Aktive të tjera financiare	100,335	329,488	8,700	438,523
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	2,668	1,138	33	3,839
Totali aktive financiare	665,817	826,870	69,551	1,562,238
Detyrime financiare				
Provizione për kontratat e sigurimit	2,192,791	981,393	52,537	3,226,721
Detyrime qiraje financiare	45,445	28,899	-	74,344
Detyrime nga sigurimi dhe risigurimi	150,402	293,399	58,727	502,528
Totali detyrime financiare	2,388,638	1,303,691	111,264	3,803,593
2021	LEK	EUR	USD	Total
Aktivet financiare				
Depozita me afat	489,925	485	-	490,410
Të drejta nga sigurimi	152,281	52,266	348	204,895
Risiguruesit	300	289,062	-	289,362
Aktive të tjera financiare	96,078	45,660	56,785	198,523
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	8,822	3,392	-	12,214
Totali aktive financiare	747,406	390,865	57,133	1,195,404
Detyrime financiare				
Provizione për kontratat e sigurimit	957,151	543,066	-	1,500,217
Detyrime qiraje financiare	11,984	-	-	11,984
Detyrime nga sigurimi dhe risigurimi	268,992	85,759	176,103	530,854
Totali detyrime financiare	1,238,127	628,825	176,103	2,043,055
Pozicioni valutor neto	(490,721)	(237,960)	(118,970)	(847,651)
Ndjeshmëria nëse kursi i këmbimit rritet me 5 %		(14,304)	(5,961)	
Ndjeshmëria nëse kursi i këmbimit zvogëlohet me 5 %		14,304	5,961	

35. Ngjarje të mëpasshme

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së raportimit që do të kërkojnë rregullime ose shënime shpjeguese shtesë në pasqyrat financiare individuale.

ANEKSE SHOQËRUESE SUPLEMENTARE

Eurosig sh.a.*Aneke shtesë të pasqyrave financiare individuale**(Të gjitha shumat janë në LEK përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)***Aneke Shtesë****a. Aktivet e lejuara në mbulim të provigjioneve teknike**

Nr.	Emërtimi	% e lejuar	Vlera në fakt	% faktike	Investime mbi limitet e lejuara
I.	Aktivët e lejuara në mbulim të provigjioneve teknike, të ndryshme nga ato matematike, sipas nenit 97 të Ligjit 52/14		4,857,611,153		-
I.1	a) Tituj të emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë ose Banka e Shqipërisë	100%		0.0%	-
I.2	b) Obligacione dhe tituj të tjerë borxhi, të garantuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë	100%		0.0%	-
I.3	c) Obligacione dhe tituj të tjerë borxhi, të emetuar nga qeverisja vendore e Republikës së Shqipërisë;	10%		0.0%	-
I.4	ç) Obligacione dhe tituj të tjerë borxhi, të shoqëruara nga garanci të emetuara nga qeverisja vendore e Republikës së Shqipërisë;				
I.5	d) Obligacione dhe tituj të tjerë borxhi, të tregtuar në tregje të rregulluara në Republikën e Shqipërisë;	35%		0.0%	-
I.6	dh) Obligacione dhe tituj të tjerë borxhi, të cilët nuk tregtohen në tregje të rregulluara në Republikën e Shqipërisë, nëse emetuesi i tyre është person juridik, me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë;	5%		0.0%	-
I.7	e) Aksione të tregtuara në tregje të rregulluara në Republikën e Shqipërisë;	25%		0.0%	-
I.8	ë) Aksione, të cilat nuk tregtohen në tregje të rregulluara në Republikën e Shqipërisë, nëse emetuesi i tyre është person juridik, me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë;	5%	4,614,693,803	143.0%	
I.9	f) Kuota/aksione të sipërmarrjeve të investimeve kolektive të regjistruara në Republikën e Shqipërisë;	40%		0.0%	-
I.10	g) Hua të pasiguruara dhe hua të siguruara nga garanci hipotekore, garanci bankare ose siguruese në Republikën e Shqipërisë, me kusht që këto të fundit të mos jenë siguruar nga shoqëri sigurimi apo banka të kontrolluara nga i njëjti grup që kontrollon dhe shoqërinë ;	10%		0.0%	-
I.11	gj) Toka, ndërtesa dhe të drejta në pasuri të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë nëse plotësohen njëkohësisht kërkesat sipas nenit 97, germa gj) e Ligjit 52/14:	30%	136,279,359	4.2%	-
	Qëllime shfrytëzimi		136,279,359		-
	HEMBULL (Nr.Pasurie 1234, Volum 12, Faqe12, Zona Kadastrale 1234, Qyteti)	10%		0.0%	-
	Apartament Rrethi Elbasan, RR/L Beqir Dardha P/G 41 SH 3 K1 AP 3	10%	23,708,069	0.7%	-
	Apartament Rrethi Elbasan, RR/L Beqir Dardha P/G 41 SH 3 K1 AP 3	10%	2,410,981	0.1%	
	Njesi RRETHI Fier , RR/I 1 MAJ P/G sh-1	10%	42,296,480	1.3%	-
	Njesi RRETHI Fier , RR/I 1 MAJ P/G sh-1	10%	20,721,134	0.6%	-
	Njesi RRETHI Fier , RR/I 1 MAJ P/G sh-1	10%		0.0%	-
	Truall Ndertese Rrethi Lushnje Rr/L Nepravishte	10%	33,071,749	1.0%	-
	Apartament Rrethi Lezhe Rr/L Beselidhja P/G 80 SH 1 K1 AP 4	10%	14,070,946	0.4%	-
	Objekti 9	10%		0.0%	-
	Objekti 10	10%		0.0%	-
	Objekti 11	10%		0.0%	-
	Objekti 12	10%		0.0%	-
	Objekti 13	10%		0.0%	-

Eurosig sh.a.**Aneke shtesë të pasqyrave financiare individuale***(Të gjitha shumat janë në LEK përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)*

	Objekti 14	10%		0.0%	-
	Objekti 15	10%		0.0%	-
	Qëllime investimi		-		-
	Objekti 1	10%		0.0%	-
	Objekti 2	10%		0.0%	-
	Objekti 3	10%		0.0%	-
	Objekti 4	10%		0.0%	-
I.12	h) Depozita në banka dhe/ose degë të bankave të huaja, me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë.	100%	106,637,991	3.3%	-
II.	Investime të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike, të ndryshme nga ato matematike, për të cilat është marrë miratimi paraprak i Autoritetit:		-		-
II.1	a) Obligacione afatgjata dhe tituj borxhi afatgjatë të emetuar nga një vend anëtar ose vend anëtar i OECD-së; që janë të klasifikuar si BBB+ e më lart sipas Standart & Poor's ose vlerësimi ekuivalent nga vlerësues të tjerë ndërkombëtarë të njohur gjerësisht;	15%		0.0%	-
II.2	b) Obligacione afatgjata dhe tituj afatgjatë të emetuar nga një entitet joqeveritar i një vendi anëtar ose vendi anëtar të OECD-së; me kushtin që entitetet jo qeveritare emetuese të jenë Banka Ndërkombëtare e Pagesave (BIS), Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Komisioni Evropian apo banka zhvillimi shumëpalëshe, nëse ato plotësojnë të gjitha kriteret e mëposhtme:				
	i) Për këta tituj ekzistojnë tregje aktive të marrëveshjeve të riblerjes;				
	ii) Titujt nuk janë emetuar nga bankat apo institucione të tjera financiare.				
II.3	Aksione të emetuara nga një shoqëri aksionare e huaj, e cila tregton në tregje të rregulluara të kapitalit në një vend anëtar ose vend anëtar të OECD-së;	15%		0.0%	-
II.4	Kuota/aksione të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, të cilat tregtohen në një vend anëtar ose vend anëtar të OECD-së.				
III.	Investime të tjera të lejuara sipas Rregullores nr. 19, date 28.04.2015, neni 4:		930,194,993		145,094,413
III.1	b) Kredi individuale hipotekore për apartamente banimi vetëm për punonjësit e shoqërisë së sigurimit;	1%		0.0%	-
III.2	c) Para dhe ekuivalentë të saj (të cilat përfaqësojnë mjete monetare në arkë, mjete monetare në bankë dhe depozita me afat maturimi më të vogël se 3 muaj), në banka të licencuara nga Banka e Shqipërisë, me seli në Republikën e Shqipërisë;	3%	3,840,209	0.1%	-
III.3	ç) Të arkëtueshmet nga risiguruesit, që nuk janë pezull më shumë se 90 ditë nga lindja e detyrimit;	25%	364,933,420	11.3%	-
III.4	d) Pjesën e risiguruesit në provigjonet teknike, kur risiguruesit janë të klasifikuar si BBB- e më poshtë nga Standart & Poor;				
III.5	d) Pjesën e risiguruesit në provigjonet teknike, kur risiguruesit janë të klasifikuar si BBB- e më lart nga Standart & Poor;	100%		0.0%	-
III.6	e) Depozita në shoqëri ceduese dhe borxhe të zotëruara nga ato;	20%		0.0%	-
III.7	f) Shuma, që detyrohen nga policëmbajtësit dhe ndërmjetësit, e që rrjedhin nga veprimtaria e sigurimeve të drejtpërdrejta dhe risiguruese, n.q.s nga dita e detyrimit të pagesës nuk kanë kaluar më shumë se 90 ditë, por jo më shumë se 20 % e provigjionit të primit të pafituar;	20%	89,743,724	6.9%	-
III.8	g) Aktive të qëndrueshme të trupëzuara, përveç atyre të parashikuara në shkronjën "gj", pika 1, të nenit 97, të ligjit nr. 52, datë 22.05.2014, "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit".	5%	54,286,861	1.7%	-

Eurosig sh.a.**Aneke shtesë të pasqyrave financiare individuale***(Të gjitha shumat janë në LEK përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)*

III.9	h) Interesa dhe qera të maturuara dhe të ardhura të tjera të maturuara.	5%	10,038,291	0.3%	-
III.10	i) Investimet në depozitat e garancisë së Kartanit jeshil pranë BSHS	100%	66,328,678	2.1%	-
III.11	j) Shpenzimet e marrjes në sigurim të shtyra	15%	341,023,811	26.1%	145,094,413
IV	TOTALI I INVESTIMEVE (I+II+III)		5,787,806,146		145,094,413
V	TOTALI I INVESTIMEVE TE LEJUARA (Totali i "Vlera në fakt" zbritur "Investime mbi limitet e lejuara")		5,642,711,732	-	
VI	C. Provigjone teknike, të ndryshme nga ato matematike, bruto (VI.1 deri VI.5)		3,226,720,976		
VI.1	Provigjone të primit të pafitur		1,306,195,985		
VI.2	Provigjone të dëmeve		1,920,524,991		
VI.3	Provigjone për bonuse dhe rabate				
VI.4	Provigjone barazimi dhe katastrofe				
VI.5	Provigjone të tjera teknike				
VII	Tepriçë (+) / Mungesë (-) (V-VI)		2,415,990,757		
VIII	Mbullimi në % (V/VI)		174.87%		

Eurosig sh.a.**Anekse shtesë të pasqyrave financiare individuale***(Të gjitha shumatat janë në LEK përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)***b. Aftësisa paguese mbi bazë kapitali**

Nr.	Emërtimi	Vlera në lekë
I	Kapitali bazë, Neni 76 i Ligjit 52/14 (I.a+I.b+I.c-II)	2,703,024,569
I.a	Kapitali aksionar i shoqërisë së sigurimit, i cili përbëhet nga aksionet e zakonshme të emetuara;	2,765,650,000
I.b	Rezervat e kapitalit, të cilat nuk i korrespondojnë detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e sigurimit;	164,679,217
I.c	Fitimi i pashpërndarë, i mbartur pas zbritjes së dividendëve të pagueshëm	-227,304,649
II	Elementet që nuk përfshihen në llogaritjen e kapitalit bazë: (II.a+II.b+II.c+II.ç)	0
II.a	Aksionet e veta të riblera	
II.b	Investimet në aktive të patrupëzuara	
II.c	Humbjet e mbartura dhe humbja e vitit ushtrimor	
II.ç	Diferenca midis provigjoneve të dëmeve të skontuara dhe të paskontuara.	
III	Kapitali shtesë, neni 77 i Ligjit 52/14 (III.a+III.b+III.c+III.ç)	0
III.a	Kapitali aksionar i cili përbëhet nga aksionet me përparësi të akumuluar	
III.b	Instrumente të borxhit të varur	
III.c	Rezerva kapitali që lidhen me aksionet me përparësi të akumuluar	
III.ç	Elemente të tjera	
IV	Elementet e zbritshme në llogaritjen e kapitalit, neni 79 i Ligjit 52/14 (IV.a+IV.b+IV.c+V)	528,198,645
IV.a	Pjesëmarrje dhe instrumente të borxhit të varur në një tjetër shoqëri sigurimi, risigurimi, grupi kontrollues sigurimi, banka dhe/ose degë të bankave të huaja, shoqëri komisionere, shoqëri administruese dhe institucione të tjera financiare, në të cilat shoqëria e sigurimit zotëron pjesëmarrje influencuese mbi 10 për qind	3,920,000
IV.b	Investime të tjera në personat e parashikuar në shkronjën "a", të kësaj pike, që janë përfshirë në llogaritjen e kapitalit të personave përkatës	
IV.c	Pjesëmarrjet dhe titujt e borxhit të varur, si dhe investime të tjera në një shoqëri tjetër sigurimi ose ente financiare, të tjera nga ato të parashikuara në shkronjën "a", të kësaj pike, të cilat kalojnë masën 10 për qind të kapitalit të shoqërisë së sigurimit, e llogaritur përpara zbritjes së elementeve të përmendura në shkronjat "a" dhe "b" të kësaj pike	
V	Aktivitet jolikuide (V.a deri V.g)	524,278,645
V.a	Aksionet e palistuar në tregje të rregulluara	
V.b	Huatë/llogaritë e arkëtueshme me palë të lidhura	8,700,253
V.c	Huatë nga brokerat dhe agentët	
V.ç	Primet e arkëtueshme ose debitorë nga risigurimi, që kanë tejkaluar afatin 90 - ditor;	29,896,241
V.d	Debitorë të tjerë ose llogari të tjera të arkëtueshme, të cilat nuk rrjedhin drejtpërsëdrejti nga veprimtaria e sigurimit;	88,053,791
V.dh	Inventari	3,570
V.e	Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim	
V.ë	Shpenzimet e parapaguara	1,582,707
V.f	Aktivitet të tjera, të cilat nuk janë të lira nga çdo përgjegjësi apo detyrim i parashikuar	
V.g	Aktivitet të tjera, të cilat nuk janë lehtësisht të kthyeshme në para në momentin kur është e nevojshme përmbushja e detyrimeve financiare kur u vjen afati	6,016,312
V.h	Elemente të tjerë të zbritshëm sipas nenit 4 të kësaj rregullore (V.-h-1 deri V.h-10) :	390,025,771
V.h-1	<i>Emri i mirë i shoqërisë</i>	
V.h-2	<i>Toka, ndërtesa dhe të drejta në pasuri të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë nëse nuk plotësohen njëkohësisht kërkesat sipas nenit 4, pika 1, germa c) të rregullores</i>	301,892,766

Eurosig sh.a.**Aneke shtesë të pasqyrave financiare individuale***(Të gjitha shumat janë në LEK përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)*

V.h-3	Aktive afatgjata materiale për të cilat shoqëria nuk zotëron dokumentacionin mbi pronësinë;	
V.h-4	Aktive afatgjata materiale që vijnë nga shpenzime për përmirësimin e ambienteve me qira	21,804,327
V.h-5	Aktive afatgjata materiale në formën e materialeve publicitare	
V.h-6	Likuiditete në Banka, në rast se shoqëria ka një linjë kredie të hapur në llogari rrjedhëse (overdraft) apo të ngjashme, në vlerën maksimale të kredisë së hapur në llogari rrjedhëse (overdraft) apo të ngjashme;	0
V.h-7	Të ardhura të llogaritura nga paditë e regresit nga Fondi i Kompensimit apo të tjera në rast se shoqëria nuk zotëron dokumentacion justifikues të mjaftueshëm për të garantuar arkëtimin e shumës	
V.h-8	Të gjitha aktivet e lëna si kolateral, të lënë peng apo që nuk janë të lira nga çdo barrë tjetër në të gjithë vlerën e tyre	
V.h-9	Fondi i Garancisë për Kartonin Jeshil	66,328,678
V.h-10	Çdo zë tjetër në kundërshtim me kërkesat ligjore, rregullatore dhe vendime të Bordit të Autoritetit	
VI	KAPITALI (Aftësia Paguese)	2,174,825,924
VII	Kufiri minimal i aftësisë paguese, sipas pikës 3 të nenit 80 të Ligjit Nr. 52/2014	380,921,283
VIII	Fondi i garancisë, sipas nenit 81 të Ligjit Nr. 52/2014	370,000,000
IX	Niveli i kërkuar i aftësisë paguese, sipas pikës 2 të nenit 80 të Ligjit Nr. 52/2014	571,381,925
X	Mbi (+) / nën (-) nivelin e kërkuar të Aftësisë paguese (VI-IX)	1,603,443,999
XI	Mjaftueshmëria e kapitalit	I mjaftueshëm



**SIGURIMI
PRONËS**



**SIGURIME
MOTORIKE**



**SIGURIMI
BIZNESEVE**



**SIGURIMI
SHËNDETIT**